


KONSULTIMI PUBLIK NË SHQIPËRI: ILUZIONI I PËRFSHIRJES

NJË DISTANCË E LARGËT NDËRMJET TRANSPARENCËS
DHE PJESEMARRJES NË KONSULTIMET E QEVERISË



Institute
for Democracy
and Mediation



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

KONSULTIMI PUBLIK NË SHQIPËRI: ILUZIONI I PËRFSHIRJES

NJË DISTANCË E LARGËT NDËRMJET TRANSPARENCËS
DHE PJESËMARRJES NË KONSULTIMET E QEVERISË

KONSULTIMI PUBLIK NË SHQIPËRI: ILUZIONI I PËRFSHIRJES NJË DISTANCË E LARGËT NDËRMJET TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES NË KONSULTIMET E QEVERISË

Autorët:

Megi Reçi, Diori Angjeli

Ekipi i Monitorimit:

Diori Angjeli, Vilson Blloshmi, Bora Kola, Megi Reçi, Ina Shënplaku, Alba Tema

Metodologjia nga:

Prof. Assoc. Dr. Nadia Rusi, Megi Reçi

Rishikuar nga:

Gjergji Vurmo

Redaktuar nga:

Thomas Adamson-Green

Dizajni:

Eduart Cani

Përkthimi:

Language Solutions



Institute
for Democracy
and Mediation



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Ky raport monitorimi është hartuar në kuadër të projektit «Forcimi i Transparencës dhe Qeverisjes së Mirë» i cili zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e NED.

Të drejtat e autorit për këtë publikim i përkasin vetëm IDM-së. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo të transmetohet në asnjë formë apo mënyrë pa miratimin paraprak me shkrim të IDM-së.

PËRMBAJTJA

RËNDËSIA E MONITORIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10
KUADRI METODOLOGJIK	12
SISTEMI I PIKËZIMIT	13
KAMPIONIMI I INSTITUCIONEVE DHE PROJEKTAKTEVE TË MONITORUARA	15
MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	16

PARIMI I: TRANSPARENCA E KONSULTIMEVE PUBLIKE **19**

Performanca sipas treguesve të transparencës	19
Krahasimi i institucioneve lidhur me transparencën	19
Krahasimi i performancës për transparencën në kuadër të ligjeve dhe politikave të monitoruara	20
Treguesi 1.1: Publikimi i paketës së dokumentacionit mbështetës për konsultimin publik	21
Treguesi 1.2: Transparenca e planit vjetor të konsultimit publik	23
Treguesi 1.3: Publikimi i planeve individuale të konsultimit publik	24
Treguesi 1.4: Transparenca e komenteve të mbledhura nga institucionet	25
Treguesi 1.5: Publikimi i raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik	27
Treguesi 1.6: Publikimi i raporteve individuale të konsultimit publik	29

PARIMI II: AKSESUESHMËRIA NË DOKUMENTET E KONSULTIMIT **31**

Performanca sipas treguesve të aksesueshmërisë	31
Krahasimi i aksesueshmërisë në konsultime sipas institucioneve	31
Krahasimi i performancës së aksesueshmërisë në kuadër të ligjeve dhe politikave të monitoruara	32
Treguesi 2.1: Aksesimi në njoftimet për konsultim	33
Treguesi 2.2: Aksesimi në dokumentacionin e konsultimit	34

PARIMI III: EFEKTIVITETI I KONSULTIMIT PUBLIK **36**

Performanca sipas treguesve të efektivitetit të konsultimeve	36
Krahasimi i efektivitetit të konsultimit në institucione	36
Krahasimi i efektivitetit të konsultimeve të ligjeve dhe politikave të monitoruara	37
Treguesi 3.1: Përshtatshmëria e afatit kohor të konsultimit	37
Treguesi 3.2: Shpërndarja e konsultimeve gjatë vitit kalendarik	39
Treguesi 3.3: Miratimi në kohë i projektakteve të konsultuara	41
Treguesi 3.4: Zbatimi i planit vjetor të konsultimit	42
Treguesi 3.5: Vlerësimi i efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes	44
Treguesi 3.6: Monitorimi i brendshëm i procesit të konsultimit publik	45

PARIMI IV: LLOGARIDHËNIA PËR KONSULTIMET PUBLIKE **47**

Performanca sipas treguesve të llogaridhënies	47
Krahasimi i llogaridhënies në institucione	47
Krahasimi i llogaridhënies në kuadër të ligjeve dhe politikave të monitoruara	48
Treguesi 4.1: Llogaridhënia për fazën e hartimit të aktit/konsultimit paraprak	48
Treguesi 4.2: Projektaktet që e kanë origjinën nga dokumentet strategjike të qeverisë dhe plani vjetor i konsultimeve publike	50

Treguesi 4.3: Ofrimi i arsyeve nga ana e institucioneve për refuzimin ose pranimin e pjesshëm të komenteve në konsultimet publike	51
Treguesi 4.4: Vendosja e procedurave për ankesat e qytetarëve mbi shkeljet e konsultimit publik	53
Treguesi 4.5: Ofrimi nga ana e institucioneve e arsyeve për përjashtimin e projektakteve nga konsultimet publike	54
Treguesi 4.6: Demonstrimi i ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR	55

PARIMI V: GJITHËPËRFSHIRJA DHE MOSDISKRIMINIMI NË KONSULTIMET PUBLIKE **57**

Performanca e treguesve të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit	57
Krahasimi i gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit në konsultimet publike ndërmjet institucioneve	57
Krahasimi i performancës së gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit në kuadër të ligjeve dhe politikave të monitoruara	58
Treguesi 5.1: Identifikimi paraprak i grupeve të ndikuara nga projektakti	59
Treguesi 5.2: Larmia e grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit	60
Treguesi 5.3: Larmia e grupeve pjesëmarrëse në konsultim publik	61
Treguesi 5.4: Përshtatshmëria e metodave të përzgjedhura të konsultimit	63

PARIMI VI: PJESËMARRJA QYTETARE NË KONSULTIMET PUBLIKE **65**

Performanca sa u përket treguesve për pjesëmarrjen qytetare	65
Krahasimi i pjesëmarrjes qytetare ndërmjet institucioneve	65
Krahasimi i performancës së pjesëmarrjes qytetare në kuadër të ligjeve dhe politikave të monitoruara	66
Treguesi 6.1: Krijimi i një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet	66
Treguesi 6.2: Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit	68
Treguesi 6.3: Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në procesin e konsultimit	69
Treguesi 6.4: Numri i pjesëmarrësve kontribues në procesin e konsultimit	71
Treguesi 6.5: Numri i komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve	72
Treguesi 6.6: Kategorizimi i të dhënave të raportuara për angazhimin qytetar për çdo projektakt të konsultuar	74
Treguesi 6.7: Kategorizimi i të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar	76

REKOMANDIMET **78**

SHTOJCAT **80**

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Sistemi i pikëzimit	13
Tabela 2: Nivelet e shkallëzuara të performancës	14
Tabela 3: Reagimi institucional ndaj kërkesave për informim	17
Tabela 4: Treguesit e transparencës të renditur sipas pikëzimit, nga më i larti tek më i ulëti	19
Tabela 5: Performanca e institucioneve lidhur me transparencën	20
Tabela 6: Performanca lidhur me transparencën e dokumentacionit mbështetës të konsultimit, sipas projektakteve dhe institucioneve	22
Tabela 7: Performanca lidhur me transparencën e planeve vjetore të konsultimit, sipas institucioneve (2022-2023)	24
Tabela 8: Performanca lidhur me transparencën e planeve individuale të konsultimit, sipas projektakteve dhe institucioneve	25
Tabela 9: Performanca lidhur me transparencën e komenteve të mbledhura, sipas projektakteve dhe institucioneve	26
Tabela 10: Performanca e transparencës së raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik, për vitin 2022 dhe vitin 2023	28
Tabela 11: Performanca lidhur me transparencën e raporteve individuale të konsultimit publik, sipas projektakteve dhe institucioneve	30
Tabela 12: Treguesit e aksesueshmërisë të renditur sipas performancës, nga më i larti tek më i ulëti	31
Tabela 13: Performanca e institucioneve lidhur me aksesueshmërinë e dokumenteve	32
Tabela 14: Performanca e projektakteve bazuar në aksesin në njoftimet për konsultim, sipas projektaktit dhe institucionit	34
Tabela 15: Performanca e aksesit të dokumenteve të konsultimit, sipas projektaktit dhe institucionit	35
Tabela 16: Treguesit e efektivitetit të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti	36
Tabela 17: Performanca e institucioneve lidhur me efektivitetin e konsultimeve	37
Tabela 18: Numri i projektakteve bazuar në performancën e efektivitetit të konsultimit	37
Tabela 19: Performanca lidhur me përshtatshmërinë e afateve të konsultimit, për projektakt dhe institucion	38
Tabela 20: Performanca e shpërndarjes së konsultimeve gjatë vitit kalendarik për vitet 2022 dhe 2023, për institucion	40
Tabela 21: Performanca për miratimin në kohë të dokumenteve të konsultuara gjatë periudhës 2022–2023, për institucion	42
Tabela 22: Performanca për zbatimin e planeve vjetore të konsultimit për vitet 2022 dhe 2023, për institucion	43
Tabela 23: Performanca për vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes, për institucion	45
Tabela 24: Performanca për monitorimin e brendshëm të proceseve të konsultimit publik, për institucion	46
Tabela 25: Treguesit e llogaridhënies të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti	47
Tabela 26: Performanca e institucioneve lidhur me llogaridhënien për konsultimet	48
Tabela 27: Performanca për llogaridhënien në fazën e hartimit, për projektakt dhe institucion	49
Tabela 28: Përfshirja e projektakteve të monitoruara në dokumentet strategjike të qeverisë dhe planin vjetor të konsultimeve publike	51
Tabela 29: Performanca për ofrimin e arsyeve nga ana e institucioneve mbi komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht, për projektakt dhe institucion	52
Tabela 30: Performanca për vendosjen e procedurave për ankesat e qytetarëve kundrejt konsultimeve publike, për institucion	54
Tabela 31: Performanca për ofrimin e informacionit mbi demonstrimin e ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR, për institucion dhe projektakt	56

Tabela 32: Treguesit e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti	57
Tabela 33: Performanca e institucioneve lidhur me gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin	58
Tabela 34: Performanca për identifikimin paraprak të grupeve të ndikuara nga projektakti, për institucion dhe projektakt	60
Tabela 35: Performanca sa i përket larmisë së grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit, për institucion dhe projektakt	61
Tabela 36: Performanca sa i përket larmisë së grupeve pjesëmarrëse në konsultim, për institucion dhe projektakt	62
Tabela 37: Performanca sa i përket përshtatshmërisë së metodave të përzgjedhura të konsultimit	64
Tabela 38: Treguesit e pjesëmarrjes qytetare të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti	65
Tabela 39: Performanca e institucioneve lidhur me pjesëmarrjen qytetare	66
Tabela 40: Performanca sa i përket pjesëmarrjes qytetare në konsultime sipas numrit të projektakteve	66
Tabela 41: Performanca sa i përket krijimit të një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet	67
Tabela 42: Performanca bazuar te numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit gjatë periudhës 2022-2023, për institucion	69
Tabela 43: Performanca bazuar te numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në konsultime gjatë periudhës 2022-2023, për institucion	70
Tabela 45: Performanca bazuar te numri i komenteve të mbledhura në konsultime gjatë periudhës 2022-2023, për institucion	72
Tabela 47: Performanca bazuar te kategorizimi i të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar. për institucion	73
Tabela 48: Performanca e institucioneve për secilin parim, renditur nga performanca më e lartë tek ajo më e ulët	75
Tabela 49: Renditja e projektakteve sipas shumës së pikëve të fituara, renditur nga rezultati më i lartë tek ai më i ulët	77
Tabela 50: Performanca e procesit të konsultimit për çdo projektakt, e vlerësuar sipas secilit parim dhe e organizuar sipas institucionit propozues	80
Table 49: Ranking of draft acts by total points received, ranked from best scoring to worst	81
Table 50: Performance of the consultation process for each draft act, assessed according to each principle and organized by the proposing institution	84

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Renditja e parimeve bazuar në performancën e përgjithshme të institucioneve	11
Figura 2: Renditja e performancës së institucioneve bazuar në pikët e përgjithshme të marra nga secili institucion	11
Figura 3: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me transparencën.	20
Figura 4: Rezultatet e projektakteve për transparencën e dokumentacionit mbështetës të konsultimit	21
Figura 5: Transparenca e planeve vjetore të konsultimit publik për vitin 2022 dhe vitin 2023, sipas institucioneve	23
Figura 6: Numri i projektakteve bazuar në transparencën e planeve individuale të konsultimit	24
Figura 7: Numri i projektakteve sipas transparencës së komenteve të mbledhura	26
Figura 8: Numri i institucioneve sipas performancës së transparencës së raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik, për vitin 2022 dhe vitin 2023	27
Figura 9: Numri i projektakteve sipas performancës së transparencës së raporteve individuale të konsultimit publik	29
Figura 10: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me aksesin në dokumente	32

Figura 11. Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me aksesin në njoftime për konsultim	33
Figura 12: Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me aksesin në dokumentet e konsultimit	35
Figura 13: Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me përshtatshmërinë e afateve të konsultimit	38
Figura 14. Numri i institucioneve bazuar në performancën e shpërndarjes së konsultimeve gjatë vitit kalendarik	40
Figura 15: Numri i institucioneve bazuar në performancën lidhur me miratimin në kohë të projektakteve të konsultuara	41
Figura 17. Numri i institucioneve bazuar në performancën për vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes	43
Figura 18: Performanca institucionale për monitorimin e brendshëm të procesit të konsultimit publik	44
Figura 19: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me llogaridhënien	45
Figura 20: Performanca për llogaridhënien në fazën e hartimit, për çdo projektakt	48
Figura 21: Përfshirja e projektakteve në dokumentet strategjike të qeverisë dhe planin vjetor të konsultimeve publike	49
Figura 22: Ofrimi i arsyeve nga ana e institucioneve për komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht për projektakt	50
Figura 23: Performanca institucionale për vendosjen e procedurave për ankesat e qytetarëve kundrejt konsultimeve publike	52
Figura 24: Performanca e institucioneve lidhur me ofrimin e arsyeve për përjashtimin e projektakteve nga konsultimet publike, 2022–2023	53
Figura 25: Performanca për demonstrimin e ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR	54
Figura 26: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin në konsultimet publike	55
Figura 27: Performanca për identifikimin paraprak të grupeve të ndikuara nga projektakti	58
Figura 28: Performanca sa i përket larmisë së grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit	59
Figura 29: Performanca sa i përket larmisë së grupeve pjesëmarrëse në konsultimin për projektaktet	60
Figura 30: Performanca sa i përket përshtatshmërisë së metodave të përzgjedhura të konsultimit për çdo projektakt	62
Figura 31: Performanca e institucioneve sa i përket krijimit të një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet	63
Figura 32: Performanca e institucioneve sa i përket numrit të pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit	67
Figura 33: Numri i institucioneve duke u bazuar te performanca për sigurimin e pjesëmarrësve joqeveritarë në procesin e konsultimit	68
Figura 34: Performanca e institucioneve për sigurimin e përfshirjes së pjesëmarrësve kontribues në proceset e konsultimit	70
Figura 35: Performanca e institucioneve sa i përket mbledhjes së komenteve gjatë konsultimeve	71
Figura 36: Performanca për kategorizimin e të dhënave të raportuara për pjesëmarrjen qytetare, për projektakt	73
Figura 37: Performanca sa i përket kategorizimit të të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar	74
	76

LISTA E SHKURTESAVE

AMBU	Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore
KI	Kërkesa për Informim
KM	Këshilli i Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PPAP	Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve
RENJKP	Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator

RËNDËSIA E MONITORIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje - një tipar kyç i shoqërive demokratike - ndihmon në përfshirjen e këndvështrimeve të ndryshme gjatë diskutimit të akteve ligjore dhe politikave qeveritare me ndikim në jetën e përditshme. Një prej metodave të nxitjes së kësaj pjesëmarrjeje është zhvillimi i konsultimeve publike, të cilat sigurojnë që veprimet qeveritare të jenë në harmoni me nevojat dhe pritshmëritë e publikut të gjerë.

Monitorimi i procesit të konsultimit ka rëndësi thelbësore për disa arsye. Së pari, përmirëson transparencën, duke parandaluar vendimet e marra pa mbikëqyrje publike. Kjo mbikëqyrje mund të përforcojë më tej angazhimin e qytetarëve përmes identifikimit të vështirësive që lidhen me pjesëmarrjen dhe zbatimin e strategjive për garantimin e përfshirjes.

Monitorimi i efektshëm mund të përmirësojë edhe cilësinë e vendimmarrjes. Ai siguron që vendimet e qeverisë të mbështeten në të dhëna dhe të mos ndikohen nga interesat e ngushtë politikë apo grupet me pushtet. Së fundmi, ai nxit llogaridhënie më të lartë nga qeveria, duke u lejuar qytetarëve të shohin sa të përfaqësuar dhe të dëgjuar janë.

Për këto arsye, monitorimi i procesit të konsultimit publik në Shqipëri është kritik për sigurimin e proceseve vendimmarrëse të drejta, përfshirëse dhe të efektshme, duke ndihmuar kështu në forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e cilësisë së kuadrit ligjor dhe vendimeve të qeverisë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përsa i përket **transparencës**, institucionet në tërësi u vlerësuan me 256 nga 480 pikë të mundshme (53%), duke e bërë transparencën parimin e dytë me vlerësimin më të lartë nga parimet e vlerësuara. Relacionet shpjeguese për ligjet e propozuara shpesh publikohen, së bashku me projektaktin që është në proces konsultimi, por shumica e institucioneve nuk publikojnë materiale mbështetëse shtesë. Planet vjetore të konsultimeve janë përgjithësisht transparente, por kur kjo nuk ndodh, ato shpesh nuk vihen në dispozicion as pas kërkesave për informim. Po ashtu, transparenca e planeve individuale të konsultimeve për secilin projektakt ka mangësi. Ndërsa transparenca e komenteve të mbledhura nga palët e interesuara është mbi mesataren, disa nga institucionet e monitoruara nuk kanë publikuar komentet e marra gjatë takimeve të konsultimit. Për më tepër, raportimi i kontributeve nga aktorët joqeveritarë në procesin e konsultimeve është shpesh i paqartë dhe paraqitet i bashkuar me kontributin e aktorëve qeveritarë.

Sa i përket **aksesueshmërisë** së dokumenteve të konsultimeve publike, institucionet grumbulluan 141 nga 200 pikë të mundshme (71%). Njoftimet për konsultimet publike zakonisht publikohen si në RENjKP, ashtu edhe në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Megjithatë, disa prej faqeve të internetit të institucioneve nuk kanë një seksion të dedikuar për konsultimet publike dhe njoftimet përkatëse. Dokumentet e monitoruara, të cilat ishin kryesisht me bazë teksti, ishin në formate të aksesueshme për shumicën e kompjuterëve dhe përdoruesve të zakonshëm. Dokumentet (e rralla) që përmbanin më shumë të dhëna, si buxhetet e projekteve, ishin në formate Excel, duke i lejuar palët e interesuara t'i shkarkonin dhe t'i përdornin në mënyrë të pavarur. Megjithatë, herë pas here kishte probleme të tilla si mungesa ose fshirja e dokumenteve të publikuara më parë, si dhe mungesa e përkthimit për materiale që ishin të publikuara pjesërisht në anglisht. Përtej aksesueshmërisë së dokumenteve, problematikat kryesore lidhen me aksesueshmërinë e procesit të konsultimit në përgjithësi, trajtuar më poshtë tek parimi i gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Sa i përket **efektivitetit** të konsultimit publik, institucionet morën 108 nga 260 pikë të mundshme (42%), duke e renditur këtë parim të tretin në vlerësim. Edhe pse afati minimal i konsultimit prej 20 ditësh pune respektohet në shumicën e rasteve, mungon fleksibiliteti për dokumentet më komplekse dhe voluminoze. Për më tepër, disa institucione priren t'i përqendrojnë konsultimet e tyre në muaj të caktuar, duke krijuar periudha të gjata pa aktivitet dhe periudha të tjera kur disa konsultime zhvillohen njëkohësisht. Planifikimi i dobët evidentohet gjithashtu nga vonesat në miratimin e akteve dhe realizimi i kufizuar i planeve vjetore të konsultimit. Gjithashtu, vërehet mungesa e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm të konsultimeve për të matur efektivitetin e tyre, përfshirë publikimin e raporteve përkatëse të monitorimit.

Përsa i përket **llogaridhënies**, institucionet morën gjithsej vetëm 148 pikë nga 460 të mundshme (32%). Vihet re një mungesë e informacionit të plotë mbi procesin e hartimit të dokumenteve ligjore ose të politikave, si dhe një përfshirje e kufizuar e aktorëve joqeveritarë në këtë fazë. Edhe kur ofrohet informacion mbi konsultimet paraprake, aktorët joqeveritarë shpesh përmenden nën terma të gjerë dhe nuk identifikohen konkretisht. Teksa shumë konsultime përfshihen në planet vjetore dhe strategji qeveritare, disa prej tyre nuk planifikohen paraprakisht, duke e bërë të paqartë origjinën e projektakteve. Institucionet rrallëherë prodhojnë përmbledhje të detajuara (tabela) të komenteve të marra gjatë konsultimeve, por kur kjo ndodh, ato priren të jenë gjithëpërfshirëse. Duhet të theksohet se asnjë nga institucionet e monitoruara nuk kishte publikuar procedura të qarta për qytetarët, që këta të fundit të kenë mundësinë të paraqesin ankesa lidhur me proceset e konsultimit. Për më tepër, nuk u gjet asnjë provë për arsyet që qëndrojnë pas përjashtimit të disa akteve specifike nga konsultimet publike. Në përgjithësi, hartimi dhe publikimi i raporteve të vlerësimit të ndikimit rregullator nuk është praktikë e zakonshme në institucionet e monitoruara, përveç rasteve të projektligjeve. Edhe kur ato janë të disponueshme, rrallëherë përfshijnë informacion mbi mënyrën se si konsultimet publike kanë ndikuar në vlerësimin e ndikimit.

Institucionet performuan dobët në parimin e **gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit**, duke marrë 129 pikë nga 400 të mundshme (32%). Institucionet ishin relativisht të kujdesshme në përzgjedhjen e metodave të duhura të konsultimit për aktet, ndërsa shumica e tyre mbështeten vetëm në konsultimet

elektronike – të cilat nuk janë të aksesueshme në mënyrë të barabartë nga të gjithë. Megjithatë, grupet e interesit që priten të preken nga legjislacioni rrallëherë identifikohen paraprakisht në dokumentet e konsultimit. Për më tepër, në përgjithësi mungojnë evidencat për pjesëmarrjen e aktorëve joqeveritarë si gjatë fazës së hartimit, ashtu edhe gjatë fazës së konsultimit.

Pjesëmarrja qytetare ishte parimi me vlerësimin më të ulët, me vetëm 69 pikë nga 320 të mundshme (22%). Përfshirja e aktorëve joqeveritarë në fazat e hershme të hartimit të ligjeve dhe politikave është një praktikë e rrallë. Edhe kur një përfshirje e tillë ndodh, rrallë arrihet një angazhim i mirëfilltë. Institucionet zakonisht ofrojnë vetëm të dhëna të agreguara për pjesëmarrësit në fazat e hartimit ose konsultimit, duke mos bërë dallim midis grupeve të ndryshme të interesit (p.sh., qytetarë, konsulencia teknike ose autoritete publike), gjë që shtrembëron saktësinë e të dhënave mbi pjesëmarrjen qytetare. Në raportet individuale të konsultimeve shpesh mungojnë përshkrimet e detajuara të metodave të përdorura ose të dhëna të disagreguara për pjesëmarrjen. Këto mangësi pasqyrohen edhe në raportet gjashtëmujore dhe vjetore, të cilat mbështeten në plotësinë e raporteve individuale të konsultimeve. Është tregues pozitiv fakti që shumica e institucioneve tashmë kanë publikuar datatbazat e ekspertëve dhe grupeve të interesit, duke e bërë këtë një praktikë standarde.

Figura 1: Renditja e parimeve bazuar në performancën e përgjithshme të institucioneve





Figura 2: Renditja e performancës së institucioneve bazuar në pikët e përgjithshme të marra nga secili institucion



KUADRI METODOLOGJIK

Metodologjia për monitorimin e proceseve të konsultimit publik të qeverisë vlerëson:

- a. nivelin e transparencës institucionale gjatë proceseve të konsultimit;
- b. nivelin e llogaridhënies publike gjatë proceseve të konsultimit;
- c. aksesin në dokumentacionin e paraqitur gjatë konsultimeve;
- d. efektivitetin dhe ndikimin e konsultimeve publike në vendimmarrje;
- e. shkallën e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të qytetarëve;
- f. garantimin e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Hartimi i kësaj metodologjie monitorimi u krye në katër faza kryesore. Faza e parë nisi me shqyrtimin e kuadrit ligjor dhe rregullator që trajton proceset e konsultimit publik, i cili përfshin:

- Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 828/2015 “Për miratimin e rregullave për ngritjen dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 584/2003 “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”;
- Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave Nr. 3/2021 “Për miratimin e udhëzimeve për procesin e konsultimit publik”.

Gjatë kësaj faze, ekipi i ekspertëve i përbërë nga juristë të nivelit të lartë dhe stafi i IDM-së me përvojë në hartimin dhe zbatimin e metodologjive të monitorimit qytetar, identifikoi kërkesat ligjore bazë, si dhe standardet shtesë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, të cilat duhet të zbatohen nga institucionet publike në kuadër të konsultimeve për projektligje apo politika publike.

Faza e dytë u përqendrua në përcaktimin e qasjes metodologjike, bazuar në parimet themelore të transparencës, llogaridhënies, efektivitetit, aksesueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Në këtë kuadër u hartuan tregues performance për secilin këto parime, me qëllim përcaktimin e një sistemi objektiv të pikëzimit, sipas të cilit vlerësohet performanca e institucioneve të monitoruara gjatë konsultimit publik të projektakteve të ndryshme (shpjegohet më hollësisht më poshtë).

Gjatë fazës së tretë, metodologjia u përsos më tej përmes konsultimeve me palë të ndryshme interesi, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë dhe përfaqësues të institucioneve publike, kontributi i të cilëve është përfshirë në metodologji.

Pas hartimit të dokumentit të konsoliduar, hulumtuesit e IDM-së ndërmorën fazën e testimit të metodologjisë me një kampion të vogël me dy institucione dhe 10 projektakte të konsultuara. Gjetjet e fazës së testimit mundësuan përshtatje të mëtejshme të metodologjisë, duke dhënë kontribut në hartimin e variantit përfundimtar të zbatuar në për hartimin e këtij raporti monitorimi.

SISTEMI I PIKËZIMIT

Kuadri metodologjik bazohet në gjashtë parime themelore të procesit të konsultimit publik: transparenca, llogaridhënia, efektiviteti, aksesueshmëria, gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi, si dhe pjesëmarrja qytetare. Secili parim vlerësohet në bazë të një grupi treguesish performance. Nga 31 treguesit e hartuar gjithsej, 15 prej tyre vlerësohen çdo vit ose në nivel institucional gjatë periudhës dyvjeçare të monitorimit, ndërsa 16 të tjerët vlerësohen për aktet individuale të konsultuara nga institucionet (shihni Tabelën 1).

Tabela 1: Sistemi i pikëzimit

Parimi	Treguesi	Pikët maksimale për tregues	Pikët maksimale për parim	Niveli i performancës		
				Niveli i lartë i performancës (>80%)	Niveli mesatar i performancës (40%–80%)	Niveli i ulët i performancës (<40%)
Transparenca	1.1	10	48 pikë	Më shumë se 38,4 pikë	Ndërmjet 19,2 dhe 38,4 pikë	Më pak se 19,2 pikë
	1.2	4				
	1.3	10				
	1.4	10				
	1.5	4				
	1.6	10				
Akses-ueshmëria	2.1	10	20 pikë	Mbi 16 pikë	Ndërmjet 8 dhe 16 pikë	Më pak se 8 pikë
	2.2	10				
Efektiviteti	3.1	10	26 pikë	Mbi 20,8 pikë	Ndërmjet 10,4 dhe 20,8 pikë	Më pak se 10,4 pikë
	3.2	4				
	3.3	4				
	3.4	4				
	3.5	2				
	3.6	2				
Llogaridhënia	4.1	10	46 pikë	Mbi 36,8 pikë	Ndërmjet 18,4 dhe 36,8 pikë	Më pak se 18,4 pikë
	4.2	10				
	4.3	10				
	4.4	2				
	4.5	4				
	4.6	10				

Parimi	Treguesi	Pikët maksimale për tregues	Pikët maksimale për parim	Niveli i performancës		
				Mbi 32 pikë	Ndërmjet 16 dhe 32 pikë	Më pak se 16 pikë
Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi	5.1	10	40 pikë	Mbi 32 pikë	Ndërmjet 16 dhe 32 pikë	Më pak se 16 pikë
	5.2	10				
	5.3	10				
	5.4	10				
Pjesëmarrja qytetare	6.1	2	32 pikë	Mbi 25,6 pikë	Ndërmjet 12,8 dhe 25,6 pikë	Më pak se 12,8 pikë
	6.2	4				
	6.3	4				
	6.4	4				
	6.5	4				
	6.6	10				
		4				

Sistemi i pikëzimit lejon përlogaritjen e indeksit të konsultimit publik, si raport të pikëzimit të përfutur nga monitorimi me maksimumin e pikëve të mundshme për secilin institucion.

Varianti i detajuar i metodologjisë së monitorimit, përfshirë matricën e vlerësimit që përvijon edhe arsyetimin e pikëzimit për secilin tregues, është i disponueshëm në [faqen e internetit](#)¹ të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Integrimi i tabelës së shkallëzuar (shihni Tabelën 2 më poshtë) në sistemin e vlerësimit, pasqyron situatën e zbatimit të proceseve të konsultimit publik në secilin institucion. Nivelet e performancës janë klasifikuar në tre kategori kryesore: nivel i ulët, i mesëm dhe i lartë, bazuar në pikëzimit e përgjithshëm të arritur nga secili institucion.

Tabela 2: Nivelet e shkallëzuara të performancës

Rezultati i përgjithshëm	Niveli i performancës institucionale	Spektri i përqindjeve bazuar në numrin e pikëve totale	Numri i mundshëm i pikëve
Më pak se 84,8 pikë	I ulët	Më pak se 40%	212 pikë
Ndërmjet 84,8 dhe 169,6 pikë	I mesëm	Ndërmjet 41%-80%	
Mbi 169,6 pikë	I lartë	Mbi 80%	

1 <https://idmalbania.org/publication-cpt/monitoring-methodology-for-public-consultation-at-the-central-government-level/>

KAMPIONIMI I INSTITUCIONEVE DHE PROJEKTAKTEVE TË MONITORUARA

Ky proces monitorimi përfshiu 10 institucione të qeverisjes qendrore, që përbëjnë më shumë se gjysmën (56%) e institucioneve që kanë kryer konsultime publike në periudhën 2022-2023. Për secilin prej tyre, u përzgjedh një numër i barabartë projekta (pesë), që do të thotë se për periudhën 2022 - 2023 u monitoruan gjithsej 50 projektakte. Nga këto, 19 ishin dokumente strategjike, politika, ose vendime të Këshillit të Ministrave, ndërsa 31 ishin projektligje. Kampioni i përgjithshëm i projektakteve për këtë proces monitorimi është i barabartë me 62% të mesatares së akteve që iu nënshtruan konsultimit publik në periudhën 2022 - 2023.

Për përzgjedhjen e institucioneve dhe projektakteve për monitorim u zbatuan kriteret e mëposhtme.

KRITERET E ZBATUARA PËR PËRZGJEDHJEN E INSTITUCIONEVE:

- **Volumi i veprimtarisë ligj hartuese/politikëbërëse të institucionit**, që pasqyron nivelin e angazhimit institucional në procese ligjvënëse dhe politikëbërëse;
- **Shpeshtësia e konsultimeve publike të organizuara nga institucioni**, që ofron informacion për praktikën e institucionit lidhur me konsultimet;
- **Gjerësia e fushës së përgjegjësive të institucionit, që thekson ndikimin e vendimmarrjes së institucioneve mbi audiencën dhe sektorë të shumëllojshëm;**
- **Interesi i krijuar tek aktorët joqeveritarë**, që tregon nivelin e interesit publik për proceset e konsultimit të institucioneve;
- **Shumëllojshmëria e institucioneve**, që siguron përfshirjen e një larmie institucionesh me përgjegjësi të gjera dhe të veçanta, apo agjenci qendrore;
- **Përfaqësimi i institucioneve të përzgjedhura**, që garanton që kampioni të përfshijë më shumë se gjysmën e institucioneve që kanë kryer konsultime publike gjatë 2022-2023.

KRITERET E ZBATUARA PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTAKTEVE:

- **Rëndësia strategjike**, për të siguruar përfshirjen e projektakteve me rëndësi të lartë, si ato që kanë të bëjnë me reforma kyçe sektoriale ose qeveritare;
- **Interesi publik**, reagimet dhe komentet për projektakte të caktuar, si tregues për nivelin e ndjeshmërisë dhe angazhimit;
- **Shumëllojshmëria e natyrës dhe përmbajtjes**, për të siguruar përfshirjen e një game të gjerë projekta, dokumentesh teknike, ligjesh të përgjithshme, projekta strategjike, dhe vendimesh qeveritare;
- **Ndikimi mbi grupe të popullsisë**, për të siguruar përfshirjen e projektakteve që kanë ndikim të konsiderueshëm mbi demografi të ndryshme, veçanërisht mbi grupet vulnerabël ose komunitete të caktuara;
- **Përfaqësueshmëria e projektakteve të përzgjedhura**, për të siguruar që aktet e zgjedhura për kampionin të përbënin më shumë se gjysmën e projektakteve të nënshtruara konsultimit publik gjatë periudhës së përcaktuar.

MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Procesi i monitorimi u krye në periudhën mars-qershor 2024. Ekipi i monitorimit përdori dy instrumente kryesore për mbledhjen e të dhënave:

I: SHQYRTIMI I LITERATURËS:

Këtu përfshihet konsultimi i burimeve publike të informacionit pa kërkesë të drejtpërdrejtë ndaj institucioneve, duke përfshirë:

- Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP);
- Faqet zyrtare dhe Programet e Transparencës së institucioneve publike të monitoruara;
- Fletoren Zyrtare për vitin 2022 dhe vitin 2023;
- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 - 2024;
- Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitet 2022 dhe 2023;

Ndërkohë, disa prej dokumenteve kyçe të shqyrtuara për secilin institucion dhe projektaktet e monitoruara përfshinë: raportet vjetore dhe gjashtë mujore të konsultimit publik, raportet individuale të konsultimeve publike, planet vjetore të konsultimit publik, planet individuale të konsultimit publik, si dhe materialet mbështetëse për secilin projektakt të konsultuar, si relacionet shpjeguese, raportet e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR), dhe tabelat e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Gjatë shqyrtimit të literaturës, ekipi i monitorimit identifikoi shumë raste në të cilat mungonin të dhëna statistikore të disagreguara (katëgorizuara) për pjesëmarrjen dhe kontributin e aktorëve joqeveritarë. Kjo mangësi erdhi si pasojë e vënies në dispozicion të të dhënave të përmbledhura nga institucionet, që nuk bënë dallim ndërmjet palëve qeveritare dhe joqeveritare të interesit që kanë marrë pjesë në konsultim. Pas identifikimit të këtyre rasteve, kërkuesit nxorën manualisht të dhënat nga raportet individuale të konsultimit me qëllim përlogaritje e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve joqeveritarë, së bashku me numrin e komenteve dhe kontributeve të tyre çdo vit. Këto të dhëna u analizuan më tej me qëllim vlerësimin e treguesve përkatëse të lidhur me të dhënat statistikore të pjesëmarrjes qytetare.

II: KËRKESAT PËR INFORMIM

Duke qenë se metodologjia kërkon edhe disa kategori informacioni për të cilat institucionet publike nuk kanë detyrime publikimi, u dërguan edhe kërkesa zyrtare për informacion. Pas punës kërkimore për identifikimin e mangësive të të dhënave ose dokumentacionit të pa publikuar, 10 kërkesa për informim publik u dërguan tek institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Brendshme (MB)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
- Këshilli i Ministrave (KM)
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

Në përgjithësi u vu re se kategori të caktuara informacioni nuk publikohen në mënyrë proaktive nga shumica e institucioneve. Për shembull, nuk publikohej informacion nëse institucioni monitoronte efektivitetin e metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes, përmes anketave të posaçme për shembull, shoqëruar me rezultatet përkatëse dhe masat e marra. Vetë raportet e monitorimit të konsultimit nuk ishin publike. Për më tepër, në përgjithësi mungonin informacione mbi fazën e hartimit të projektakteve, përfshirë konsultimet paraprake dhe informacionin për grupin e punës përgjegjës për hartimin. Gjithashtu, informacioni lidhur me arsyetimin për përjashtimin e projektakteve të caktuara nga procesi i konsultimit, ndikimin e konsultimeve mbi VNR, si dhe për analizat e palëve të interesit që mund të jenë kryer përpara konsultimeve, ishte i pamjaftueshëm. Ndërkohë që mungesa e këtij dokumentacioni duket se lidhet kryesisht me mungesën e detyrimit ligjor për t'i hartuar apo për t'i bërë ato publike, duhet theksuar se këto kërkesa përfshihen në aktet rregullatore dhe udhëzimet që trajtojnë proceset politikëbërëse të qeverisë qendrore.

Si pasojë, këto kategori informacion u kërkuan përmes 10 kërkesave për informim (KI) nga ana e ekipit të monitorimit. Megjithëse u morën gjithsej 9 përgjigje zyrtare, 8 prej tyre nuk i trajtonin tërësisht pyetjet e shtruar. Shumica e institucioneve vunë në dispozicion linqe që të dërgonin në dokumente tashmë publike, të cilat nuk e përmbanin informacionin e kërkuar. Për më tepër, vetëm 6 nga 9 institucionet që iu përgjigjën kërkesave për informim e respektuan afatin ligjor prej 10 ditësh pune. Një prej institucioneve, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk iu përgjigj kërkesës në fjalë. Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme ishte i vetmi institucion që iu përgjigj pjesës më të madhe të pyetjeve. Për shembull, institucioni vuri në dispozicion të dhëna për aktorët joqeveritarë të përfshirë në proceset e konsultimit, reagimet e marra, kanalet e njoftimit të përdorura për konsultimin e projektakteve të ndryshme, informacion për fazën e hartimit, si dhe dokumente të brendshme, përfshirë indeksin e treguesve institucionalë të performancës. Paraqitja pamore e nivelit të përgjigjes ndaj KI-ve jepet në Tabelën 3 më poshtë. Në këtë tabelë, ngjyra e kuqe përfaqëson moskthim përgjigje, mostrajtim të pyetjeve, ose mospërbushje të afateve ligjore; ngjyra e verdhë përfaqëson përgjigje të kufizuar; ngjyra e gjelbër e çelur përfaqëson përgjigje të pjesshme; dhe ngjyra e gjelbër përfaqëson përgjigje të plotë dhe në kohë, në përputhje me afatet ligjore.

Tabela 3: Reagimi institucional ndaj kërkesave për informim

Institucioni	Marrje përgjigje për kërkesën	Trajtimi i kërkesës	Respektimi i afatit ligjor
1. Ministria e Brendshme			
2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural			
3. Ministria e Drejtësisë			
4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit			
5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë			

Institucioni	Marrje përgjigje për kërkesën	Trajtimi i kërkesës	Respektimi i afatit ligjor
6. Këshilli i Ministrave			
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë			
8. Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore			
9. Ministria e Arsimit dhe Sportit			
10. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale			

Pas përfundimit të fazës së mbledhjes së të dhënave, performanca e secilit tregues u vlerësua nga një ekip prej gjashtë hulumtuesish. Për këtë proces u përdor një matricë e dedikuar, e cila përfshinte edhe seksione narrative për shënime lidhur me praktikën e mirë dhe problemet sistematike, si dhe për burimet konkrete të informacionit. Rezultatet e procesit të pikëzimit iu nënshtruan dy raundeve shqyrtimi nga hulumtuesit e nivelit të lartë në IDM. Së fundmi, me qëllim hartimin e raportit të monitorimit, autorët përdorën 10 matricat e plotësuara, nga një për secilin prej 10 institucioneve.

PARIMI I: TRANSPARENCA E KONSULTIMEVE PUBLIKE

Transparenca proaktive dhe e vazhdueshme është kërkesë ligjore për institucionet shqiptare në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit. Kur bëhet fjalë për proceset e konsultimit, transparenca dhe vënia e dokumentacionit të konsultimit në dispozicion në kohë garanton që publiku të ketë informacionin e nevojshëm lidhur me vendimmarrjen e propozuar dhe të ketë mundësi të marrë pjesë i informuar.

PERFORMANCA SIPAS TREGUESVE TË TRANSPARENCËS

Sa i përket treguesve të transparencës, 10 institucionet e monitoruara patën rezultatet më të mira lidhur me publikimin e planeve vjetore të konsultimit publik (70%). Shumica e treguesve të tjerë patën rezultate mbi mesataren, si transparenca e komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve (64%), hartimi i raporteve vjetore (60%) dhe individuale të konsultimeve publike (60%), dhe publikimi i paketës me dokumentacion mbështetës për procesin e konsultimit (58%). Treguesi me performancën më të dobët kishte të bënte me publikimin e planeve individuale të konsultimit publik, që rezultoi në 29%.

Tabela 4: Treguesit e transparencës të renditur sipas pikëzimit, nga më i larti tek më i ulëti

1.	Publikimi i planit vjetor të konsultimit publik	70%
2.	Transparenca e komenteve të mbledhura nga institucionet	64%
3.	Publikimi i raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik	60%
4.	Publikimi i raporteve individuale të konsultimit publik	60%
5.	Transparenca e paketës së dokumentacionit mbështetës për konsultimin publik	58%
6.	Publikimi i planit individual të konsultimit publik	29%

KRAHASIMI I INSTITUCIONEVE LIDHUR ME TRANSPARENCËN

Në të 10 institucionet, transparenca ishte parimi i dytë me pikëzimin më të lartë, me 256 nga 480 pikë gjithsej. Megjithatë, përqindja e përgjithshme e vlerësimit për parimin e transparencës në 10 institucionet e monitoruara ishte pak më lart mesatares (53%). Nga 10 institucionet, ato që patën rezultate më të mira lidhur me transparencën ishin Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Këshilli i Ministrave (me pikëzim 88%, 73% dhe 67% përkatësisht). Nga ana tjetër, rezultatet më të ulëta lidhur me transparencën ishin të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore (4%, 35% dhe 42% përkatësisht). Ndërkohë, performanca e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (63%), Ministrisë së Drejtësisë (58%), Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (54%), dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (50%) ishte pak a shumë mesatare.

Tabela 5: Performanca e institucioneve lidhur me transparencën


Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Transparencën (Max. 48)	32	28	17	42	30	20	26	2	24	35
Përqindja për Transparencën	67%	58%	35%	88%	63%	42%	54%	4%	50%	73%
Total										256/480 (53%)

KRAHASIMI I PERFORMANCËS PËR TRANSPARENCËN NË KUADËR TË LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË MONITORUARA

Ndër 50 projektaktet e monitoruara, rezultati më i zakonshëm ishte pesë nga tetë pikë të mundshme për transparencën e proceseve të tyre të konsultimit publik, me 10 projektakte gjithsej që morën këtë rezultat. Tetë projektakte të tjera u vlerësuan me gjashtë pikë. Gjashtë dokumente gjithsej (tre projektligje dhe tre VKM ose dokumente strategjike kombëtare) morën rezultatin maksimal prej tetë pikësh; dy projektakte morën shtatë pikë; ndërsa pesë dokumente (tre projektligje dhe dy VKM ose dokumente strategjike kombëtare) nuk morën pikë për transparencën. 19 projektaktet e tjera morën nga një deri në katër pikë.

Projektaktet me pikëzimin më të lartë për transparencën përfshijnë projektligje si ‘Projektligji për Zbatimin e Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesit’, VKM si ‘Vendimi për miratimin e planit të emergjencave për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë’ dhe dokumente strategjike kombëtare si ‘Programi i Reformave Ekonomike 2023 - 2025’. Nga ana tjetër, projektaktet që nuk morën pikën për transparencën gjatë konsultimit përfshinin projektligje si ‘Projektligji për Ndhmën Shoqërore në Republikën e Shqipërisë’ dhe ‘Projektligji për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale’, si dhe dokumentet strategjike kombëtare si ‘Dokumenti i politikave për politikën shoqërore’. Për më tepër, edhe disa projektakte që krijuan interes të konsiderueshëm publik dhe polemikë, si ‘Vendimi për Mbylljen e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive të saj’ dhe ‘Ligji për trajtimin e veçantë të studentëve në programin e integruar të studimit për mjekësi të përgjithshme në institucionet publike të arsimit të lartë’, nuk morën pikë për transparencë.

Figura 3: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me transparencën.



TREGUESI 1.1: PUBLIKIMI I PAKETËS SË DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS PËR KONSULTIMIN PUBLIK


Transparenca, përfshirë vënien në dispozicion në kohë të dokumentacionit mbështetës, përveç projektaktit objekt konsultimi, është thelbësore për t'i mundësuar publikut të gjithë informacionin për propozimin e hedhur për konsultim. Kjo qasje u lejon qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit të krijojnë mendime të informuara dhe t'i qasen informacionit praktik mbi mënyrat si mund të marrin pjesë dhe të japin kontribut në procesin e konsultimit. Publikimi i vetë projektaktit duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, si plani i konsultimit (i cili duhet të përfshijë edhe informacionin logjistik të pjesëmarrjes), raportin VNR, relacionin shpjegues (për projektligjet), tabelën e përputhshmërisë për aktet që synojnë të harmonizojnë legjislacionin e BE-së dhe dokumente të tjera si studime dhe vlerësime, sipas rastit. Për më tepër, duhet të publikohet edhe raporti individual i konsultimit publik pas përfundimit të procesit të konsultimit. Publikimi i dokumenteve të caktuara, si raportet dhe planet e konsultimit, përcaktohet si detyrim nga ligji për konsultimin publik. Kërkesa të tjera parashikohen nga udhëzime dhe akte rregullatore (p.sh. procesi i VNR-së) dhe rregullorja e Këshillit të Ministrave (p.sh. tabela e përputhshmërisë për dokumentet që synojnë të përafrojnë legjislacionin e BE-së).

Ky tregues vlerëson nëse këto dokumente mbështetëse janë publikuar së bashku me projektaktin e paraqitur për konsultim. Institucioneve iu dhanë dy pikë nëse vunë në dispozicion të gjithë dokumentacionin mbështetës gjatë procesit të konsultimit. Nëse u publikua vetëm një pjesë e dokumentacionit në fjalë, ato morën vetëm një pikë. Institucionet që nuk publikuan asnjë prej dokumenteve mbështetëse, ose publikuan vetëm projektaktin, nuk morën asnjë pikë. Duhet theksuar se ky vlerësim përjashtoi dokumente si planet apo raportet vjetore me qëllim shmangien e vlerësimit të dyfishtë, duke qenë se ato mbulohen në tregues të tjerë.

Përqindja e përgjithshme e rezultatit të këtij treguesi ishte 58%. Krahasuar me treguesit e tjerë të këtij parimi, transparenca e dokumentacionit mbështetës u rendit e pesta nga gjashtë tregues (në vend të parafundit). 18 nga 50 projektakte të monitoruara gjithsej morën pikët maksimale. 22 projektakte të tjera morë një pikë, ndërsa 10 projektakte nga 50 gjithsej, nuk morën asnjë pikë.

Figura 4: Rezultatet e projektakteve për transparencën e dokumentacionit mbështetës të konsultimit

Treguesi 1.1: Publikimi i dokumentacionit mbështetës të konsultimit



Institucioni me performancën më të mirë ishte Ministria e Brendshme (10 pikë nga 10 të mundshme), ndjekur nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave me tetë nga dhjetë pikë të mundshme përkatësisht. Pjesa tjetër e institucioneve morën rezultate mesatare (ndërmjet pesë dhe gjashtë pikë nga dhjetë të mundshme) me përjashtim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (4 pikë) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (0 pikë).

Tabela 6: Performanca lidhur me transparencën e dokumentacionit mbështetës të konsultimit, sipas projektakteve dhe institucioneve

Treguesi 1.1: Transparenca e paketës së dokumentacionit mbështetës për konsultimin publik										
Projekt-akti 1	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projekt-akti 2	2	2	2	2	1	1	1	0	0	2
Projekt-akti 3	1	2	1	2	1	1	1	0	2	2
Projekt-akti 4	1	1	1	2	1	1	2	0	2	0
Projekt-akti 5	2	2	0	2	1	1	1	0	1	2
Pikët totale	2	1	0	2	1	1	1	0	1	0
Total	8	8	4	10	5	5	6	0	6	6
									Pikët totale	58/100 ose 58%

Gjatë vlerësimit të transparencës së dokumentacionit mbështetës që shoqëron projektaktet e monitoruara, u identifikuan një sërë problematikash. Në rastin e disa projektakteve që përmendnin se përafrojnë plotësisht ose pjesërisht direktivat e BE-së, si projektligji për 'sigurinë kibernetike', 'prokurimin publik', 'bletërritjen', si dhe 'strategjia detare', shpesh mungonin tabelat e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Në raste të tjera, tabelat e përputhshmërisë ishin kryesisht të disponueshme në anglisht, siç ishte rasti i projektligjit për 'përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar'. Disa raporte VNR u publikuan vetëm pasi institucionet kishin marrë KI nga ekipi i monitorimit të IDM-së, ndërkohë që një prej këtyre VNR-ve u publikua plot dy vite pas përfundimit të procesit të konsultimit ('Projektligji për Titujt e Nderit në Republikën e Shqipërisë'). Në disa raste, VNR-të nuk ishin publike për projektligje të caktuara, edhe pse citoheshin në dokumente të tjera, si atë lidhur me 'Mbrotjen e të dhënave personale', 'Burimet ujore' dhe 'Lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë'. Në përgjithësi, duket sikur VNR-të hartohen në mënyrë rutinë për projektligjet, duke u hartuar rrallë për aktet nënligjore, si VKM apo strategjitë kombëtare. Kjo konfirmohet edhe nga përgjigjet e disa prej ministrive ndaj kërkesave për informacion.

Në raste të tjera, dokumentacioni mbështetës citonte studime ose analiza të kryera nga institucionet, të cilat nuk ishin publikuar. Për shembull, në 'Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23, Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore' përmendet se dokumenti është hartuar pas analizës së akteve ligjore dhe kapaciteteve institucionale, por kjo analizë nuk ishte e disponueshme gjatë periudhës së konsultimit. Po ashtu, në rastin e projektligjit 'Për faturat tregtare për produktet bujqësore', u theksuar se studimi ishte kryer bazuar në legjislacionin dhe praktikën aktuale, dhe në zbatimin e mundshëm të faturave tregtare (të njohura ndërkombëtarisht si 'Faturat e Kulturave' dhe 'Faturat e Magazinimit'), por as ky studim nuk u publikua.

Në përgjithësi, ndërkohë që relacionet shpjeguese ose dokumentacioni mbështetës për projektligjet publikohet në mënyrë kryesisht të rregullt, ka ende shumë raste në të cilat institucionet vënë në dispozicion vetëm projektaktin për konsultim pa ofruar materiale shtesë.


TREGUESI 1.2: TRANSPARENCA E PLANIT VJETOR TË KONSULTIMIT PUBLIK

Institucionet publike kanë detyrimin ligjor të hartojnë dhe të publikojnë plane vjetore për konsultimin publik. Këto plane rendisin të gjitha dokumentet që institucioni planifikon të konsultojë gjatë vitit në fjalë, ndërkohë që japin edhe informacionin e nevojshëm dhe afatet. Kur planet nuk publikohen, ose kur u mungon informacioni thelbësor, palët e interesit mund ta kenë të vështirë të monitorojnë dhe të marrin pjesë në procesin e konsultimit.

Ky tregues vlerëson nëse planet vjetore të konsultimit janë publikuar të plota dhe në këto raste janë dhënë pikë maksimale (dy pikë). Nëse planet vjetore ishin publikuar, por informacioni nuk ishte i plotë, u dha vetëm një pikë. Së fundmi, nuk u dhanë pikë për rastet kur planet vjetore të konsultimit nuk ishin publikuar fare nga institucionet përkatëse.

Figura 5: Transparenca e planeve vjetore të konsultimit publik për vitin 2022 dhe vitin 2023, sipas institucioneve

Treguesi 1.2: Transparenca e planit vjetor të konsultimit



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte 70%, duke e bërë këtë treguesin me rezultatin më të lartë në kategorinë e transparencës. Megjithatë, duhet theksuar se ky tregues është vlerësuar vetëm dy herë për secilin institucion, nga një herë për secilin vit (2022 dhe 2023). Për vitin 2022, pesë institucione morën pikë maksimale (dy), ndërsa pesë të tjera morën zero pikë për shkak se nuk kishin publikuar planet e tyre vjetore të konsultimit. Rezultatet e këtij treguesi u përmirësuan në vitin 2023 - vetëm Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mori zero pikë, ndërsa nëntë institucionet e tjera morën rezultatin maksimal prej dy pikësh për vitin në fjalë.

Institucionet që morën të gjitha pikët e mundshme për të dy vitet janë: Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Kjo tregon se publikimi i planeve vjetore të konsultimit është kthyer në praktikë të qëndrueshme për këto institucione.

Tabela 7: Performanca lidhur me transparencën e planeve vjetore të konsultimit, sipas institucioneve (2022-2023)

Treguesi 1.2: Publikimi i planit vjetor të konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	2	0	0	2	2	0	2	0	0	2
2023	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2
Pikë Gjithsej	4	2	2	4	4	2	4	0	2	4
									Pikë Gjithsej	28/40 ose 70%

Ndërkohë që transparenca në planet vjetore të konsultimit është përgjithësisht e lartë, është e rëndësishme të theksohet se rastet në të cilat planet nuk ishin të disponueshme publikisht, këto plane nuk u vunë në dispozicion edhe kur u kërkuan përmes KI-ve. Në disa raste, kur institucionet nuk publikuan planet e tyre vjetore të konsultimit, këto plane mund të merreshin përmes planit vjetor të konsultimit të publikuar nga Këshilli i Ministrave.


TREGUESI 1.3: PUBLIKIMI I PLANEVE INDIVIDUALE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Përveç planeve vjetore, udhëzimet për konsultimin publik u kërkojnë institucioneve të hartojnë dhe publikojnë plane individuale konsultimi për secilin dokument që i nënshtrohet konsultimit publik. Planet individuale përcaktojnë afatet e përcaktuara për konsultimet, audiencën e synuar, metodat e konsultimit, burimet e nevojshme, mënyrën e mbledhjes së kontributeve, si dhe veprimtaritë e monitorimit dhe vlerësimit. Transparenca e planeve individuale të konsultimit është thelbësore, sepse mund të sigurojnë një kuadër të strukturuar që garanton informimin e palëve të interesit dhe u mundëson të japin kontribut të efektshëm për procesin.

Ky tregues vlerëson nëse planet individuale të konsultimit janë publikuar dhe nëse janë të plota, për secilin prej projektakteve të monitoruara. Në rastet kur u plotësuan këto kushte, u dhanë pikët maksimale (2 pikë). Kur aktet individuale u publikuan po ishin të paplota, (për shembull kur mungonte informacioni logjistik për dëgjesat publike), u dha një pikë. Së fundmi, nuk u dhanë pikë për rastet kur planet individuale të konsultimit nuk ishin publikuar fare nga institucionet përkatëse.

Figura 6: Numri i projektakteve bazuar në transparencën e planeve individuale të konsultimit

Treguesi 1.3: Publikimi i planit individual të konsultimit



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte 29%, duke e bërë këtë treguesin me rezultatin më të ulët ndër treguesit e transparencës. Nga 50 dokumentet e monitoruara, shumica dërrmuese (34 projektakte) nuk morën asnjë pikë; 13 projektakte të tjera morën maksimumin e pikëve (2) dhe tre projektakte morën vetëm një pikë.

Kur merret në konsideratë performanca institucionale në kuadër të këtij treguesi, Ministria e Brendshme ishte institucioni i vetëm që mori të gjitha pikët e mundshme (10/10), ndjekur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (9 nga 10 pikë). Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk morën pikë për transparencën e planeve individuale të konsultimit publik. Pesë institucionet e tjera morën dy nga 10 pikët e mundshme për këtë tregues.

Tabela 8: Performanca lidhur me transparencën e planeve individuale të konsultimit, sipas projektakteve dhe institucioneve

Treguesi 1.3: Publikimi i planit individual të konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	0	0	2	2	0	0	0	0	2
Projektakti 2	0	1	0	2	0	0	0	0	0	1
Projektakti 3	0	1	0	2	0	0	2	0	0	2
Projektakti 4	0	0	0	2	0	0	0	0	2	2
Projektakti 5	0	0	0	2	0	2	0	0	0	2
Pikë Gjithsej	0	2	0	10	2	2	2	0	2	9
									Pikë Gjithsej	29/100

Gjatë vlerësimit të transparencës së planeve individuale të konsultimit, u vu re se në disa raste këto plane përfshiheshin me dokumentacionin e njoftimit ose shënimet shpjeguese. Megjithatë, shpesh mungonin disa elemente kyçe, përfshirë hollësitë për grupet e synuara në kuadër të procesit të konsultimit, si dhe informacionin logjistik për orarin dhe vendin e takimeve publike, ndër të tjera. Megjithatë, në disa raste, dokumentet e vëna në dispozicion përfshinin informacion gjithëpërfshirës, si konteksti, afatet, udhëzimet për mënyrën e dorëzimit të komenteve, dhe personat e kontaktit. Në përfundim, ndërkohë që transparencja e planeve individuale të konsultimit publik ishte në përgjithësi e ulët, vlen të theksohet se të paktën një prej institucioneve të monitoruara zbaton praktikë të qëndrueshme në këtë fushë.

TREGUESI 1.4: TRANSPARENCA E KOMENTEVE TË MBLEDHURA NGA INSTITUCIONET


Garantimi i transparencës së komenteve të mbledhura gjatë procesit të konsultimit është një detyrim ligjor që mundëson që të gjitha komentet që mblihen të jenë të disponueshme dhe t'i atribuohen grupeve përkatëse të interesit, duke krijuar besim dhe ofruar llogaridhënie mbi procesin.

Ky tregues vlerëson nëse institucionet kanë publikuar komentet e mbledhura përmes metodave të konsultimit dhe nëse kanë identifikuar qartë grupet e interesit që kanë bërë këto komente. Institucionet që përmbushën këto kritere morën të dy pikët e mundshme. Institucionet që raportuan qartë se nuk kishin marrë komente gjatë procesit të konsultimit, ndërkohë që analizonin e arsyet e mundshme për këtë situatë, morën gjithashtu dy pikë. Kjo siguroi që në këtë vlerësim institucionet të mos penalizohen për angazhimin e kufizuar publik. Institucionet që publikuan komentet e marra nga një metodë e

vetme konsultimi (duke përjashtuar metodat e tjera që janë përdorur), të cilat nuk identifikuan grupet e interesit që dhanë kontribut, ose raportuan se nuk kishin marrë komente pa analizuar arsyet përkatëse për këtë situatë, morën një pikë. Institucionet që nuk publikuan komentet dhe/ose nuk sqaruan mungesën e tyre nuk morën asnjë pikë.

Figura 7: Numri i projektakteve sipas transparencës së komenteve të mbledhura

Treguesi 1.4: Transparenca e komenteve të mbledhura



Përqindja e përgjithshme e rezultatit të institucioneve për këtë tregues është 64%, rezultat që renditet i dyti nga gjashtë treguesit e vlerësuar në kuadër të parimit të transparencës. Nga vlerësimi i transparencës së komenteve të mbledhura për 50 projektaktet e monitoruara, gjysma e tyre morën të gjitha pikët e mundshme (dy); 11 projektakte nuk morën asnjë pikë; dhe 14 projektakte morën një pikë.

Sa i përket vlerësimit të performancës institucionale për këtë tregues, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë morën të gjitha pikët e mundshme. Ato ndiqen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me 9 nga 10 pikë dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me 8 nga 10 pikë. Shumica e institucioneve të tjera morën nga pesë deri në gjashtë pikë, me përjashtim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela 9: Performanca lidhur me transparencën e komenteve të mbledhura, sipas projektakteve dhe institucioneve

Treguesi 1.4: Transparenca e komenteve të mbledhura										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	2	2	2	0	1	1	1	1	1	2
Projektakti 2	2	2	0	2	2	1	2	0	0	2
Projektakti 3	2	2	1	0	2	1	2	0	2	0
Projektakti 4	2	2	0	2	2	1	0	1	1	2
Projektakti 5	2	2	0	2	2	1	1	0	1	2
Pikët totale	10	10	3	6	9	5	6	2	5	8
									Pikët totale	64/100 (64%)

Ndërkohë që shumica e institucioneve arritën performancë mbi mesataren sa i përket transparencës së komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve të tyre, në praktikën e tyre u vunë re disa problematika. Për shembull, identifikimi i palëve të interesit që dhanë kontribut gjatë konsultimeve nuk ishte i qartë në disa raste dhe bëhej përmes termave të përgjithshëm si 'shoqëria civile', 'sindikatat', ose 'bashkitë'. Një shembull i këtyre rasteve është tabela e komenteve që shoqëron projektligjin për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Në një rast tjetër, pavarësisht organizimit të disa takimeve dhe tryezave lidhur me projektligjin për dëftesat tregtare për produktet bujqësore, komentet e marra prej tyre nuk u publikuan. Po ashtu, në rastin e projektligjit për burimet ujore, tabela e komenteve e përfshirë në raport ishte e paplotësuar. Raporti përmendte vetëm se komentet e marra në këto dëgjesa lidheshin me çështje të identifikuara gjatë procesit të zbatimit të legjislacionit.

Nga ana tjetër, kishte një sërë shembujsh pozitivë të institucioneve që publikojnë komentet e marra përmes metodave të ndryshme të konsultimit, përfshirë edhe përmes regjistrit elektronik dhe dëgjesave të konsultimit, ndërkohë që përfshinin edhe emrat e aktorëve që kishin dhënë kontribut dhe arsye për refuzimin e tyre. Një shembull i tillë ishte konsultimi për programin e reformave ekonomike.


TREGUESI 1.5: PUBLIKIMI I RAPORTEVE GJASHTËMUJORE DHE VJETORE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Institucionet kanë detyrimin ligjor të hartojnë dhe publikojnë raporte vjetore lidhur me veprimtaritë e tyre të konsultimit, ndërsa udhëzimet e konsultimit kërkojnë edhe raporte gjashtë mujore. Këto raporte duhet të përfshijnë informacion statistikor si të dhëna për rekomandimet dhe komentet e marra, të pranuar dhe të refuzuara; aktet e miratuara nga institucioni gjatë vitit në fjalë; informacione mbi dëgjesat dhe veprimtaritë e tjera të konsultimit; palët pjesëmarrëse; analizën e sfidave dhe risqeve të pranishme. Garantimi i nivelit të lartë të transparencës në këto raporte ofron llogaridhënie, duke u lejuar palëve të interesit të kuptojnë si/a përdoret kontributi i tyre, si dhe duke mundësuar vlerësimin e jashtëm të procesit të konsultimit.

Ky tregues vlerëson nëse institucionet e monitoruara kanë publikuar raportet e tyre gjashtë mujore dhe vjetore të konsultimit publik dhe nëse këto raporte përfshinin të gjithë informacionin e kërkuar. Institucionet që përmbushën të dy kriteret morën të dy pikët e mundshme. Kur ishte publikuar vetëm një prej raporteve, ose nëse raportet nuk ishin të plotë, ato morën një pikë. Institucionet nuk morën pikë nëse nuk kishin publikuar asnjërin prej raporteve. .

Figura 8: Numri i institucioneve sipas performancës së transparencës së raporteve gjashtë mujore dhe vjetore të konsultimit publik, për vitin 2022 dhe vitin 2023

Treguesi 1.5: Publikimi i raporteve gjashtë mujore dhe vjetore të konsultimit



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte 60%. Kjo do të thotë se transparencja e raporteve vjetore dhe gjashtëmujore të konsultimeve publike u rendit në vendin e tretë nga gjashtë treguesit e transparencës. Është e rëndësishme të theksohet se ky tregues u vlerësua dy herë për secilin institucion (çdo vit për vitet 2022 dhe 2023).

Gjatë vlerësimit të transparencës së siguar nga raportet gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik, katër nga 10 institucionet arritën rezultat maksimal me dy pikë për vitin 2022 dhe dy për vitin 2023. Këto ishin përkatësisht Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo tregon se këto institucione kanë krijuar praktika të qëndrueshme për publikimin e raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik. Nga ana tjetër, institucionet me rezultatet më të ulëta ishin Këshilli i Ministrave, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të cilat nuk morën pikë për asnjërin prej viteve. Institucionet e tjera morën nga dy deri në tre pikë nga katër për të dy vitet e monitorimit.

Tabela 10: Performanca e transparencës së raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik, për vitin 2022 dhe vitin 2023

Treguesi 1.5: Publikimi i raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	1	1	2	2	0	2	0	2	0
2023	0	2	2	2	2	0	2	0	2	2
Pikë gjithsej	0	3	3	4	4	0	4	0	4	2
									Pikë gjithsej	24/40 ose 60%

Gjatë vlerësimit të transparencës së raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të konsultimit publik u vu re se Këshilli i Ministrave kishte publikuar vetëm raporte të përgjithshme performance që trajtojnë konsultimet e kryera nga të gjitha institucionet qeveritare, pa publikuar raporte të veçanta për projektaktet që ka hartuar dhe konsultuar vetë institucioni. Për më tepër, agjenci qendrore si Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nuk kanë publikuar raporte gjashtëmujore ose vjetore të konsultimeve publike për vitin 2022 dhe vitin 2023. E njëjta problematikë u has me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto dokumente nuk u siguruan as pas kërkesës për informim. Në një rast, mungesa e raporteve gjashtëmujore vinte si pasojë e mos organizimit të konsultimeve publike gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik nga ana e institucionit në fjalë, përkatësisht Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2022. Në raste të tjera, raportet e konsultimit publik paraqiteshin të publikuara nga regjistrin elektronik dhe faqen e internetit të ministrisë, por linqet përkatëse nuk hapeshin, siç ishte edhe rasti i Ministrisë së Turizmit dhe asaj të Shëndetësisë lidhur me raportin e vitit 2022. Megjithatë, të paktën katër institucione duket se kanë praktikë të qëndrueshme për hartimin dhe publikimin e raporteve gjashtëmujore dhe atyre vjetore të konsultimeve publike, siç paraqitet në Tabelën 10.

TREGUESI 1.6: PUBLIKIMI I RAPORTEVE INDIVIDUALE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Përveç raporteve gjashtëmujore dhe vjetore për konsultimet publike, sipas udhëzimeve për konsultimet, institucionet duhet të hartojnë dhe të publikojnë raporte individuale për secilin konsultim që mbajnë - proces që kërkon përpjekje sistematike. Këto raporte duhet të sigurojnë detaje lidhur me rekomandimet dhe komentet e marra, të pranuar dhe të refuzuara për projektaktin e veçantë objekt konsultimi. Ato duhet të përfshijnë edhe informacion për takimet dhe veprimtaritë e tjera të konsultimit të kryera, listat e palëve të interesit pjesëmarrëse dhe analizat e vështirësive dhe risqeve të hasura. Qëllimi për këtë është mundësimi i mbikëqyrjes së jashtme, vlerësimi lidhur me shfrytëzimin e kontributit të publikut dhe vlerësimi i efektshmërisë së procesit të konsultimit.


Ky tregues vlerëson nëse institucionet e monitoruara kanë publikuar raporte konsultimi për secilin prej 50 projektakteve dhe nëse këto raporte përfshijnë informacionin e nevojshëm. Projektaktet që përmbushën të dy këto kriterë morën dy pikë. Nëse raportet ishin publikuar, por përfshinin informacion të paplotë, atyre iu dha një pikë. Së fundmi, institucionet nuk morën pikë nëse raportet individuale të konsultimit publik nuk ishin publikuar.

Performanca e përgjithshme për këtë tregues është 60%, duke u renditur i katërti nga gjashtë treguesit e transparencës.

Të dhënat treguan se institucionet publikuan raporte individuale të konsultimit publik për gjysmën e 50 projektakteve në fjalë, duke marrë pikëzimin maksimal prej dy pikësh. Ato morën nga 1 pikë për 14 projektakte, ndërkohë që nuk morën pikë për 11 projektakte, si pasojë e mospublikimit të raporteve individuale të konsultimit publik.

Figura 9: Numri i projektakteve sipas performancës së transparencës së raporteve individuale të konsultimit publik

Treguesi 1.6: Publikimi i raportit individual të konsultimit



Sa i përket performancës institucionale për këtë tregues, vetëm Këshilli i Ministrave arriti rezultatin maksimal. Ai u ndoq nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku secila u vlerësua me tetë nga 10 pikë. Pesë institucione të tjera morën rezultate mesatare nga katër deri në gjashtë pikë, ndërsa Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk mori asnjë pikë.

Tabela 11: Performanca lidhur me transparencën e raporteve individuale të konsultimit publik, sipas projektakteve dhe institucioneve

Treguesi 1.6: Publikimi i raporteve individuale të konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	2	2	2	1	2	2	0	0	1	2
Projektakti 2	2	2	1	2	2	1	1	0	0	2
Projektakti 3	2	0	2	1	0	1	2	0	2	0
Projektakti 4	2	2	0	2	2	1	0	0	2	2
Projektakti 5	2	2	0	2	2	1	1	0	0	0
Pikë Gjithsej	10	8	5	8	8	6	4	0	5	6
									Pikë Gjithsej	60/100 ose 60%

Në përfundim, ndërkohë që transparencën e raporteve individuale të konsultimit publik ishte në përgjithësi mbi mesataren, përforsimi i përpjekjeve institucionale në këtë fushë do të lehtësonte praktika më të mira të mbledhjes së të dhënave për konsultimet e organizuara gjatë vitit. Kjo më pas do të rriste cilësinë e raporteve vjetore të konsultimit, të cilat mbështeten kryesisht mbi të dhënat e raporteve individuale të konsultimit.

PARIMI II: AKSESUESHMËRIA NË DOKUMENTET E KONSULTIMIT

Aksesueshmëria është parim themelor në kontekstin e konsultimeve publike, duke qenë se siguron përfshirjen, barazinë dhe pasqyrimin e këndvështrimeve të grupeve shoqërore të shumëllojshme, të cilave proceset demokratike synojnë t'u shërbejnë. Eliminimi i pengesave ndaj pjesëmarrjes, qofshin këto fizike, digjitale apo socio-ekonomike, mundëson dëgjimin e një game më të gjerë zërash, veçanërisht ato të grupeve të marginalizuara. Kjo nuk përforcon vetëm legjitimitetin e procesit të konsultimit publik, por mundëson edhe besim dhe angazhim më të lartë të publikut. Për këto arsye, konsultimet kuptimplota duhet të përfshijnë të gjithë aktorët e interesit dhe ata të ndikuar nga vendimmarrja, dhe jo vetëm grupe që kanë angazhim rutinë me institucionin në fjalë.

Ndërkohë që aksesueshmëria nga këndvështrimi metodologjik këtu trajtohet duke u përqendruar veçanërisht në qasjen në dokumentacion, është e rëndësishme të theksohet se aspekte të tjera të aksesueshmërisë trajtohen në kuadër të treguesve të Parimit V: Gjithëpërfshirja dhe Mosdiskriminimi.

PERFORMANCA SIPAS TREGUESVE TË AKSESUESHMËRISË

Nga dy treguesit e lidhur me aksesueshmërinë, treguesi 2.2 (për aksesin në dokumentacion) kishte numrin më të lartë të pikëve, në kuadër të të cilit 50 projektaktet në fjalë arritën rezultat të përgjithshëm prej 81%. Nga ana tjetër, treguesi 2.1 (për aksesin në njoftimin e konsultimit) arriti gjithashtu rezultat pozitiv, duke mbledhur 60% të pikëve të mundshme.

Tabela 12: Treguesit e aksesueshmërisë të renditur sipas performancës, nga më i larti tek më i ulëti

1	Aksesi në dokumentacionin e konsultimit	81%
2	Aksesi në njoftimin për konsultim	60%

KRAHASIMI I AKSESUESHMËRISË NË KONSULTIME SIPAS INSTITUCIONEVE

Treguesit e aksesueshmërisë së dokumenteve morën pikët më larta në të 10 institucionet, duke mbledhur 141 pikë gjithsej nga 200 pikë të mundshme. Nga 10 institucionet në fjalë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore patën rezultatet më të larta (19, 17 dhe 16 pikë nga 20 të mundshme përkatësisht). Në fund të renditjes është ish-in Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të cilat morën numrin më të ulët të pikëve, me nëntë pikë nga 20 të mundshme gjithsej për aksesueshmërinë.


Tabela 13: Performanca e institucioneve lidhur me aksesueshmërinë e dokumenteve

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Aksesueshmërinë (Max. 20)	16	9	19	13	13	15	9	15	15	17
Përqindja për Aksesueshmërinë	80%	45%	95%	65%	65%	75%	45%	75%	75%	85%
Total										141/200 (70.5%)

KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË AKSESUESHMËRISË NË KUADËR TË LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË MONITORUARA

Figura 10: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me aksesin në dokumente

Performanca e projektakteve në bazë të aksesueshmërisë së dokumenteve



Shumica (rreth 60%) e 50 projektakteve morën tre pikë nga katër të mundshme për treguesit e aksesueshmërisë. Në skajet e renditjes, nëntë projektakte morën pikë të plota për aksesueshmërinë, ndërsa dy projektakte nuk morën asnjë pikë për këtë parim. Projektaktet që kanë marrë pikë të plota ishin kryesisht projektligje, ndërsa dy projektaktet që nuk morën asnjë pikë ishin Ligji Nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe VKM Nr. 338 date 31 maj 2023 “Për shkrirjen e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe ristrukturimin e njësive kryesore të saj”. Të dy këto projektakte u propozuan nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke anashkaluar procesin e konsultimit pavarësisht interesit të lartë publik dhe reagimit të shkaktuar.

TREGUESI 2.1: AKSESI NË NJOFTIMET PËR KONSULTIM


Për të siguruar arritjen e qytetarëve të ndikuar nga vendimmarrja dhe grupeve të interesit, që këta të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë në konsultime publike, ka shumë rëndësi që njoftimet për procesin e konsultimit të jenë të aksesueshme dhe të përdoren kanale të ndryshme komunikimi. Kjo jo vetëm që përforcon aksesin për audiencat e shumëllojshme, por rrit edhe transparencën dhe besimin në procesin e vendimmarrjes. Në rastin e Shqipërisë, ky proces njoftimi, dhe aksesin në përgjithësi si parim kyç, përcaktohen si në legjislacionin për konsultimin publik, ashtu edhe në udhëzimet për konsultimin.

Treguesi 2.1 (për aksesin në njoftimin për konsultim) vlerësoi nëse njoftimet për konsultimin publik të projektakteve në fjalë u bënë përmes RENJKP dhe të paktën një kanal tjetër komunikimi, ndërkohë që kontrolloi edhe plotësinë e këtyre njoftimeve (p.sh. nëse ato përfshinin informacionin e nevojshëm logjistik për pjesëmarrje). Sa i përket pikëzimit, u dhanë dy pikë në rastet kur njoftimet ishin shpallur të paktën edhe në një kanal tjetër përveç regjistrit, si dhe kur informacioni në këto njoftime ishte i plotë. U dha një pikë në rastet kur njoftimet ishin shpallur në regjistër dhe të paktën një kanal tjetër, por nuk përmbanin informacion për vendin dhe orën e seancave të konsultimit me prani fizike, në rastet kur organizoheshin të tilla. Së fundmi, nuk u dha asnjë pikë kur njoftimet nuk ishin shpallur, ose ishin shpallur vetëm në RENJKP, i cili është kanal që nuk njihet nga të gjithë qytetarët dhe që nuk mundëson akses të barabartë për të gjithë, p.sh. qytetarët me njohuri të kufizuara dixhitale apo personat me aftësi të kufizuara.

Gjithsej, projektaktet grumbulluan 60 pikë nga 100 të mundshme për këtë tregues. Në pjesën më të madhe të rasteve, njoftimet për konsultimin publik të projektakteve ishin shpallur si në RENJKP dhe në faqen e internetit të institucionit përkatës. Megjithatë, Këshilli i Ministrave ishte i vetmi institucion që nuk kishte seksion të veçantë për konsultimet publike në faqen e tij të internetit. Për këtë arsye, të gjithë projektaktet e shpallura nga Këshilli i Ministrave ishin të pranishëm vetëm në regjistër dhe në faqet e internetit të institucioneve të tjera të ndikuara nga projektakti në fjalë, si agjencitë e varësisë së Kryeministrit.

Figura 11. Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me aksesin në njoftime për konsultim

Indikatori 2.1 - Aksesin në njoftimet e konsultimit



Pas ndryshimeve institucionale që rezultuan në krijimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (si pasardhëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të trajtuara në këtë monitorim), për këto dy institucione u krijuan faqe të reja interneti. Faqet e internetit ndoqën formatet e faqes së Këshillit të Ministrave dhe si pasojë nuk kanë seksion të veçantë për

konsultimet publike. Si pasojë, duket se në të ardhmen e aftërt në dallim nga të tjerat, faqet e këtyre dy ministrive nuk do të shërbejnë si kanali i dytë i zakonshëm për njoftimet për konsultime publike (përveç RENJKP).

Sa i përket plotësisë së njoftimeve lidhur me përcaktimin e detajeve logjistike si orari dhe vendi i seancave të konsultimit me pjesëmarrje fizike, nuk kishte asnjë rast në të cilin këto elemente jepeshin qartë gjatë fazës së njoftimit. Rastet në të cilat janë dhënë dy pikë janë pasojë e faktit që institucionet nuk kishin planifikuar asnjë seancë konsultimi me prani fizike.

Tabela 14: Performanca e projektakteve bazuar në aksesin në njoftimet për konsultim, sipas projektaktit dhe institucionit

Treguesi 2.1: Aksesin në njoftimet për konsultim										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	1	1	1	1	2	0	2	2	2
Projektakti 2	1	1	1	2	1	1	1	2	2	1
Projektakti 3	2	1	1	2	1	1	1	2	2	2
Projektakti 4	0	1	0	1	1	1	0	2	2	1
Projektakti 5	0	1	0	1	1	1	1	2	2	2
Pikë Gjithsej	3	5	3	7	5	6	3	10	10	8
									Pikë Gjithsej	60/100


TREGUESI 2.2: AKESI NË DOKUMENTACIONIN E KONSULTIMIT

Me qëllim që konsultimet publike të jenë realisht të efektshme, dokumentacioni mbështetës për të gjitha projektaktet duhet të jetë i lexueshëm lehtësisht, i ripërdorshëm dhe i disponueshëm në format me të dhëna të hapura. Kjo qasje pakëson pengesat për pjesëmarrje dhe fuqizon pjesëtarët e komunitetit të angazhohen në mënyrë kuptimplotë në procesin e vendimmarrjes, pavarësisht profilit të tyre apo nivelit të ekspertizës. Për më tepër, sigurimi i informacionit në formate të të dhënave të hapura mundëson analizim dhe ripërdorim më të gjerë, për shembull nga ekspertët. Si pasojë, aksesueshmëria konsiderohet si parim kyç i procesit të konsultimit, si në legjislacionin e konsultimit publik, ashtu edhe në udhëzimet e konsultimit.

Me qëllim vlerësimin e aksesit në dokumentacionin e konsultimit, treguesi 2.2 përqendrohet në vlerësimin e disponueshmërisë së projektakteve dhe dokumentacionit përkatës mbështetës në format me qasje të lehtë, që mund të ripërdoret dhe me të dhëna të hapura. Për qëllimet e monitorimit të këtij treguesi, studimi analizoi dokumentacionin në dosjet e integruara të secilit akt individual në RENJKP, si dhe në faqet e internetit të institucioneve. Sa i përket pikëzimit, iu dhanë dy pikë dokumentacionit që përmbushte kriteret e aksesit, ripërdorimit dhe formatit të të dhënave të hapura. Iu dha një pikë dokumentacionit që siguronte qasje, por të dhënat e të cilit nuk ishin të hapura duke kufizuar kështu mundësinë e palëve të treta për të punuar në mënyrë të pavarur me të dhënat. Së fundmi, nuk iu dhanë pikë dokumentacionit që nuk ofronte qasje, dhe që ishte në formate të palexueshme nga programet e zakonshme kompjuterike.

Figura 12: Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me aksesin në dokumentet e konsultimit

Treguesi 2.2 - Aksesin në dokumentet e konsultimit



Për këtë tregues u morën gjithsej 81 nga 100 pikë. Shumica e dokumentacionit të disponueshëm në regjistër në dosjet e secilit projektakt siguronte akses dhe ishte i ripërdorshëm. Dokumentet ishin kryesisht në format Word dhe PDF, që janë formate të zakonshme për thuajse çdo kompjuter dhe përdorues të zakonshëm. Dokumentet (e rralla) me sasi të mëdha të dhënash, si projektbuxhetet, ishin vënë kryesisht në dispozicion në format Excel, duke i mundësuar palëve të interesuara të shkarkojnë dokumentin dhe të punojnë me të në mënyrë të pavarur.

Nga ana tjetër, kishte raste në të cilat dokumentet e disponueshme ishin të publikuara në gjuhë që krijojnë vështirësi në akses. Në rastin e 'Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale' dhe 'Ligjit për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar' për shembull, tabelat e përputhshmërisë ishin kryesisht në anglisht. Megjithatë kishte përkthim në shqip për pjesët kryesore të dokumentit, teksti hyrës, titujt dhe hollësitë e vlerësimit ishin paraqitur vetëm në anglisht. Në raste të tjera, aksesin nuk ishte e mundur në dokumente të ndryshme, të cilat megjithatë ishin paraqitur në regjistër, nuk mund të shkarkoheshin për shkak se dokumenti origjinal ishte fshirë nga vendruajtja qendrore.

Tabela 15: Performanca e aksesit të dokumenteve të konsultimit, sipas projektaktit dhe institucionit

Treguesi 2.2: Aksesin në dokumentacion										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	2	1	2	2	2	2	1	1	2	2
Projektakti 2	2	2	2	2	2	2	1	1	2	2
Projektakti 3	2	1	2	2	2	2	2	1	2	0
Projektakti 4	2	2	0	2	2	2	1	1	2	2
Projektakti 5	2	2	0	2	2	2	1	1	1	1
Pikë Gjithsej	10	8	6	10	10	10	6	5	9	7
									Pikë Gjithsej	81/100

PARIMI III: EFEKTIVITETI I KONSULTIMIT PUBLIK

Efektiviteti është një tjetër parim kyç i përcaktuar në ligjin për njoftimet dhe konsultimin publik. Me qëllim hartimin e ligjeve dhe politikave realiste, është thelbësore të zbatohen procese të efektshme të konsultimit publik. Treguesit kyçë të angazhimit institucional për konsultimin e efektshëm përfshijnë planifikimin e arsyeshëm të konsultimeve gjatë vitit, duke njoftuar dhe mundësuar kohë të mjaftueshme për përgatitje, si dhe duke siguruar miratimin në kohë të projektakteve të konsultuara. Elemente të tjera kyçe për sigurimin e efektivitetit janë përzgjedhja e metodave të përshtatshme të konsultimit dhe monitorimi aktiv i shkallës së pjesëmarrjes dhe rezultateve.

PERFORMANCA SIPAS TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË KONSULTIMEVE

Sa i përket treguesve të efektivitetit, 10 institucionet e monitoruara dolën më mirë lidhur me përshtatshmërinë e afateve të konsultimit, duke arritur rezultat prej 71%. Megjithatë, për të gjithë treguesit e tjerë u regjistruan rezultate nën mesataren. Këta tregues matën shpërndarjen vjetore të konsultimeve (43%), zbatimin e planeve vjetore të konsultimit publik (35%), miratimin në kohë të projektakteve të konsultuara (10%), dhe monitorimin e efektshmërisë së metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes (5%). Së fundmi, treguesi i monitorimit të brendshëm për proceset e konsultimit të brendshëm, nuk mori asnjë pikë.

Tabela 16: Treguesit e efektivitetit të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti

1	Përshtatshmëria e afatit të konsultimit	71%
2	Shpërndarja e konsultimeve gjatë vitit kalendarik	43%
3	Zbatimi i planit vjetor të konsultimeve publike	35%
4	Miratimi në kohë i projektakteve të konsultuara (brenda 1 viti)	10%
5	Vlerësimi i efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes	5%
6	Monitorimi i brendshëm i procesit të konsultimit publik	0%

KRAHASIMI I EFEKTIVITETIT TË KONSULTIMIT NË INSTITUCIONE

Efektiviteti i proceseve të konsultimit publik ishte parimi me rezultatin e tretë më të lartë, me 108 pikë gjithsej nga 260 të mundshme. Rezultatet e përgjithshme për efektivitetin ndër institucionet e monitoruara, ishin nën mesatare me 42%. Nga 10 institucionet në fjalë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore arritën rezultatet më të larta duke marrë përkatësisht nga 50% të pikëve të mundshme. Nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Këshilli i Ministrave arritën rezultatet më të ulëta me 27%, 35% dhe 35%, përkatësisht. Pesë institucionet e tjera arritën rezultate disi më të mira, duke arritur nga 39% deri 46%, megjithëse këto rezultate ishin gjithsesi nën mesataren.

Tabela 17: Performanca e institucioneve lidhur me efektivitetin e konsultimeve

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Efektivitetin (Max. 26)	9	11	12	10	12	13	12	7	9	13
Përqindja për Efektivitetin	35%	42%	46%	39%	46%	50%	46%	27%	35%	50%
Total										108/260 (41.5%)

KRAHASIMI I EFEKTIVITETIT TË KONSULTIMEVE TË LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË MONITORUARA

Gjatë vlerësimit të efektivitetit të 50 projektakteve të monitoruara, shumica e tyre (27) morën të dy pikët e mundshme, ndërsa një numër i konsiderueshëm (17) morën një pikë. Ndërkohë, gjashtë nga 50 projektakte nuk morën asnjë pikë për efektivitetin.

Tabela 18: Numri i projektakteve bazuar në performancën e efektivitetit të konsultimit

Efektiviteti (Maksimumi 2 pikë)	Numri i projektakteve
0 pikë	6
1 pikë	17
2 pikë	27

Projektaktet me rezultatin më të lartë për efektivitetin e konsultimeve të tyre ishin kryesisht projektligjet. Vetëm pesë nga 27 projektaktet në fjalë që morën rezultatin maksimal për efektivitetin ishin VKM dhe/ose dokumente të strategjive kombëtare, megjithëse këto të fundit përbënin 38% të kampionit të projektakteve të monitoruara. Sa i përket gjashtë projektakteve që nuk morën asnjë pikë, katër prej tyre ishin VKM dhe/ose dokumente strategjike kombëtare, dhe dy ishin projektligje.

TREGUESI 3.1: PËRSHTATSHMËRIA E AFATIT KOHOR TË KONSULTIMIT

Respektimi i afateve kohore të konsultimit siguron që palët e interesit të kenë kohë të mjaftueshme për të rishikuar dhe ofruar “feedback” domethënës për projektaktet. Megjithëse sipas ligjit afati kohor standard është 20 ditë pune, është e rëndësishme që kur përcaktohen afatet kohore të merret në konsideratë kompleksiteti i dokumenteve dhe nevojat e grupeve të interesuara dhe jo thjesht të zbatohet afatit kohor minimal në çdo rast. Ligji lejon një periudhë të zgjatur deri në 40 ditë pune në rastet e dokumenteve komplekse dhe shumë të rëndësishme. Afatet kohore fleksible dhe të planifikuara si duhet, që mund të përfshijnë shtyrje kur është e nevojshme, kontribuojnë për angazhim më efektiv dhe cilësi më të lartë të kontributeve.


Treguesi 3.1 vlerësoi nëse institucionet e monitoruara respektonin afatin kohor minimal ligjor, nëse afatet ishin realiste dhe nëse natyra dhe kompleksiteti i projektakteve në konsultim ishte marrë parasysh paraprakisht. Institucionet që i përmbushin këto kritere duke vendosur afate kohore realiste, të cilat pasqyrojnë kompleksitetin e dokumentit, ose që kanë demonstruar proaktivitet nëpërmjet zgjatjeve, shtyrjeve ose përsëritjeve të procesit të konsultimit kur nevojitej, u vlerësuan me dy pikë.

Në bazë të metodologjisë së vlerësimit, u mat kompleksiteti i dokumenteve duke shqyrtuar numrin e faqeve në raport me afatin kohor dhe llojin e dokumentit. Për rrjedhojë, strategjitë, politikay, kodey

dhe ligjet e rëndësishme, si dhe projektaktet që propozojnë reforma të rëndësishme, u konsideruan dokumente komplekse. Kur afatet kohore të konsultimit e kishin respektuar minimumin ligjor prej 20 ditësh pune, por nuk kishin marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e dokumenteve, institucionet morën një pikë. Nëse afati kohor i konsultimit ishte më i shkurtër se 20 ditë pune, ose nuk merrte parasysh pushimet zyrtare, u vlerësuan me zero pikë.

Figura 13: Numri i projektakteve bazuar në performancën lidhur me përshtatshmërinë e afateve të konsultimit

Treguesi 3.1: Përshtatshmëria e afatit të konsultimit



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 71%. Në krahasim me treguesit e tjerë, përshtatshmëria e afateve kohore të konsultimit kishte pikët më të larta nga gjashtë treguesit e vlerësuar për efektivitetin. Kur u vlerësua përshtatshmëria e afateve të konsultimit për 50 dokumentet e monitoruara, shumica e projektakteve (27 nga 50) morën kohore maksimumin e pikëve (dy pikë), 17 morën një pikë, ndërsa gjashtë projektakte nuk morën asnjë pikë lidhur me përshtatshmërinë e afateve të tyre kohore të konsultimit.

Tabela 19: Performanca lidhur me përshtatshmërinë e afateve të konsultimit, për projektakt dhe institucion

Treguesi 3.1: Përshtatshmëria e afatit të konsultimit

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	2	2	1	1	1	2	2	0	1	2
Projektakti 2	1	2	2	2	2	1	2	2	1	2
Projektakti 3	1	1	2	0	1	1	0	2	1	2
Projektakti 4	2	1	0	2	2	2	2	0	2	2
Projektakti 5	1	2	0	1	1	2	2	1	2	2
Pikë Gjithsej	7	8	5	6	7	8	8	5	7	10
									Pikë Gjithsej	71/100 ose 70%

Kur ky tregues u vlerësua sipas performancës institucionale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ishte i vetmi institucion që arriti maksimumin prej 10 pikësh. Ajo u ndoq nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, të cilat u vlerësuan me tetë nga 10 pikë secila. Institucionet e mbetura morën nga pesë deri në shtatë pikë, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale morën pikët më të ulëta.

Megjithëse përshtatshmëria e afateve kohore ishte ndër treguesit me pikët më të larta të kategorisë, u evidentuan disa praktika që kanë nevojë për përmirësim. Pati raste kur afati minimal ligjor i konsultimit prej 20 ditësh pune ishte caktuar pa marrë parasysh kompleksitetin dhe volumin e dokumenteve të konsultuara. Për shembull, Programi i Reformave Ekonomike 2023–2025 kishte një periudhë konsultimi prej 20 ditësh pune pavarësisht se dokumentet shoqëruese ishin rreth 205 faqe. Po ashtu, Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe Plani i Veprimit 2021–2023 ishin të disponueshme për një periudhë konsultimi prej 21 ditësh, me 103 faqe dokumente, ndërsa Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe Plani i Veprimit u konsultuan për një periudhë prej 20 ditësh me 78 faqe dokumente.

Në rastin e ligjit lidhur me “trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, pavarësisht interesit publik dhe kundërshtive të krijuara, Ministria e Arsimit dhe Sportit e vijoi procesin me procedurë të përshpejtuar, duke shmangur konsultimin. Sipas përgjigjes ndaj KI, kjo u bë për shkak të emergjencës për ta pasur ligjin në fuqi përpara fillimit të procedurave të aplikimit dhe regjistrimit për vitin akademik 2023–2024, gjë që solli anshkalimin e procesit të zakonshëm të konsultimit.

Është pozitiv fakti që disa institucione siguruan kohë të mjaftueshme konsultimi për dokumente voluminoze, duke shkuar përtej afateve kohore minimale ligjore. Për shembull, Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për Drinin dhe Bunën ishte i disponueshëm për konsultim për më shumë se pesë muaj, ndërsa paketa e konsultimit përfshinte rreth 200 faqe dokumente.

Si përfundim, edhe pse institucionet priren t’u përmbahen afateve kohore minimale të konsultimit, sigurimi i efektivitetit të procesit kërkon një qasje më të nuancuar. Më konkretisht, afatet kohore duhet të përcaktohen duke i kushtuar më shumë rëndësi kompleksitetit dhe vëllimit të dokumenteve shoqëruese.


TREGUESI 3.2: SHPËRNDARJA E KONSULTIMEVE GJATË VITIT KALENDARIK

Planifikimi institucional efektiv dëshmohej nga shpërndarja e mirëpërcaktuar në kohë e njoftimeve dhe proceseve të konsultimit gjatë vitit. Kjo njihet si praktikë e mirë pasi u ofron palëve të interesit kohë të mjaftueshme për të përgatitur kontributet e tyre dhe u mundëson institucioneve t’i organizojnë aktivitetet e tyre të konsultimit në mënyrë më efikase. Nga ana tjetër, zhvillimi i shumë proceseve të konsultimit njëherësh ose i përqendruar në periudha të shkurtra të vitit, mund t’i mbingarkojë palët e interesit dhe mund të ulë sasinë dhe cilësinë e “feedback-ut”, duke sjellë edhe sforcime lidhur me burimet institucionale dhe planifikimin.

Ky tregues vlerëson nëse konsultimet janë shpërndarë në mënyrë të barabartë ose proporcionale gjatë vitit kalendarik, duke ruajtur nivele konsistente aktivitetesh në muaj ose periudha të ndryshme kohore. Institucionet që ia dolën ta ruanin këtë balancë morën maksimumin prej dy pikësh. Në rastet kur konsultimet ishin disi të përqendruara në muaj të caktuar, por kishte ende disa prova për shpërndarje gjatë gjithë vitit, institucionet morën një pikë. Institucionet që i kishin zhvilluar konsultimet e tyre shumë të përqendruara në muaj ose periudha të caktuara, me aktivitet minimal ose pa aktivitet në periudha të tjera, që kishin zhvilluar konsultime të mbivendosura ose gjatë pushimeve zyrtare, morën zero pikë.

Figura 14. Numri i institucioneve bazuar në performancën e shpërndarjes së konsultimeve gjatë vitit

Treguesi 3.2: Shpërndarja e konsultimeve gjatë vitit kalendarik



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 43% të pikëve të disponueshme. Megjithatë ky tregues shënoi pikët e dyta më të larta në gjashtë treguesit e efektivitetit, sërish mbetet nën nivelin mesatar. Është e rëndësishme të theksohet se ky tregues u vlerësua dy herë për secilin institucion (çdo vit për vitet 2022 dhe 2023).

Kur u vlerësua shpërndarja e njoftimeve dhe proceseve të konsultimit për vitin 2022, tre institucione morën zero pikë, shtatë institucione morën një pikë dhe asnjë institucion nuk e mori maksimumin prej dy pikësh. Megjithatë, në vitin 2023, u vu re një përmirësim i lehtë, me dy nga institucionet që morën maksimumin prej dy pikësh (Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë), ndërsa gjashtë institucione morën një pikë dhe dy institucione nuk morën asnjë pikë për shkak të shpërndarjes disproporcionale të njoftimeve dhe proceseve të tyre të konsultimit.

Tabela 20: Performanca e shpërndarjes së konsultimeve gjatë vitit kalendarik për vitet 2022 dhe 2023, për institucion

Treguesi 3.2: Shpërndarja e konsultimeve gjatë vitit kalendarik

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	1	1	1	0	1	0	1	0	1	1
2023	0	1	2	1	1	1	2	1	0	1
Pikë Gjithsej	1	2	3	1	2	1	3	1	1	2
									Pikë Gjithsej	17/40 pikë ose 43%

Gjatë monitorimit u vu re se disa institucione kishin prirje t'i përqendronin proceset e tyre të konsultimit në disa muaj të vitit, gjë që sjell periudha të zgjatura pa aktivitet. Për shembull, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kishte pesë muaj pa aktivitet në vitin 2022, ndërsa Ministria e Brendshme zhvilloi konsultime për gjashtë nga tetë projektaktet për vitin 2022 në dy muajt e fundit të vitit. Po ashtu, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore i zhvilloi konsultimet vetëm në katër muajt e fundit të vitit. Megjithatë mund të ketë arsye të ndryshme për këtë, periudhat e përqendruara të konsultimeve ose të disa konsultimeve të mbajtura njëkohësisht, mund të ndikojnë negativisht në efektivitetin institucional dhe mundësitë për angazhim të palëve të interesit.


TREGUESI 3.3: MIRATIMI NË KOHË I PROJEKTAKTEVE TË KONSULTUARA

Miratimi në kohë i politikave ose ligjeve që janë konsultuar është vendimtar për të pasur "feedback" koherent dhe të përdorshëm nga palët e interesit. Ai tregon përgjegjshmëri ndaj kontributit të publikut dhe ndihmon për krijimin e besimit në procesin e konsultimit. Nga ana tjetër, vonesat në miratim mund të bëjnë që politikat të vjetrohen ose të jenë më pak efektive, me ndryshimin e rrethanave dhe nevojave. Për më tepër, gjatë diskutimeve pasuese ndër-institucionale, në dokument mund të bëhen ndryshime që nuk ishin paraqitur gjatë fazës së konsultimit publik, duke devijuar nga dokumenti fillestar dhe duke e transformuar draftin që iu nënshtrua konsultimit publik. Praktikrat më të mira tregojnë se vendimmarrja në kohë mund të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes, duke siguruar trajtimin e problematikave aktuale dhe përdorimin e përshtatshëm të burimeve.

Ky tregues vlerëson nëse dokumentet e konsultuara janë miratuar zyrtarisht brenda vitit kalendarik gjatë të cilit janë konsultuar. Në rastet kur mbi 80% e projektakteve të konsultuara ishin miratuar gjatë të njëjtit vitit kalendarik kur u zhvillua edhe konsultimi, institucionet morën maksimumin prej dy pikësh. Nëse 50–80% e projektakteve të konsultuara ishin miratuar brenda vitit, institucionet morën një pikë. Institucionet morën zero pikë kur më pak se 50% e projektakteve të konsultuara ishin miratuar brenda vitit.

Pikëzimi i përgjithshëm për institucionet për këtë tregues është ndër më të ulët në të gjithë treguesit e efektivitetit, me vetëm 10%.

Figura 15: Numri i institucioneve bazuar në performancën lidhur me miratimin në kohë të projektakteve të konsultuara



Kur u kontrollua miratimi zyrtar i dokumenteve të konsultuara për vitin kalendarik 2022, tetë nga 10 institucionet morën zero pikë, gjë që tregon se më pak se gjysma e projektakteve të tyre të konsultuara ishin miratuar brenda vitit. Dy institucionet e mbetura, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, morën secila nga një pikë për vitin 2022. Rezultatet për vitin 2023 ishin të ngjashme, me tetë institucione që nuk morën asnjë pikë dhe dy institucione, konkretisht Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, që morën një pikë. Në asnjërin vit, asnjë prej institucioneve nuk mori maksimumin prej dy pikësh për miratimin zyrtar të dokumenteve të konsultuara brenda vitit kalendarik kur u zhvillua konsultimi për projektaktet.

Tabela 21: Performanca për miratimin në kohë të dokumenteve të konsultuara gjatë periudhës 2022–2023, për institucion

Treguesi 3.3: Miratimi në kohë i projektakteve të konsultuara

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0
2023	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	0	0	1	0	2	1	0	0	0	0
									Pikë Gjithsej	4/40 pikë ose 10%

Si përfundim, rezultatet e ulëta të konstatuara për këtë tregues theksojnë një problematikë të rëndësishme: mosmiratimin nga institucionet publike të projektakteve të konsultuara brenda të njëjtit vit, gjë që sinjalizon për praktika joefektive planifikimi. Megjithëse mund të ketë faktorë të tjerë kontribues për këtë fenomen, siç mund të jenë problematika ose nevojat emergjente që dalin gjatë vitit, nevojitet përmirësim i planifikimit dhe parashikueshmërisë së proceseve legislative dhe politikëbërëse. Për të siguruar integritetin dhe për të ruajtur besimin, është e rëndësishme që të shmanget miratimi i dokumenteve disa vite pas konsultimit të tyre. Vonesat shpesh sjellin ndryshime të rrethanave dhe humbje të kontributit të vlefshëm, pasi projektaktet u nënshtrohen ndryshimeve të shumta që nuk marrin në konsideratë zinxhirin e konsultimeve që u kanë paraprirë.


TREGUESI 3.4: ZBATIMI I PLANIT VJETOR TË KONSULTIMIT

Zbatimi efektiv i konsultimeve publike varet në një masë të madhe nga planifikimi rigoroz, që shërben si hap i parë thelbësor. Institucioneve publike u kërkohet me ligj që të përgatitin dhe publikojnë plane vjetore ku përcaktohen të gjitha dokumentet e planifikuara për konsultim brenda një viti kalendarik. Për dokumentet e përjashtuara nga konsultimi, duhet të ofrohen justifikime të arsyeshme, sipas udhëzimeve për konsultimet. Këto plane duhet të hartohen me kujdes, duke marrë në konsideratë faktorë kyç, si interesi i lartë publik dhe komunitetet e ndikuara nga vendimet. Pa plane vjetore transparente dhe të mirëstrukturuara, ndjekja e procesit të konsultimit bëhet e vështirë dhe mundësitë për pjesëmarrje domethënëse pakësohen.

Treguesi 3.4 vlerëson nëse institucionet i realizojnë planet e tyre vjetore të konsultimit publik gjatë vitit kalendarik. Institucionet marrin maksimumin prej dy pikësh nëse kanë konsultuar më shumë se 80% të projektakteve të planifikuara brenda vitit kalendarik. Nëse janë konsultuar vetëm 50-80% e projektakteve, institucioni merr një pikë. Së fundi, institucionet që kanë konsultuar më pak se 50% të projektakteve të planifikuara vlerësohen me zero pikë.

Figura 16: Numri i institucioneve bazuar në nivelin e zbatimit të planit vjetor të konsultimit

Treguesi 3.4: Zbatimi i planit vjetor të konsultimeve



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 35%. Sikurse treguesi pararendës, zbatimi i planeve vjetore të konsultimit u vlerësua nga dy herë për secilin institucion (në bazë vjetore, përkatësisht për vitet 2022 dhe 2023).

Pas vlerësimit të zbatimit të planeve vjetore të konsultimit për vitin 2022, tre institucione morën zero pikë, pesë institucione morën një pikë dhe vetëm Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore morën maksimumin prej dy pikësh. Për vitin 2023, katër institucione nuk morën asnjë pikë, gjashtë institucione morën një pikë dhe asnjë institucion nuk mori maksimumin prej dy pikësh për zbatimin e planeve vjetore të konsultimit.

Tabela 22: Performanca për zbatimin e planeve vjetore të konsultimit për vitet 2022 dhe 2023, për institucion

Treguesi 3.4: Zbatimi i planit vjetor të konsultimeve publike											
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM	
2022	0	1	2	1	1	2	1	0	1	0	
2023	1	0	1	1	0	1	0	1	0	1	
Pikë Gjithsej	1	1	3	2	1	3	1	1	1	1	
										Pikë Gjithsej	15/40 ose 35%

Si përfundim, rezultatet e ulëta për këtë tregues, ashtu si treguesi i mëparshëm, zbulojnë mangësi të konsiderueshme në praktikën e planifikimit të institucioneve publike. Megjithatë shkak për zbatimin e dobët të planit vjetor të konsultimit mund të jenë faktorë të ndryshëm, si çështje urgjente dhe vonesa të paparashikuara, është e rëndësishme që të përmirësohet parashikueshmëria e proceseve legislative dhe politikëbërëse për të krijuar më shumë besim me palët e interesit.

TREGUESI 3.5: VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË METODAVE TË KONSULTIMIT DHE PJESËMARRJES


Që konsultimet të jenë efektive, metodat e zgjedhura të konsultimit duhet të përshtaten me çështjen konkrete në shqyrtim dhe me karakteristikat e palëve të synuara të interesit. Monitorimi i efektivitetit të këtyre instrumenteve dhe vlerësimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit është i rëndësishëm për të siguruar që proceset të kenë ndikim dhe të jenë të drejta. Nëpërmjet vlerësimit sistematik të metodave të përdorura të konsultimit, autoritetet mund të identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta, duke lejuar përshtatje për të përmirësuar efektivitetin e procesit. Për shembull, edhe pse konsultimet elektronike janë me kosto efikase dhe kanë mbulim të gjerë, ato ndikohen shpesh nga niveli i ulët i përgjigjes dhe aksesueshmërisë. Për t'i kapërcyer këto sfida, konsultimet elektronike duhet të kombinohen me metoda të tjera.

Treguesi 3.5 vlerëson nëse institucionet e monitoruara e kanë ndjekur efektivitetin e metodave të tyre të konsultimit dhe nëse i kanë bërë publike rezultatet. Ky informacion mund të përfshihet në reflektime ose raporte, si raportet individuale ose vjetore të konsultimit, që, ndër temat e tjera, trajtojnë metodat dhe pjesëmarrjen.

Institucionet marrin maksimumin prej dy pikësh nëse i kanë përmbushur të dyja kërkesat (vlerësimin dhe publikimin e rezultateve). Nëse institucioni ka vlerësuar efektivitetin dhe pjesëmarrjen në konsultimet publike, por nuk i ka publikuar rezultatet, ai merr një pikë. Nëse institucioni nuk i ka monitoruar këto aspekte, ai merr zero pikë.

Figura 17. Numri i institucioneve bazuar në performancën për vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes

Treguesi 3.5: Vlerësimi i efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 5%, pasi kishte evidencë të kufizuara për të provuar që ndonjëri prej 10 institucioneve të monitoruara kishte vlerësuar efektivitetin e metodave të tyre të konsultimit ose nivelin e pjesëmarrjes publike. Ministria e Brendshme ishte përjashtimi i vetëm, pasi ofroi një analizë minimale për efektivitetin e konsultimit në raportet e saj vjetore, megjithëse nuk kishte ndërmarrë proces vlerësimi të plotë.

Tabela 23: Performanca për vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes, për institucion

Treguesi 3.5: Vlerësimi i efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes											
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM	
Pikë Gjithsej	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	
										Pikë Gjithsej	1/20 ose 5%

Në përfundim, institucioneve publike shqiptare në përgjithësi u mungojnë praktikatat e brendshme për vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit dhe pjesëmarrjes publike. Kjo mund të lidhet pjesërisht me mungesën e detyrimeve ligjore për kryerjen e një procesi të tillë.

TREGUESI 3.6: MONITORIMI I BRENDSHËM I PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK

Monitorimi dhe vlerësimi nga ana e institucioneve i proceseve të tyre të konsultimit publik, për t'u siguruar se ato janë efektive dhe gjithëpërfshirëse, përbën praktikë të mirë. Nëpërmjet vlerësimit sistematik të proceseve dhe rezultateve, institucionet mund të identifikojnë fushat ku nevojitet përmirësim dhe rritin cilësinë e përgjithshme të konsultimeve. Ky cikël i vazhdueshëm feedback-u jo vetëm që ndihmon për të përmirësuar strategjitë për ndikim më të lartë, por nxit edhe më shumë transparencë dhe llogaridhënie, gjë që krijon besimin publik.

Ky tregues vlerëson nëse institucionet kanë përgatitur dhe publikuar raporte monitorimi për proceset e tyre të konsultimit publik. Ky kriter mund të përmbushet nëpërmjet përfshirjes në raporte të tjera institucionale ose në një raport të posaçëm monitorimi dhe vlerësimi. Institucionet që i kanë hartuar dhe publikuar këto raporte vlerësohen me maksimumin prej dy pikësh. Nëse institucionet kanë përgatitur një raport, por nuk e kanë publikuar, ata vlerësohen një pikë. Nëse nuk ekziston asnjë dokument ose raport monitorimi i publikuar, institucionet nuk marrin asnjë pikë.

Figura 18: Performanca institucionale për monitorimin e brendshëm të procesit të konsultimit publik

Treguesi 3.6: Monitorimi i brendshëm i procesit të konsultimit publik



Performanca e përgjithshme për këtë tregues ishte në nivelin 0%, pasi nuk kishte prova se ndonjë nga 10 institucionet e monitoruara kishte kryer monitorim të brendshëm të proceseve të tyre të konsultimit publik, ose raporte monitorimi të publikuara.

Tabela 24: Performanca për monitorimin e brendshëm të proceseve të konsultimit publik, për institucion

Treguesi 3.6: Monitorimi i brendshëm i procesit të konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Pikë Gjithsej	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
									Pikë Gjithsej	0/20

Ashtu si në rastin e treguesit të mëparshëm, mund të arrihet në përfundimin se institucioneve publike u mungojnë praktikat e brendshme për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të tyre të konsultimit publik, si dhe për publikimin e këtyre raporteve. Për këtë, shkak mund të jetë mungesa e detyrimeve ligjore për të kryer një proces të tillë.

PARIMI IV: LLOGARIDHËNIA PËR KONSULTIMET PUBLIKE

Parimi për llogaridhënie në konsultimet publike kërkon që vendimmarrësit të jenë transparentë, të përgjegjshëm dhe të përgjigjshëm ndaj komuniteteve që u shërbejnë. Procesi llogaridhënës i konsultimit është i hapur dhe i gjurmueshëm që nga fazat e tij fillestare e deri tek ato përfundimtare, garanton marrjen në konsideratë të kontributeve të pjesëmarrësve, si dhe garanton se rezultatet pasqyrojnë feedback-un e marrë dhe se ka mekanizma të disponueshëm për korrigjim në rast problemesh. Kjo qasje forcon qeverisjen demokratike, pasi bën që vendimmarrësit t'u përmbahen angazhimeve të tyre dhe ofron mundësi për trajtimin e shqetësimeve ose mangësive.

PERFORMANCA SIPAS TREGUESVE TË LLOGARIDHËNIES

Teksa treguesit që përbëjnë metrikën e llogaridhënies shqyrtohen më me imtësi, vihet re një pabarazi ndërmjet gjysmës së parë dhe gjysmës së dytë të treguesve. Treguesit 4.1, 4.2 dhe 4.3 morën pikë të kënaqshme prej 45%, 56% dhe 39%. Pra, proceset e konsultimit të projektakteve ishin mesatarisht llogaridhënese për fazën e hartimit të akteve përkatëse; në përgjithësi, ishin planifikuar në dokumente strategjike; dhe prireshin të jepnin arsye se përse komente të caktuara në konsultimet publike ishin refuzuar ose ishin pranuar vetëm pjesërisht. Ndërkohë, treguesit 4.4, 4.5 dhe 4.6 rezultuan më keq, pasi u vlerësuan me përkatësisht 1%, 0% dhe 4%. Të përkthyer në përfundime konkrete, proceset e konsultimit të analizuar nuk dhanë arsye për përjashtimin e projektakteve të caktuara nga konsultimet publike; nuk treguan ndikimin e konsultimeve në raportet VNR; dhe nuk publikuan procedurat për ankimimet e qytetarëve lidhur me çështje të konsultimit publik.

Tabela 25: Treguesit e llogaridhënies të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti

1	Projektaktet që e kanë origjinën nga dokumentet strategjike të qeverisë dhe plani vjetor i konsultimeve publike	56%
2	Llogaridhënia për fazën e hartimit të aktit/konsultimit paraprak	45%
3	Ofrimi i arsyeve nga ana e institucioneve për refuzimin ose pranimin e pjesëshëm të komenteve në konsultimet publike	39%
4	Demonstrimi i ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR	4%
5	Vendosja e procedurave për ankesat e qytetarëve mbi shkeljet e konsultimit publik	1%
6	Ofrimi nga ana e institucioneve e arsyeve për përjashtimin e projektakteve nga konsultimet publike	0%

KRAHASIMI I LLOGARIDHËNIES NË INSTITUCIONE

Llogaridhënia rezultoi një nga parimet ku institucionet kanë performuar më keq, teksa kishin grumbulluar vetëm një të tretën e të gjitha pikëve të disponueshme (148 pikë nga 460 të mundshme). Nga 10 institucionet, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural morën pikët më të larta (përkatësisht 24, 21 dhe 20 pikë nga 46), e megjithatë kjo ishte në vetvete ende një performancë mesatare. Në skajin tjetër ishte Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat morën numrin më të ulët të pikëve, me përkatësisht gjashtë dhe dy pikë nga 46.


Tabela 26: Performanca e institucioneve lidhur me llogaridhënien për konsultimet

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Llogaridhënien (Max. 46)	17	21	12	24	20	16	6	2	16	13
Përqindja për Llogaridhënien	37%	46%	26%	52%	43%	35%	13%	4%	35%	28%
Total										147/460 (41.5%)

KRAHASIMI I LLOGARIDHËNIES NË KUADËR TË LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË MONITORUARA

Figura 19: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me llogaridhënien

Performanca e projektakteve në bazë të performancës së tyre lidhur me llogaridhënien



Kur shohim shpërndarjen e pikëve sipas treguesve të llogaridhënies për 50 konsultimet mbi projektaktet, vërejmë se asnjë institucion nuk i ka marrë të teta pikët, madje as edhe shtatë. Proceset e konsultimit për shumicën e projektakteve morën nga dy deri në gjashtë pikë. Është e rëndësishme të theksohet se një në pesë konsultime nuk morën asnjë pikë për llogaridhënien.


TREGUESI 4.1: LLOGARIDHËNIA PËR FAZËN E HARTIMIT TË AKTIT/ KONSULTIMIT PARAPRAK

Ofrimi i informacioneve të detajuara mbi fazën e hartimit dhe konsultimet paraprake të projektakteve është vendimtar për nxitjen e llogaridhënies që nga fillimi i procesit. Kjo qasje i ndihmon institucionet që të kuptojnë më mirë kontekstin dhe perceptimet e publikut, duke u mundësuar qytetarëve që të informohen për origjinën e projektaktit dhe arsyetimin për vendimmarrjen publike. Po ashtu, ajo u ofron qytetarëve mundësinë për të ndikuar në vendime sa më herët që të jetë e mundur. Megjithatë mbajtja

e konsultimeve paraprake rekomandohet nga ligji për konsultimin publik, ajo nuk është e detyrueshme dhe varet nga vullneti i institucioneve për t'u angazhuar me publikun që në fillim të procesit të hartimit.

Ky tregues shqyrton nëse është ofruar informacioni i nevojshëm për fazën e hartimit të secilit akt, përfshirë institucionin propozues, grupin e punës të ngarkuar me hartimin e aktit dhe informacion të mëtejshëm për konsultimet paraprake, kur nevojiten. Kur institucionet kanë ofruar informacion gjithëpërfshirës për fazën e hartimit të akteve specifike, përfshirë të gjitha kategoritë e informacionit të renditura më sipër, ato marrin maksimumin prej dy pikësh. Një pikë marrin në rastet kur ka informacion të disponueshëm për fazën e hartimit, por ky informacion është i paplotë dhe/ose nuk ofron të dhënat e nevojshme për procesin. Në rastet kur nuk ka fare informacion të disponueshëm mbi fazën e hartimit të akteve të monitoruara, institucionet nuk marrin asnjë pikë.

Figura 20: Performanca për llogaridhënien në fazën e hartimit, për çdo projektakt



Dokumentet mbështetëse për rreth 40% të projektakteve nuk përmbanin asnjë informacion mbi fazën e hartimit. Për aktet që kanë marrë vetëm një pikë, dokumentet e tyre mbështetëse përmbanin zakonisht detaje për institucionin propozues dhe grupin e punës përgjegjës për hartimin, por, në përgjithësi, u mungonin të dhëna për aktorët joqeveritarë që kanë marrë pjesë në fazën e hartimit. Zakonisht, aktorët e jashtëm janë monitoruar dhe prezantuar përmes përdorimit të termave të përgjithshëm si "OJF", "bota akademike" ose "përfaqësues të medias", dhe jo në formën e organizatave ose subjekteve specifike që përfaqësojnë.

Tabela 27: Performanca për llogaridhënien në fazën e hartimit, për projektakt dhe institucion

Treguesi 4.1: Llogaridhënia për fazën e hartimit të aktit/konsultimit paraprak

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	1	2	1	1	2	1	0	0	0	0
Projektakti 2	2	1	1	1	2	2	0	0	2	0
Projektakti 3	2	2	1	2	0	1	0	0	1	0
Projektakti 4	2	2	0	1	1	1	0	0	1	1

Treguesi 4.1: Llogaridhënia për fazën e hartimit të aktit/konsultimit paraprak

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 5	2	1	0	2	2	1	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	9	8	3	7	7	6	0	0	4	1
									Pikë Gjithsej	45/100


TREGUESI 4.2: PROJEKTAKTET QË E KANË ORIGJINËN NGA DOKUMENTET STRATEGJIKE TË QEVERISË DHE PLANI VJETOR I KONSULTIMEVE PUBLIKE

Kur ligjet dhe politika përpunohen me planet, prioritetet dhe objektivat e deklaruara të qeverisë, nxitet dialogu koherent me publikun. Zhvillimi i konsultimeve të planifikuara paraprakisht përmirëson ligjshmërinë e vendimmarrjes, pasi palët e interesit dhe qytetarët mund ta shohin si pjesë të një vizioni të gjerë, dhe jo si një reagim të pamenduar për interesa të momentit. Gjithashtu, ai lehtëson alokimin më efektiv të burimeve nga institucionet dhe u mundëson palëve të interesit të planifikojnë paraprakisht pjesëmarrjen e tyre. Megjithëse kërkesa për planifikimin paraprak të konsultimeve publike nuk është ligjërisht detyruese (dhe jo gjithmonë e realizueshme në rast situatash emergjente), ajo konsiderohet ende një praktikë e mirë. Konkretisht, kjo do të thotë se projektaktet që u nënshtrohen konsultimeve publike duhet të mbështeten në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP), në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe në planin vjetor të qeverisë për konsultimet publike dhe dokumente të tjera strategjike, në mënyrë që origjina e vendimit të jetë e parashikueshme, e gjurmueshme, transparente dhe llogaridhënëse.

Treguesi 4.2 kontrollon nëse konsultimet për projektaktet janë planifikuar më parë në PPAP, PKIE ose dokumente të tjera strategjike, dhe nëse janë përfshirë në planin vjetor të konsultimeve publike. Për sa i përket pikëzimit, dy pikë u janë caktuar projektakteve për të cilat proceset e konsultimit janë planifikuar më parë, në të paktën një nga dokumentet strategjike të përmendura më sipër, si dhe në planin vjetor të konsultimit. Më pas, një pikë është caktuar kur konsultimi i projektakteve është planifikuar në një nga dokumentet e përmendura më sipër, por jo në planin vjetor të konsultimit, ose anasjelltas. Së fundi, nëse konsultimi i projektakteve nuk është planifikuar në asnjë nga dokumentet e sipërpërmendura, caktohen zero pikë.

Figura 21: Përfshirja e projektakteve në dokumentet strategjike të qeverisë dhe planin vjetor të konsultimeve publike

Treguesi 4.2: Projektaktet që e kanë origjinën nga dokumentet strategjike të qeverisë dhe plani vjetor i konsultimeve publike



Konsultimet e projektakteve të përfshira në këtë raport kanë marrë në pjesën më të madhe ose dy pikët e plota, ose asnjë pikë. Shumica e konsultimeve të analizuar janë planifikuar në Planin Vjetor të Konsultimeve Publike dhe në të paktën një dokument tjetër strategjik. Së fundi, vetëm katër projektakte ishin planifikuar ose në PPAP ose në PKIE, por nuk ishin renditur në Planin Vjetor të Konsultimeve Publike. Rreth tre të katërtat e projektakteve që morën një ose dy pikë ishin planifikuar më parë në PPAP, ndërsa një e treta ishin planifikuar në PKIE. Për sa u përket institucioneve, pjesa më e madhe e shembujve pozitivë vijnë nga Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, si i vetmi institucion që ka marrë 10 pikët e plota.

Tabela 28: Përfshirja e projektakteve të monitoruara në dokumentet strategjike të qeverisë dhe planin vjetor të konsultimeve publike

Treguesi 4.2: Projektaktet që e kanë origjinën nga dokumentet strategjike të qeverisë dhe plani vjetor i konsultimeve publike

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2
Projektakti 2	1	2	2	2	0	2	0	0	2	2
Projektakti 3	2	2	2	2	0	2	0	0	2	2
Projektakti 4	0	0	0	1	2	2	0	2	2	1
Projektakti 5	0	0	0	1	2	2	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	3	6	6	8	4	10	2	2	8	7
									Pikë Gjithsej	56/100


TREGUESI 4.3: OFRIMI I ARSYEVE NGA ANA E INSTITUCIONEVE PËR REFUZIMIN OSE PRANIMIN E PJESSHËM TË KOMENTEVE NË KONSULTIMET PUBLIKE

Ofrimi i arsyeve për refuzimin ose pranimin e pjesshëm të komenteve të dala nga konsultimet publike i lejon palët e interesit të kuptojnë më mirë arsyet pas vendimeve të qeverisë. Gjithashtu, ky proces ofron të dhëna të qarta për konsultimet ose vlerësimet e ardhshme, ndihmon për identifikimin e prirjeve në përgjigjet institucionale ndaj “feedback-ut” të publikut, dhe tregon qartë ndikimin e grupeve të caktuara në proces. Ai demonstroi edhe se kontributi i palëve të interesit vlerësohet edhe kur nuk është plotësisht i integruar në legjislacion. Kjo qasje forcon besimin ndërmjet vendimmarrësve dhe grupeve të tyre të synuara përkatëse. Kërkesa për rishikimin dhe shpjegimin e vendimeve të marra në bazë të komenteve të publikut parashikohet në ligjin për konsultimin publik dhe detajohet më tej në udhëzuesin e konsultimit publik.

Treguesi 4.3 vlerëson përgjigjet e institucioneve për komentet drejtuar 50 projektakteve, për të identifikuar nëse janë dhënë arsye për pranimin e pjesshëm ose refuzimin e komenteve përkatëse. Pikët për këtë tregues janë shpërndarë si më poshtë. Dy pikët e plota janë dhënë kur institucionet kanë përpiluar tabela komentesh, që përfshinin detaje të cilat tregojnë nëse komentet janë pranuar, janë pranuar pjesërisht ose janë refuzuar, së bashku me argumentimin shoqëruar. Një pikë është dhënë në rastet kur tabela e komenteve ka qenë e përpiluar, por nuk janë dhënë shpjegime gjithëpërfshirëse se përse komentet janë pranuar pjesërisht ose janë refuzuar. Zero pikë iu caktuan projektakteve për të cilat nuk janë përpiluar tabela komentesh, përfshirë rastet kur institucionet nuk e kanë bërë të qartë se nuk kanë marrë komente gjatë procesit të konsultimit.

Figura 22: Ofrimi i arsyeve nga ana e institucioneve për komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht për projektakt

Treguesi 4.3: Ofrimi i arsyeve nga ana e institucioneve për refuzimin ose pranimin e pjesshëm të komenteve në konsultimet publike



Për më shumë se gjysmën e konsultimeve të analizuar në këtë studim, institucionet nuk i kishin të disponueshme tabelat e komenteve dhe nuk kishin dhënë shpjegime se kjo ishte për shkak të mosmarrjes së komenteve nga publiku. Për më tepër, për projektakte të caktuara kishte komente që ishin hedhur në regjistrin elektronik dhe që nuk përmendeshin në asnjë tabelë komentesh. Shtatë nga 50 projektakte kishin tabela komentesh, por nuk përmbanin detajet e nevojshme që shpjegojnë se përse këto komente ishin pranuar, ishin pranuar pjesërisht apo ishin refuzuar. Së fundi, rreth një e treta e konsultimeve morën pikët e plota, pasi institucionet kishin ofruar tabela komentesh që përfshinin të gjitha detajet e nevojshme.

Sikurse tregohet në Figurën 22, kur institucionet kanë përpiluar tabela komentesh, zakonisht ato përfshijnë detajet e plota dhe respektojnë të gjitha kërkesat e vendosura me ligj. Pra, çështja kryesore është pikë së pari mungesa e praktikës së konsoliduar për hartimin e tabelave të komenteve dhe bërja e tyre publike, dhe më pas fakti që institucionet i përpilojnë tabelat në formatin e gabuar ose nuk shpërndajnë informacionin e nevojshëm.

Tabela 29: Performanca për ofrimin e arsyeve nga ana e institucioneve mbi komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht, për projektakt dhe institucion

Treguesi 4.3: Ofrimi i arsyeve për refuzimin/pranimin e pjesshëm të komenteve


Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	2	1	2	1	0	0	0	0	1
Projektakti 2	2	2	0	2	2	0	2	0	2	2
Projektakti 3	2	0	1	0	0	0	2	0	1	0
Projektakti 4	0	2	0	2	2	0	0	0	0	1
Projektakti 5	0	1	0	2	2	0	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	4	7	2	8	7	0	4	0	3	4
									Pikë Gjithsej	39/100

TREGUESI 4.4: VENDOSJA E PROCEDURAVE PËR ANKESAT E QYTETARËVE MBI SHKELJET E KONSULTIMIT PUBLIK

Publikimi i procedurave të ankimimit për shkeljet në konsultimet publike, ashtu si procese të tjera administrative, është i rëndësishëm për promovimin e llogaridhënies dhe nxitjen e besimit të publikut. Kjo qasje jo vetëm që demonstron angazhimin ndaj standardeve etike, por lejon edhe zgjidhjen në kohë të çështjeve që mund të lindin, duke përmirësuar integritetin e përgjithshëm të procesit. Nëpërmjet një kanali të strukturuar për ankesa, institucionet mund të mësojnë nga “feedback”-u, të përmirësojnë praktikën e tyre dhe të përforcojnë besimin e publikut në zotimin e tyre për angazhim të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Ligji për konsultimin publik i trajton procedurat për shqyrtimin e ankesave, duke e caktuar kreun e institucionit përgjegjës për t’i trajtuar ato për aq kohë sa konsultimi është në vazhdim, ndërsa Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton çdo apelim të dorëzuar pas miratimit të projektaktit. Për zbatimin e këtyre procedurave, institucionet duhet të përcaktojnë qartë se si individët mund t’i shprehin shqetësimet e tyre, përfshirë këtu ofrimin e modeleve, afateve kohore dhe pikave përkatëse të kontaktit.

Treguesi 4.4 kontrollon nëse institucionet kanë publikuar informacion për procedurat e ankimimit lidhur me shkelje në konsultimet publike. Institucionet kanë marrë zero pikë kur nuk ka pasur informacion publik të disponueshëm për procedurat e ankimimit në lidhje me konsultimet publike të zhvilluara nga ai institucion. Një pikë është dhënë kur institucioni ka ofruar disa informacione të përgjithshme për procedurat bazuar në ligjin përkatës, por jo informacion specifik si personi i kontaktit dhe formatin specifik të ankesës që supozohet të përdorë qytetari. Së fundi, dy pikët janë dhënë në rastet kur institucionet kanë publikuar procedura të qarta ankimimi për qytetarët e interesuar, së bashku me formatet e posaçme të ankesës dhe detajet se si mund të komunikohet me personin përgjegjës për procesin.

Figura 23: Performanca institucionale për vendosjen e procedurave për ankesat e qytetarëve kundrejt konsultimeve publike



Të gjitha institucionet, përveç njërit, nuk morën pikë për treguesin 4.4. Në përgjithësi, asnjëra prej institucioneve nuk kishte udhëzime të qarta për procedurën që duhet ndjekur në rast se një qytetar ka ankesa për proceset e konsultimit të zhvilluara nga institucioni. Këshilli i Ministrave ishte i vetmi institucion që mori një pikë, pasi ka krijuar platformën online të “bashkëqeverisjes”, e cila është një hapësirë ku qytetarët mund të raportojnë ankesa dhe shqetësime të çdo lloji lidhur me qeverinë qendrore. Megjithatë, kjo platformë nuk u dedikohet posaçërisht çështjeve të konsultimit publik dhe nuk ka prova se është përdorur për këtë qëllim.

Tabela 30: Performanca për vendosjen e procedurave për ankesat e qytetarëve kundrejt konsultimeve publike, për institucion

Treguesi 4.4: Krijimi i procedurave për ankesat e qytetarëve për shkeljet e konsultimit publik										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Pikët	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pikë Gjithsej										1/20


TREGUESI 4.5: OFRIMI NGA ANA E INSTITUCIONEVE E ARSYEVE PËR PËRJASHTIMIN E PROJEKTAKTEVE NGA KONSULTIMET PUBLIKE

Sipas ligjit për konsultimin publik, disa projektakte mund të përjashtohen nga konsultimi publik, si ato lidhur me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare, aktet administrative, aktet normative të miratuara nga Këshilli i Ministrave, emergjencat civile dhe raste të tjera përjashtimore të përcaktuara me ligj. Megjithatë, institucionet duhet të japin arsye për përjashtimin e projektakteve nga konsultimet publike për të siguruar transparencë, për të ruajtur besimin e publikut dhe për të parandaluar anashkalimin arbitrar të shqyrtimit publik. Udhëzuesi i konsultimit publik përcakton kriteret specifike për projektaktet që duhet t'i nënshtrohen procesit të konsultimit, duke theksuar interesin e lartë publik, angazhimin e palëve aktive të interesit dhe ndikimin e parashikuar të projektaktit për grupe të ndryshme të synuara. Gjithashtu, udhëzuesi ofron një matricë vlerësimi model për këtë proces, që përfshin arsyetimin për përjashtimin, sipas rastit.

Treguesi 4.5 shqyrton nëse institucionet kanë dhënë arsye për përjashtimin e disa projektakteve nga konsultimet publike. Institucionet morën dy pikë nëse rast se kishin ofruar informacione për aktet e përjashtuara nga procesi, si dhe argumentet gjithëpërfshirëse për këtë përjashtim, duke përdorur një matricë vlerësimi. Një pikë u dha kur kjo matricë ishte përgatitur, por nuk përmbante arsye të mjaftueshme për përjashtimin e akteve specifike. Së fundi, institucionet do të merrnin zero pikë nëse nuk kishin përgatitur një matricë vlerësimi për të shpjeguar përjashtimet.

Vlerësimi ynë konstatoi se asnjë nga 10 institucionet nuk kishte publikuar matrica vlerësimi për të shpjeguar përjashtimin e disa projektakteve nga konsultimet publike. Për këtë arsye, të gjitha institucionet morën zero pikë për vitet 2022 dhe 2023. Sidoqoftë, disa institucione si Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kanë ofruar përmbledhje të shkurtra për numrin e projektakteve që ishin përfshirë ose përjashtuar nga proceset e tyre të konsultimit, por pa ofruar arsyetimin se përse çdo përjashtim ishte konsideruar i nevojshëm.

Figura 24: Performanca e institucioneve lidhur me ofrimin e arsyeve për përjashtimin e projektakteve nga konsultimet publike, 2022–2023




TREGUESI 4.6: DEMONSTRIMI I NDIKIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK NË RAPORTIN VNR

Proceset si Vlerësimet e Ndikimit Rregullator (VNR) janë thelbësore për sigurimin e politikëbërjes së bazuar në prova dhe janë dobiprurëse për procesin e konsultimit në veçanti. Angazhimi i palëve të interesit nëpërmjet konsultimeve është një mënyrë efektive për të mbledhur të dhëna në funksion të vlerësimeve të ndikimit. Në të njëjtën kohë, përfshirja e informacionit se si ndikojnë konsultimet publike në procesin VNR ndihmon për të demonstruar ndikimin e “feedback-ut” të palëve të interesit në vendimet për politikën që në fillim. Vendimmarrja që mbështetet nga konsultimet dhe që bazohet te provat krijon besim dhe ligjshmëri ndërmjet palëve të interesit dhe publikut. Për më tepër, kjo qasje ndihmon për të identifikuar prirjet lidhur me shqetësimet dhe preferencat e komunitetit, duke siguruar që marrëdhëniet përfundimtare të jenë më efektive dhe në përputhje me nevojat e palëve të prekura. Në Shqipëri, procesi VNR rregullohet nga një dokument metodologjike i miratuar nga qeveria qendrore, i cili i autorizon politikëbërësit të kryejnë vlerësime ndikimi për ligjet dhe politikën e propozuara.

Treguesi 4.6 u përqendrua te fakti nëse institucionet kishin përfshirë, në raportet e tyre VNR, informacion mbi ndikimin e konsultimeve publike në projektakte specifike. Kur bëhet fjalë për pikëzimin, dy pikët e plota janë caktuar kur institucioni kishte identifikuar qartë ndikimin e konsultimeve publike në raportet VNR. Një pikë është caktuar kur institucionet kishin pranuar në përgjithësi ndikimin e konsultimeve publike në VNR, pa dhënë detaje të qarta. Së fundi, zero pikë janë caktuar në rastet kur raportet VNR nuk përmbanin informacion mbi ndikimin e konsultimeve publike, ose kur raportet VNR nuk ishin të publikuara.

Figura 25: Performanca për demonstrimin e ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR



Në përgjithësi, vlerësimi konstatoi se hartimi dhe publikimi i raporteve VNR për projektaktet nuk ishte një praktikë e zakonshme e institucioneve. Për më tepër, në raste të rralla kur raportet VNR ishin publikuar, kishte shumë gjasa që ato të mos përmbanin asnjë informacion për ndikimin që kanë patur konsultimet publike në raportin e ndikimit. Shtatë nga 10 institucionet nuk ia dolën të merrnin pikë për këtë tregues. Megjithatë, në shumë nga përgjigjet që institucionet kishin dhënë për KI, u vu re se raportet VNR hartohen vetëm për projektligje dhe jo për projektvendime. Megjithatë, metodologjia VNR e përdorur nga qeveria qendrore sugjeron që ky proces të zgjerohet nga ligjet te politikën, përfshirë aktet nënligjore.

Edhe në rastet kur janë hartuar raporte VNR, një numër i konsiderueshëm i tyre ishin publikuar pas përmbylljes së fazës së konsultimit, duke kufizuar në këtë mënyrë mundësinë për një proces konsultimi më të informuar si rezultat i vlerësimit të ndikimit. Nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dha të vetmin shembull të mirë, duke ofruar dokumentacion ku ishte përcaktuar qartë ndikimi i konsultimeve publike në raportet VNR. Ky projektakt specifik ishte ligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore” dhe ishte i vetmi që i mori të dyja pikët.

Tabela 31: Performanca për ofrimin e informacionit mbi demonstrimin e ndikimit të konsultimit publik në Raportin VNR, për institucion dhe projektakt

Treguesi 4.6: Nndikimi i konsultimit publik në Raportin VNR										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0
Projektakti 2	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Projektakti 3	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Projektakti 4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Projektakti 5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0
									Pikë Gjithsej	4/100

PARIMI V: GJITHËPËRFSHIRJA DHE MOSDISKRIMINIMI NË KONSULTIMET PUBLIKE

Në kontekstin e konsultimeve publike, parimet e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit janë thelbësore për të siguruar që zëra të ndryshëm të dëgjohen dhe merren në konsideratë. Konsultimet publike synojnë të mbledhin kontribute nga të gjitha segmentet e shoqërisë, pavarësisht prejardhjes, identitetit, statusit socio-ekonomik, ose karakteristikave të tjera individuale. Duke i dhënë përparësi gjithëpërfshirjes, vendimmarrësit mund të sigurojnë që grupet e marginalizuara dhe të nënpërfaqësuar të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në formësimin e politikave që prekin jetën e njerëzve. Në kontekstin e konsultimeve publike, këtu përfshihet marrja në konsideratë e nevojave, sfidave dhe karakteristikave të veçanta të grupeve të synuara, dhe përshtatja e procesit në mënyrë të tillë që t'i afrojë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e tyre.

PERFORMANCA E TREGUESVE TË GJITHËPËRFSHIRJES DHE MOSDISKRIMINIMIT

Brenda parimit, proceset e konsultimit morën pikët më të larta në treguesin 5.1 që lidhet me përshtatshmërinë e metodave të konsultimit. Nga 100 pikë të disponueshme, 53 pikë u morën këtu, gjë që tregon se institucionet janë mesatarisht të kujdesshme kur zgjedhin metodat e konsultimit për secilin prej projektave të tyre. Treguesit 5.3 dhe 5.2 morën rreth një të tretën e pikëve të mundshme (duke mbledhur përkatësisht 28% dhe 36% të pikëve të disponueshme). Për rrjedhojë, institucionet në fjalë kanë punë të konsiderueshme për të bërë për të siguruar, së pari, që grupet e interesit që mund të preken nga vendimmarrja të identifikohen që në fillim të procesit dhe, së dyti, që pjesëmarrja e aktorëve joqeveritarë në fazat e konsultimit të projektave të jetë e gjerë. Së fundi, treguesi 5.4 ishte një nga treguesit me performancën më të dobët në proceset e konsultimit, me pikët në nivelin 11%. Pra, me sa duket institucionet nuk sigurojnë pjesëmarrjen e grupeve të larmishme në fazën e hartimit të shumicës së akteve që kanë nxjerrë për konsultim.

Tabela 32: Treguesit e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti

1	Përshtatshmëria e metodave të përzgjedhura të konsultimit	53%
2	Larmia e grupeve pjesëmarrëse në konsultim publik	36%
3	Identifikimi paraprak i grupeve të ndikuara nga projektakti	28%
4	Larmia e grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit	11%

KRAHASIMI I GJITHËPËRFSHIRJES DHE MOSDISKRIMINIMIT NË KONSULTIMET PUBLIKE NDËRMJET INSTITUCIONEVE

Parimi i gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit grumbulloi rreth një të tretën e pikëve të disponueshme dhe ishte një nga parimet që pati performancën më të dobët. Institucionet e përfshira morën 129 pikë në total nga 400 të mundshme për këtë parim, pra 32% të pikëve totale. Nga 10 institucionet, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Brendshme ishin të vetmet që

morën pikët më të larta (përkatësisht 20, 19 dhe 18 pikë nga 40). Institucionet që morën pikët më të ulëta, konkretisht Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, morën përkatësisht vetëm tetë, shtatë dhe pesë pikë nga 40 për gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin.

Tabela 33: Performanca e institucioneve lidhur me gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin

Institution	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Mosdiskriminimin dhe Gjithëpërfshirjen (Max. 40)	10	20	8	18	19	7	13	5	17	12
PPërqindja për Mosdiskriminimin dhe Gjithëpërfshirjen	25%	50%	20%	45%	48%	18%	33%	13%	43%	30%
Total										129/400 (32%)

KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË GJITHËPËRFSHIRJES DHE MOSDISKRIMINIMIT NË KUADËR TË LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË MONITORUARA

Figura 26: Numri i projektakteve bazuar në performancën e tyre lidhur me gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin në konsultimet publike




Kur shohim shpërndarjen e pikëve për gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin ndërmjet 50 projektakteve, vihet re se asnjë nga këta të fundit nuk i ka marrë të teta pikët. Për më tepër, vetëm një projektakt, konkretisht ligji nr. 20/2023 “Për bletarinë” mori shtatë pikë nga tetë të mundshme. Vetëm dy projektakte morën gjashtë nga tetë pikë për treguesit e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit. Këto dy projektakte ishin konkretisht “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.

TREGUESI 5.1: IDENTIFIKIMI PARAPRAK I GRUPEVE TË NDIKUARA NGA PROJEKTAKTI

Identifikimi i grupeve me gjasë për t'u prekur nga vendimmarrja është thelbësor për institucionet, për të siguruar marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të duhura. Duke kuptuar ndikimin e mundshëm të vendimeve të tyre mbi palët e ndryshme të interesit, institucionet mund të përpiqen të zbutin pasojat negative dhe të trajtojnë shqetësimet përkatëse. Ky angazhim proaktiv jo vetëm që nxit drejtësinë, por mundëson edhe politika më të informuara dhe më efektive që pasqyrojnë nevojat dhe shqetësimet e të gjitha palëve të prekura. Në bazë të udhëzuesit për konsultimin publik, këto grupe duhet të identifikohen nga institucionet përmes përdorimit të matricës së analizës së palëve të interesit.

Treguesi 5.1 u përqendrua te fakti nëse institucionet kanë identifikuar paraprakisht grupet që preken nga projektakti në fjalë, së bashku me grupet përkatëse shtesë të interesit ose grupet e cenueshme. Për sa i përket pikëzimit, projektaktet morën dy pikë kur grupet përkatëse ishin identifikuar nga institucioni dhe ishin paraqitur në matricën e analizës që identifikonte të gjitha palët e prekura. Një pikë iu caktua projektakteve që kishin identifikuar grupet e interesit në njëfarë forme, por nuk kishin përpiluar një matricë analize për këtë qëllim. Së fundi, projektaktet merrnin zero pikë nëse nuk kishin identifikuar asnjë grup interesi përpara procesit të konsultimit publik.

Figura 27: Performanca për identifikimin paraprak të grupeve të ndikuara nga projektakti



Asnjë nga 50 proceset e konsultimit të analizuar për qëllimin e këtij studimi nuk kishte një matricë analize për grupet e interesit në dokumentet e tyre shoqëruese. Megjithatë, institucionet kishin shumë gjasa që të përfshinin informacion për grupet që mund të preken nga projektaktet e tyre. Informacioni për grupet e interesit gjendej shpesh në dokumentet shoqëruese, si në planin e konsultimit të projektakteve, dokumentet konsultuese dhe/ose raportet përkatëse VNR. Shembujt më të mirë për këtë vijnë nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të cilat katër nga pesë procese konsultimi kanë identifikuar paraprakisht grupet e interesit, pavarësisht se nuk kanë përpiluar matrica analize për këtë qëllim.

Tabela 34: Performanca për identifikimin paraprak të grupeve të ndikuara nga projektakti, për institucion dhe projektakt


Treguesi 5.1: Identifikimi paraprak i grupeve të ndikuara nga projektakti										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	1	1	1	0	0	0	0	1	1
Projektakti 2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Projektakti 3	1	0	0	1	0	0	1	1	1	0
Projektakti 4	0	0	0	0	1	0	0	1	1	1
Projektakti 5	1	0	0	1	1	0	1	0	0	0
Pikë Gjithsej	3	2	2	4	3	1	3	3	4	3
									Pikë Gjithsej	28/100

TREGUESI 5.2: LARMIA E GRUPEVE TË PËRFSHIRA NË FAZËN E HARTIMIT TË AKTIT

Angazhimi i zërave të larmishëm nga demografi, përvoja dhe pikëpamje të ndryshme garanton se projektaktet do të trajtojnë nevojat dhe shqetësimet e të gjithë komunitetit. Kjo qasje përmirëson dialogun, nxit zgjidhje më novatore dhe rezultate më të barabarta për shoqërinë në tërësi. Demonstrimi i provave për pjesëmarrje të larmishme tregon se institucioni ka arritur të përfshijë me sukses audiencën të ndryshme, duke zbatuar parimet e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit në ligjin për konsultimet publike. Megjithatë jo detyrim, nisja e kësaj përfshirjeje në fazën e hartimit është praktikë e mirë.

Treguesi 5.2 u përqendrua te larmia e pjesëmarrësve të përfshirë në fazën e hartimit të akteve, duke kontrolluar nëse në këtë fazë ishin përfshirë aktorë joshtetërorë, si sektorët privatë dhe jofitimprurës, grupe informale dhe qytetarë të interesuar. Projektaktet i morën të dyja pikët kur institucionet kishin raportuar për pjesëmarrjen e grupeve ose aktorëve të ndryshëm joqeveritarë në fazën e hartimit. Një pikë u dha në rastet kur ishte raportuar të paktën një grup ose aktor pjesëmarrës joqeveritar. Së fundi, institucionet morën zero pikë kur nuk kishin raportuar për pjesëmarrjen e ndonjë grupi qytetarësh ose joqeveritar në fazën e hartimit.

Figura 28: Performanca sa i përket larmisë së grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit



Vlerësimi konstatoi se dokumentet mbështetëse për 41 nga 50 projektakte nuk raportojnë për pjesëmarrjen e asnjë grupi apo aktori joqeveritar në fazën e hartimit. Shtatë raporte që shoqëronin projektaktet e analizuar përmendnin përfshirjen e të paktën një aktori joqeveritar në fazën e hartimit, ndërsa vetëm në dy projektakte ishin përfshirë grupe të ndryshme joqeveritare. Vetëm dy projektakte të propozuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u vlerësuan me pikë të plota sa i përket këtij treguesi. 'Ligji nr. 20/2023 për bletarinë' dhe 'Vendimi nr. 460 për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027' patën pjesëmarrje nga akademikë, OJF dhe grupe fermerësh, ndër të tjerë, në fazat përkatëse të hartimit. Megjithatë, duket se, në përgjithësi, institucionet qendrore nuk priren të përfshijnë aktorë joqeveritarë në fazën e hartimit të akteve përkatëse, por zgjedhin të bashkëpunojnë me institucionet dhe agjencitë e tjera shtetërore. Në fakt, përfshirja e grupeve joqeveritare dhe individëve haset më shpesh në fazën e konsultimit të projektakteve, pas përfundimit të hartimit të tyre.

Tabela 35: Performanca sa i përket larmisë së grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit, për institucion dhe projektakt


Treguesi 5.2: Larmia e grupeve të përfshira në fazën e hartimit të aktit										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	0	0	0	1	1	0	0	1	0
Projektakti 2	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0
Projektakti 3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Projektakti 4	0	1	0	0	2	0	0	0	0	0
Projektakti 5	0	1	0	0	2	0	0	0	0	0
Pikë Gjithsej	0	3	0	0	5	1	0	0	2	0
									Pikë Gjithsej	11/100

TREGUESI 5.3: LARMIA E GRUPEVE PJESËMARRËSE NË KONSULTIM PUBLIK

Kur individë me prejardhje, kultura dhe përvoja të ndryshme kontribuojnë gjatë konsultimeve publike, politikat rezultuese kanë më shumë gjasë t'i përgjigjen një game më të gjerë nevojash dhe shqetësimesh. Kjo qasje i ndihmon institucionet edhe për identifikimin e pikave të mundshme të dobëta dhe pasojave të paqëllimshme që mund të anashkalohen nga një grup homogjen apo dhe nga vetë ekspertët teknikë. Si përfundim, sikurse për treguesin pararendës, paraqitja e provave për një pjesëmarrje të larmishme në procesin e konsultimit publik tregon se institucioni ka arritur të përfshijë me sukses audienca të ndryshme, duke zbatuar parimet e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit në ligjin për konsultimet publike.

Treguesi 5.3 fokusohet te larmia e pjesëmarrëseve në proceset e konsultimit publik, duke vlerësuar nëse janë përfshirë aktorë të ndryshëm joshtetërorë. Institucionet që raportuan për pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme joqeveritare në fazën e konsultimit u vlerësuan me pikë të plota. Kur raportuan vetëm për një grup të caktuar joqeveritar, u vlerësuan me një pikë. Së fundi, në rastin e raportimit të mospjesëmarrjes së asnjë aktori joqeveritar në konsultim, institucionet u vlerësuan me zero pikë.

Figura 29: Performanca sa i përket larmisë së grupeve pjesëmarrëse në konsultimin për projektaktet
Treguesi 5.3: Larmia e grupeve pjesëmarrëse në konsultim publik



Vlerësimi konstatoi se dokumentet mbështetëse të thujse gjysmës së 50 projektakteve nuk përmendnin asnjë aktor joqeveritar pjesëmarrës në procesin përkatës të konsultimit. Nga ana tjetër, konsultimet për 14 projektakte përfshinin vetëm pjesëmarrës kryesorë të prekur drejtpërdrejt, ndërsa konsultimet për 11 prej tyre ishin ndjekur nga pjesëmarrës të ndryshëm. Institucioni me performancën më të lartë sa i përket këtij treguesi ishte Ministria e Drejtësisë, e vlerësuar me tetë nga 10 pikë të mundshme, pasi pjesa më e madhe e konsultimeve të kryera ishte ndjekur nga pjesëmarrës të ndryshëm.

Tabela 36: Performanca sa i përket larmisë së grupeve pjesëmarrëse në konsultim, për institucion dhe projektakt

Treguesi 5.3: Larmia e grupeve pjesëmarrëse në konsultim publik

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	2	1	1	1	0	0	0	1	1
Projektakti 2	1	2	0	0	1	0	2	0	1	2
Projektakti 3	1	0	2	0	0	0	0	1	2	0
Projektakti 4	0	2	0	2	2	0	0	1	0	1
Projektakti 5	0	2	0	2	1	0	1	0	0	0
Pikë Gjithsej	2	8	3	5	5	0	3	2	4	4


Pikë Gjithsej 36/100

TREGUESI 5.4: PËRSHTATSHMËRIA E METODAVE TË PËRZGJEDHURA TË KONSULTIMIT

Përzgjedhja e metodave të duhura të konsultimit me publikun, të përshtatura për grupet e synuara, është thelbësore për të siguruar mundësi konkrete për pjesëmarrje. Kjo qasje përfshin marrjen në konsideratë të nevojave dhe sfidave konkrete të palëve të ndryshme të interesit, ndërsa ndihmon për pakësimin e barrierave ndaj pjesëmarrjes. Në fakt, përdorimi i metodave të duhura dhe të përshtatura të konsultimit kontribuon për respektimin e parimeve të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në ligjin për konsultimet publike.

Treguesi për metodat e përzgjedhura të konsultimit vlerëson nëse metodat e zgjedhura për projektaktet ishin më të përshtatshmet në kontekstin e çështjes përkatëse, objektivave dhe grupeve të prekura. Çdo projektakt u vlerësua me pikë maksimale nëse metoda e përzgjedhur e konsultimit përshtatej me nevojat dhe kapacitetet e grupeve përkatëse të interesit, për të siguruar pjesëmarrjen e tyre. Nëse metoda e përzgjedhur e konsultimit bënte të mundur pjesëmarrjen e një pjese të grupeve të prekura, atëherë vlerësimi ishte me një pikë. Së fundi, nëse konstatohej se metoda e përzgjedhur nuk përshtatej me nevojat dhe kapacitetet e palëve të prekura apo të interesuara, vlerësimi ishte me zero pikë.

Figura 30: Performanca sa i përket përshtatshmërisë së metodave të përzgjedhura të konsultimit për çdo projektakt



Gjysma e proceseve të konsultimit u vlerësuan me një pikë, pasi institucionet kishin përdorur metoda konsultimi të zakonshme, si konsultimet elektronike ose kontaktimin e palëve përkatëse nëpërmjet e-mail-it. Konsultimi për këto projektakte pati një mungesë të përgjithshme të hapësirës së ndërveprimit ballë për ballë të palëve të interesuara, dhe përjashtoi qytetarët që nuk zotëronin njohuri apo mundësi për të ndërvepruar me institucionet në mënyrë elektronike. Megjithatë, në thujt një të tretën e rasteve të përgjithshme, institucionet shkuan përtej metodave të zakonshme, duke përfshirë metoda konsultimi shtesë, si takimet konsultuese, workshop-et, seancat publike dhe konferencat. Institucioni me rezultatin më të lartë për këtë tregues ishte Ministria e Brendshme, që u vlerësua me nëntë nga dhjetë pikë të mundshme.

Tabela 37: Performanca sa i përket përshtatshmërisë së metodave të përzgjedhura të konsultimit

Treguesi 5.4: Përshtatshmëria e metodave të përzgjedhura të konsultimit										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	1	1	1	2	1	1	1	0	2	1
Projektakti 2	1	2	1	1	1	1	2	0	2	2
Projektakti 3	1	1	1	2	0	1	2	0	2	0
Projektakti 4	1	1	0	2	2	1	0	0	0	1
Projektakti 5	1	1	0	2	2	1	2	0	1	1
Pikë Gjithsej	5	6	3	9	6	5	7	0	7	5
									Pikë Gjithsej	53/100

PARIMI VI: Pjesëmarrja Qytetare në Konsultimet Publike

Pjesëmarrja qytetare në konsultime publike është thelbësore për një demokraci funksionale dhe qeverisje efektive. Nëpërmjet angazhimit të individëve në proceset e vendimmarrjes, qeveritë mund të sigurojnë se politikat dhe legjislacioni do të trajtojnë nevojat dhe perspektivat e ndryshme të komunitetit. Kjo përfshirje promovon transparencën, përmirëson besimin ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe përforcon legjitimitetin e vendimeve qeveritare.

PERFORMANCA SA U PËRKET TREGUESVE PËR Pjesëmarrjen Qytetare

Në kontekstin e treguesve të pjesëmarrjes qytetare, 10 institucionet e monitoruara patën performancën më të lartë në treguesin që shqyrton nëse institucionet publikojnë listat e ekspertëve dhe grupeve të interesit, ku u arrit një nivel i përgjithshëm prej 80%. Më tej ishte treguesi që vlerësonte numrin e komenteve të mbledhura gjatë procesit të konsultimit (38%) dhe treguesi që vlerësonte nivelin e kategorizimit të të dhënave për angazhimin qytetar (për secilin Akt), në nivelin 29%. Treguesit e tjerë patën rezultate shumë më të ulëta, ku përfshihej niveli i kategorizimit të të dhënave për angazhimin qytetar gjatë një viti (13%), numri i pjesëmarrësve kontribues (5%), numri i aktorëve joqeveritarë pjesëmarrës në procesin e konsultimit (3%) dhe numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në procesin e hartimit (0%).

Tabela 38: Treguesit e pjesëmarrjes qytetare të renditur sipas performancës, nga më i larti te më i ulëti

1.	Krijimi i një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet	80%
2.	Numri i komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve	38%
3.	Kategorizimi i të dhënave të raportuara për angazhimin qytetar për çdo projektakt të konsultuar	29%
4.	Kategorizimi i të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar	13%
5.	Numri i pjesëmarrësve kontribues në procesin e konsultimit	5%
6.	Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në procesin e konsultimit	3%
7.	Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit	0%

KRAHASIMI I Pjesëmarrjes Qytetare Ndërmjet Institucioneve

Parimi i pjesëmarrjes qytetare ishte parimi me rezultatin më të ulët, me 69 nga 320 pikë gjithsej, ku përqindja e përgjithshme për institucionet e monitoruara ishte ndjeshëm nën nivelin mesatar, në 22%.

Ndër 10 institucionet, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit patën rezultatet më të larta sa i përket pjesëmarrjes qytetare, secila e vlerësuar me vetëm 12 nga 32 pikë të disponueshme. Më pas vinin Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, secila e vlerësuar me 10 nga 32 pikë. Performanca e institucioneve të tjera ishte shumë më e ulët, me rezultate që varionin nga një deri në gjashtë pikë nga 32 pikë të mundshme për nivelin e pjesëmarrjes qytetare në proceset përkatëse të konsultimit.

Tabela 39: Performanca e institucioneve lidhur me pjesëmarrjen qytetare

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MShMS	MIE	MTM
Pikët për Pjesëmarrjen Qytetare (Max. 32)	6	10	3	3	12	1	10	2	10	12
Përqindja për Pjesëmarrjen Qytetare	19%	31%	9%	9%	38%	3%	31%	6%	31%	38%
									Total	69/320 (21.5%)

KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË Pjesëmarrjes Qytetare në KUADËR TË Ligjeve dhe Politikave të Monitoruara

Sa i përket nivelit të pjesëmarrjes qytetare në proceset e konsultimit, shumica e 50 projektakteve të monitoruara (29) u vlerësuan me zero pikë, ndërsa 13 projektakte të tjera u vlerësuan me një pikë. Vetëm tetë nga 50 dokumentet e monitoruara u vlerësuan maksimalisht me dy pikë.

Ndër dokumentet me pikët më të larta për pjesëmarrjen qytetare në proceset e konsultimit publik, shumica (gjashtë nga tetë) ishin projektligje, dhe vetëm dy nga tetë ishin vendime të Këshillit të Ministrave ose dokumente strategjike kombëtare. Nga ana tjetër, ndër dokumentet me pikët më të ulëta, 10 nga 29 ishin vendime të Këshillit të Ministrave ose dokumente strategjike kombëtare, ndërsa 19 ishin projektligje.

Tabela 40: Performanca sa i përket pjesëmarrjes qytetare në konsultime sipas numrit të projektakteve

Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2 pikë)	Numri i projektakteve
0 pikë	29
1 pikë	13
2 pikë	8

TREGUESI 6.1: Krijimi i një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet

Sipas udhëzuesit për konsultimin, institucionet duhet të zhvillojnë dhe mirëmbajnë një bazë të dhënash të palëve të interesit të përfshira në proceset e tyre të konsultimit, duke përfshirë edhe informacionin e kontaktit të grupeve përkatëse të interesit. Megjithatë, është e rëndësishme që këto baza të dhënash të rishikohen rregullisht për të siguruar se janë të sakta dhe të përshtatshme, dhe se mund të përdoren për kontekstin konkret të një dokumenti. Gjithashtu, institucionet duhet të sigurojnë transparencën e kësaj liste dhe t'u japin të gjitha palëve të interesit mundësinë që të pajtohen në të, me qëllim që të marrin njoftime dhe ftesa lidhur me konsultimet publike.

Ky tregues vlerësoi nëse institucioni ka krijuar një bazë të dhënash të grupeve të mundshme të interesit, që është e disponueshme publikisht, dhe nëse baza e të dhënave në fjalë përfshin një gamë të larmishme aktorësh nga sektorë të ndryshëm. Nëse institucioni i përmbushte të dyja kriteret, atëherë vlerësohej me dy pikë. Nëse baza e të dhënave ishte publike, por i mungonte larmia dhe përfaqësimi sektorial, institucioni vlerësohej me një pikë. Së fundi, nëse institucioni nuk kishte krijuar dhe as publikuar një listë grupesh të mundshme interesi, atëherë vlerësohej me zero pikë.

Figura 31: Performanca e institucioneve sa i përket krijimit të një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet

Treguesi 6.1: Krijimi i një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet



Performanca e përgjithshme e institucioneve për treguesin 6.1 ishte në nivelin 80%, duke qenë përqindja më e lartë për treguesit e pjesëmarrjes qytetare. Për shkak se baza e të dhënave është një dokument i veçantë dhe i vetëm, është e rëndësishme të theksohet se ky tregues është vlerësuar vetëm një herë për secilin institucion.

Në vlerësimin e performancës institucionale për këtë tregues, tetë nga 10 institucionet u vlerësuan maksimalisht me dy pikë, çka tregon se kishin publikuar lista gjithëpërfshirëse të palëve të interesit. Për shembull, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme kanë krijuar secila një bazë të dhënash të larmishme dhe gjithëpërfshirëse palësh interesi. I vetmi përjashtim ishte Këshilli i Ministrave dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, që nuk kishin paraqitur asnjë listë, qoftë publikisht apo në përgjigjet ndaj KI. Pavarësisht nga kjo, mund të arrihet në përfundimin se hartimi dhe publikimi i një liste institucionale ekspertësh dhe grupesh interesi është shndërruar në një praktikë standarde për institucionet.

Tabela 41: Performanca sa i përket krijimit të një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet

Treguesi 6.1: Krijimi i një baze institucionale të dhënash të grupeve të interesit dhe ekspertëve për konsultimet											
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM	
Institucioni	0	2	2	2	2	0	2	2	2	2	
Total									Pikë Gjithsej	16/20 ose 80%	


TREGUESI 6.2: NUMRI I Pjesëmarrësve Joqeveritarë në Fazën e Hartimit të Aktit

Organizimi i konsultimeve në fazë të hershme është opsional sipas ligjit për konsultimet, por kjo praktikë konsiderohet gjithsesi si qasje me efektivitet dhe rëndësi të lartë. Konsultimet u mundësojnë institucioneve perspektiva dhe rekomandime të vlefshme përpara hartimit të dokumentit. Kjo përfshirje mund të kryhet nëpërmjet diskutimeve të hershme ose përfshirjes së palëve të interesit joqeveritare në grupin e punës të caktuar për hartimin e aktit. Zakonisht, përfshirja e sugjerimeve është më e lehtë në këtë fazë të hershme të procesit sesa pas hartimit të një projektakti të konsoliduar. Megjithatë, vendimi për kryerjen e konsultimeve në fazë të hershme i përket institucionit.

Treguesi 6.2 vlerëson nëse institucioni ka ndërmarrë përpjekje për të përfshirë aktorë joqeveritarë në procesin e hartimit të politikave ose akteve ligjore, përpara nisjes së fazës së konsultimit publik. Mbështetur te statistikat vjetore për pjesëmarrjen, institucionet u vlerësuan me dy pikë nëse mbi 100 palë interesi kishin qenë pjesë e procesit të hartimit. Nëse pjesëmarrja përfshinte 50-99 palë interesi në vit, institucionet u vlerësuan me një pikë. Nëse pjesëmarrja përfshinte më pak sesa 50 palë interesi, institucionet u vlerësuan me zero pikë. Megjithëse nuk është dakorduar një vlerë e caktuar sa i përket numrit të pjesëmarrësve në fazën e hartimit në një vit të caktuar, këto shkallë matëse janë formuluar në bazë të shifrave vjetore mesatare të raportuara nga qeveria.

Figura 32: Performanca e institucioneve sa i përket numrit të pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit

Treguesi 6.2: Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit



Numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në procesin e hartimit u vlerësua dy herë për secilin institucion (në bazë vjetore, për vitet 2022 dhe 2023).

Nga shtatë treguesit përbërës të parimit të pjesëmarrjes qytetare, përfshirja e aktorëve joqeveritarë në fazën e hartimit renditet e fundit, me një rezultat prej 0%. Asnjë nga institucionet nuk paraqiti prova të mjaftueshme të përfshirjes së të paktën 50 palëve joqeveritare të interesit në proceset e hartimit të politikave ose dokumenteve ligjore gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Tabela 42: Performanca bazuar te numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit gjatë periudhës 2022-2023, për institucion

Treguesi 6.2: Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në fazën e hartimit të aktit										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2023	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
									Pikë Gjithsej	0/40 ose 0%


Mund të arrihet në përfundimin se përfshirja e aktorëve joqeveritarë në fazat e hershme të hartimit të ligjeve dhe politikave është një praktikë shumë e rrallë në institucionet shqiptare. Për më tepër, kur ndodh përfshirja, ajo shoqërohet me mungesë transparence në lidhje me provat e disponueshme për ta mbështetur atë. Zakonisht, institucionet raportojnë statistika të përmbledhura për pjesëmarrësit e përfshirë në fazën e hartimit, pa bërë dallime ndërmjet aktorëve joqeveritarë dhe qytetarëve, nga njëra anë, dhe institucioneve publike, konsulentëve ndërkombëtarë, donatorëve ose organizatave që ofrojnë ekspertizë teknike, nga ana tjetër. Në këtë mënyrë, krijohet një përshtypje e gabuar se konsultimet ndërinstitucionale dhe ekspertiza teknike e jashtme mund të llogariten si konsultim publik. Për qëllime të vlerësimit të këtij treguesi, numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në procesin e hartimit u nxor në mënyrë manuale prej raporteve individuale dhe dokumenteve të tjera të disponueshme për konsultimin, për të shmangur numërimin e pjesëmarrësve që nuk ishin aktorë joqeveritarë, subjekte apo qytetarë. Megjithatë, për shkak të mungesës së transparencës në disa prej dokumenteve të konsultimit, duhet theksuar se të dhënat e disponueshme ishin të kufizuara (një sfidë e hasur edhe për treguesit e tjerë).

TREGUESI 6.3: NUMRI I Pjesëmarrësve Joqeveritarë në Procesin e Konsultimit

Kur pjesëmarrësit në konsultime publike përfaqësojnë grupe të larmishme palësh interesi, si organizatat e shoqërisë civile, grupet e advokimit, ekspertët dhe komunitetet e prekura, procesi fiton vlerë prej perspektivave të ndryshme dhe ekspertizës së gjerë, çka mundëson një nivel më të thelluar të kuptuari për çështjet e trajtuara. Regjistrimi i numrit të pjesëmarrësve joqeveritarë në proceset e konsultimit ofron informacion se sa përfaqësues dhe gjithëpërfshirës është konsultimi, ndërsa u shërben institucioneve edhe për të vlerësuar ecurinë e tyre drejt sigurimit të sistemeve me pjesëmarrje të vërtetë.

Ky tregues vlerëson nivelin e pjesëmarrjes së aktorëve joqeveritarë në procesin e konsultimit të politikave dhe akteve ligjore. Mbështetur te statistikave vjetore për pjesëmarrjen, u përcaktua se institucionet do të vlerësoheshin me dy pikë nëse mbi 175 palë interesi kanë qenë pjesë e konsultimeve. Nëse pjesëmarrja përfshinte 75-174 palë interesi në vit, institucionet u vlerësuan me një pikë. Nëse pjesëmarrja përfshinte më pak sesa 75 palë interesi, institucionet u vlerësuan me zero pikë. Megjithatë nuk është përcaktuar një vlerë e synuar sa i përket numrit të pjesëmarrësve që duhet të përfshihen në proceset e konsultimit, këto shkallë matëse janë formuluar në bazë të shifrave vjetore mesatare të raportuara nga qeveria për këtë qëllim.

Figura 33: Numri i institucioneve duke u bazuar te performanca për sigurimin e pjesëmarrësve joqeveritarë në procesin e konsultimit



Sikurse treguesi pararendës, numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në procesin e konsultimit u vlerësua dy herë për secilin institucion (në bazë vjetore, për vitet 2022 dhe 2023).

Nga shtatë treguesit për pjesëmarrjen qytetare, përfshirja e aktorëve joqeveritarë në procesin e konsultimit (në bazë vjetore) renditet e dyta nga fundi, me një rezultat prej vetëm 2.5%. Vetëm njëri nga institucionet, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, paraqiti prova të mjaftueshme të përfshirjes së të paktën 75 palëve joqeveritare në proceset përkatëse të konsultimit për vitin 2023, duke u vlerësuar me një pikë nga dy pikë gjithsej. Me përjashtim të këtij rasti, nuk u konstatua thujt asnjë dallim gjatë krahasimit të performancës institucionale ndërmjet vitit 2022 dhe 2023.

Tabela 43: Performanca bazuar te numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në konsultime gjatë periudhës 2022-2023, për institucion

Treguesi 6.3: Numri i pjesëmarrësve joqeveritarë në procesin e konsultimit

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2023	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
									Pikë Gjithsej	1/40 ose 2.5%

Mund të arrihet në përfundimin se mungojnë prova transparente sa i përket numrit të aktorëve joqeveritarë, që marrin pjesë në proceset e konsultimit. Në mënyrë të ngjashme me praktikat e raportimit për fazën e hartimit, shpeshherë institucionet mundësojnë statistika të përmbledhura për pjesëmarrësit, pa bërë dallime ndërmjet aktorëve joqeveritarë dhe qytetarëve, nga njëra anë, dhe institucioneve publike, konsulentëve ndërkombëtarë, donatorëve dhe ekspertëve teknikë, nga ana tjetër.

Kjo metodë na pengon të kuptojmë qartë pjesëmarrjen qytetare, duke përfshirë në mënyrë të gabuar aktorë të tjerë, që shpesh janë aktorë qeveritarë. Gjithashtu, raportet vjetore përdorin shpeshherë gjuhë të paqartë, me deklarata si 'pjesëmarrësit në konsultime publike përfshijnë përfaqësues të universiteteve, medias, shoqatave të ndryshme, të shoqërisë civile dhe institucioneve publike', në vend që të paraqesin statistika të qarta sa i përket llojit të pjesëmarrësve. Për qëllime të këtij raporti, numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në procesin e konsultimit u nxor në mënyrë manuale prej raporteve individuale, për të shmangur numërimin e pjesëmarrësve që nuk ishin aktorë joqeveritarë, subjekte apo qytetarë. Megjithatë, për shkak të mungesës së transparencës në disa raporte individuale (transparenca e përgjithshme u vlerësua në 60%), edhe të dhënat e disponueshme ishin të kufizuara.


TREGUESI 6.4: NUMRI I Pjesëmarrësve Kontribues në Procesin e Konsultimit

Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në mënyrë aktive në proceset e konsultimit nëpërmjet ndarjes së komenteve dhe sugjerimeve të tyre është një parametër thelbësor për vlerësimin e efektivitetit dhe vërtetësisë së procesit. Kur një grup i larmishëm palësh interesi, ku përfshihen shoqatat e organizatës civile, grupet e advokimit, ekspertët dhe komunitetet e prekura, merr pjesë në takime dhe, njëkohësisht, angazhohet në mënyrë domethënëse, kjo tregon se konsultimi ka arritur te palët e rëndësishme dhe i ka përfshirë ato në mënyrë të suksesshme. Pjesëmarrja aktive siguron se procesi nuk është thjesht formalitet apo një aktivitet fiktiv, por një përpjekje konkrete për të mbledhur dhe ndërthurrur një spektër të gjerë perspektivash.

Treguesi 6.4 mat nivelin e angazhimit të aktorëve joqeveritarë në proceset e konsultimit të 10 institucioneve të monitoruara për vitet 2022 dhe 2023. Bazuar te statistikat vjetore të mundësuar, një institucion do të vlerësohej me dy pikë nëse kishte pasur kontribut aktiv nga më shumë se 48 palë interesi në konsultimet e kryera. Nëse numri vjetor i kontribuesve kishte qenë nga 20 në 47, institucioni do të vlerësohej me një pikë. Së fundi, institucionet do të vlerësoheshin me zero pikë nëse numri i palëve të interesit që kanë kontribuar në konsultimet gjatë vitit ishte më i vogël sesa 20. Megjithëse nuk është përcaktuar një vlerë e synuar sa i përket numrit të pjesëmarrësve kontribues të parashikuar në proceset e konsultimit, këto shkallë matëse janë formuluar në bazë të shifrave vjetore mesatare të raportuara nga qeveria për këtë qëllim.

Figura 34: Performanca e institucioneve për sigurimin e përfshirjes së pjesëmarrësve kontribues në proceset e konsultimit

Treguesi 6.4: Numri i pjesëmarrësve kontribues në procesin e konsultimit



Sikurse treguesi pararendës, numri i pjesëmarrësve kontribues të përfshirë në konsultimet publike u vlerësua dy herë për secilin institucion (në bazë vjetore, për vitet 2022 dhe 2023).

Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte shumë e ulët, në nivelin 5%. Sa u përket rezultateve të institucioneve, nëntë nga 10 institucione u vlerësuan me zero pikë si për vitin 2022, po ashtu edhe për vitin 2023. I vetmi përjashtim ishte Ministria e Financave dhe Ekonomisë asokohe, që paraqiti prova të mjaftueshme të pjesëmarrjes së më shumë se 20 kontribuesve, për secilin vit.

Tabela 44: Performanca bazuar te numri i pjesëmarrësve kontribues në konsultime gjatë periudhës 2022-2023, për institucion

Treguesi 6.4: Numri i pjesëmarrësve kontribues në procesin e konsultimit										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0
2023	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0
Total	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0
									Pikë	2/40 ose
									Gjithsej	5%

Duhet theksuar se identifikimi i saktë i numrit të pjesëmarrësve që kontribuan në proceset e konsultimit publik ka qenë sfidues për shkak të raportimit të paqartë të statistikave, një problematikë e konstatuar edhe në rastin e treguesve të tjerë. Gjithashtu, kur raportet individuale të konsultimit, që shërbyen si burim për identifikimin e të dhënave në fjalë, nuk përfshijnë hollësi për komentet e marra, identifikimi i kontribuesve është teknikisht i pamundur. Edhe kur institucionet ishin transparente për komentet e mbledhura gjatë konsultimeve dhe kishin identifikuar kontribuesit, rrallëherë kishin sqaruar nëse të gjitha komentet, të mbledhura nëpërmjet metodave të ndryshme (takime publike, regjistrë elektronik, e-mail, postë, etj.), ishin konsoliduar në një dokument të vetëm për të siguruar një mbulim gjithëpërfshirës të të gjitha përshtypjeve të ndara. Prandaj, në mungesë të transparencës, të dhënat e disponueshme të përdorura për vlerësimin e këtij treguesi ishin të kufizuara.

TREGUESI 6.5: NUMRI I KOMENTEVE TË MBLEDHURA GJATË KONSULTIMEVE

Numri i komenteve të mbledhura gjatë proceseve të konsultimit është një tjetër parametër i rëndësishëm për matjen e efektivitetit dhe vërtetësisë së angazhimit të palëve të interesit. Ndryshe nga numërimi i thjeshtë i pjesëmarrësve, që tregojnë shkallën e përfshirjes, vëllimi i lartë i komenteve mundëson të kuptuarit e nivelit të angazhimit dhe larmisë së përshtypjeve të publikut. Nga ana tjetër, numri i vogël i komenteve (ose mungesa e tyre) mund të jetë tregues i faktit se, pavarësisht pjesëmarrjes, angazhimi i palëve të interesit ka qenë sipërfaqësor, çka sinjalizon nevojën për përmirësimin e mënyrës se si proceset e konsultimit nxisin kontributet e pjesëmarrësve. Megjithatë mund të përputhet me treguesin pararendës, ky parametër mundëson të kuptuarit përtej numrit të pjesëmarrësve kontribues, pasi një pjesëmarrës mund të ndajë disa komente ose rekomandime, duke ndikuar te numri i përgjithshëm i komenteve.


Ky tregues mat vëllimin e komenteve prej aktorëve joqeveritarë në proceset e konsultimit të 10 institucioneve të monitoruara për vitet 2022 dhe 2023. Bazuar te statistikave vjetore të mundësuar, një institucion do të vlerësohej me dy pikë nëse gjatë konsultimeve të kryera ishin paraqitur më shumë sesa 50 komente. Nëse numri vjetor i komenteve ishte nga 20 në 49, institucioni do të vlerësohej me një pikë. Institucionet që kishin mbledhur më pak sesa 20 komente gjatë konsultimeve të kryera për një vit, do të vlerësoheshin me zero pikë. Megjithatë nuk është përcaktuar një vlerë formale e synuar sa i përket

numrit të komenteve të parashikuara që duhet të mblidhen gjatë secilit proces konsultimi, këto shkallë matëse janë formuluar në bazë të shifrave vjetore mesatare të raportuara nga qeveria. Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 38%, duke qenë përqindja e dytë më e lartë për treguesit e pjesëmarrjes qytetare, pavarësisht nga fakti se ishte nën rezultatin mesatar.

Sikurse treguesi pararendës, numri i komenteve të mbledhura në konsultimet publike u vlerësua dy herë për secilin institucion (në bazë vjetore, për vitet 2022 dhe 2023).

Figura 35: Performanca e institucioneve sa i përket mbledhjes së komenteve gjatë konsultimeve

Treguesi 6.5: Numri i komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve



Sa i përket performancës së institucioneve për këtë tregues, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë asokohe patën numrin më të madh të komenteve në vit, ku secila u vlerësua me tri nga katër pikë për periudhën 2022-2023. Pjesa më e madhe e institucioneve të tjera u vlerësuan me një ose dy pikë nga katër gjithsej, me përjashtim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore, që u vlerësuan me zero pikë për të dyja vitet. Krahasimi i numrit të komenteve vjetore të mbledhura prej aktorëve joqeveritarë gjatë dy viteve nxori në pah një rënie të lehtë në vitin 2023. Gjatë vitit 2023, pesë institucione u vlerësuan me zero pikë, katër me një pikë, dhe vetëm një u vlerësua maksimalisht me dy pikë. Ndërsa në vitin 2022, dy institucione u vlerësuan maksimalisht me dy pikë, pesë institucione u vlerësuan me një pikë dhe tri institucione u vlerësuan me zero pikë.

Tabela 45: Performanca bazuar te numri i komenteve të mbledhura në konsultime gjatë periudhës 2022-2023, për institucion

Treguesi 6.5: Numri i komenteve të mbledhura gjatë konsultimeve										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	1	2	1	1	2	0	1	0	1	0
2023	1	1	0	0	1	0	2	0	0	1
Total	2	3	1	1	3	0	3	0	1	1
									Pikë	15/40 ose
									Gjithsej	37.5%

Është e rëndësishme të theksohet se, për shkak të të dhënave dhe statistikave të kufizuara që u mundësuan nga shumica e institucioneve, numri i komenteve të mbledhura çdo vit nga secili institucion u desh të nxirrej manualisht prej raporteve individuale dhe vjetore të konsultimit, gjatë procesit të monitorimit. Qëllimi i kësaj qasjeje ishte shmangia e përfshirjes së komenteve që nuk ishin paraqitur prej aktorëve joqeveritarë, subjekteve dhe qytetarëve. Megjithatë, sikurse u përmend më herët, nuk është gjithmonë e qartë nëse komentet e mbledhura nëpërmjet metodave të ndryshme janë konsoliduar në një dokument të vetëm nga institucioni përkatës, çka do të siguronte një mbulim gjithëpërfshirës të të gjitha përshtypjeve të marra gjatë konsultimeve. Prandaj, në mungesë të transparencës, të dhënat e nxjerra, të përdorura për vlerësimin e këtij treguesi, ishin të kufizuara.

TREGUESI 6.6: KATEGORIZIMI I TË DHËNAVE TË RAPORTUARA PËR ANGAZHIMIN QYTETAR PËR ÇDO PROJEKTAKT TË KONSULTUAR


Gjatë raportimit të statistikave për angazhimin qytetar, si numri i pjesëmarrësve, kontribuesve ose komenteve, një praktikë e mirë për institucionet është kategorizimi i palëve të interesit sipas llojit (qeveritarë ose joqeveritarë), nivelit të organizimit, ekspertizës, llojit të kontributit të ofruar dhe metodave të konsultimit të përdorura. Kjo qasje lehtëson kryerjen e një analize të hollësishme të përfshirjes dhe ndikimit të grupeve të ndryshme në procesin e konsultimit publik dhe bën të mundur vlerësimin e efektivitetit të metodave të ndryshme të konsultimit.

Ky tregues vlerëson nëse institucionet kanë publikuar të dhëna statistikore të detajuara dhe të kategorizuara për pjesëmarrjen qytetare në konsultimin e projektakteve të caktuara, duke përfshirë informacione për llojin e aktorëve pjesëmarrës, kontributeve përkatëse dhe ndikimit të tyre te procesi. Gjithashtu, vlerëson edhe nëse institucionet kanë raportuar për audiencën e përgjithshme të mbuluar kur nuk ka pasur asnjë koment të mbledhur, dhe nëse i kanë analizuar arsyet e mungesës së pjesëmarrjes. Institucionet që përmbushën këto kritere u vlerësuan me dy pikë. Nëse institucionet kishin publikuar të dhëna për numrin e pjesëmarrësve, por nuk i kishin kategorizuar ato, u vlerësuan me një pikë. Së fundi, institucionet që nuk kishin publikuar asnjë të dhënë statistikore për pjesëmarrjen qytetare ose informacion për audiencën e mbuluar, u vlerësuan me zero pikë.

Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 29%. Në ndryshim nga treguesit vjetorë të vlerësuar më sipër, ky tregues është vlerësuar për çdonjërin prej 50 projektakteve të monitoruara, duke rezultuar në pesë vlerësime të veçanta gjithsej për çdo institucion.

Figura 36: Performanca për kategorizimin e të dhënave të raportuara për pjesëmarrjen qytetare, për projektakt

Treguesi 6.6: Kategorizimi i të dhënave të raportuara për angazhimin qytetar për çdo projektakt të konsultuar



Gjatë vlerësimit të performancës së institucioneve për kategorizimin e të dhënave për angazhimin qytetar për çdo projektakt, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit arriti rezultatin më të lartë, me gjashtë nga 10 pikë gjithsej. Më pas vinin Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, secila e vlerësuar me pesë nga 10 pikë. Gjashtë institucionet e tjera u vlerësuan në nivelin mesatar për këtë tregues, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u vlerësuan me zero pikë secila.

Gjatë shqyrtimit të kategorizimit të të dhënave për angazhimin qytetar, shumica e projektakteve (29 nga 50 dokumentet e monitoruara) u vlerësuan me pikët minimale, pra me zero pikë. 13 projektakte u vlerësuan me një pikë, ndërsa vetëm tetë projektakte u vlerësuan maksimalisht me dy pikë për institucionet që kishin raportuar të dhëna statistikore të detajuara për pjesëmarrjen qytetare.

Tabela 46: Performanca bazuar te kategorizimi i të dhënave të raportuara për angazhimin qytetar, për institucion dhe projektakt

Treguesi 6.6: Kategorizimi i të dhënave të raportuara për angazhimin qytetar për çdo projektakt të konsultuar

Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
Projektakti 1	0	1	0	0	1	1	0	0	1	2
Projektakti 2	2	1	0	0	2	0	1	0	1	2
Projektakti 3	2	0	0	0	0	0	1	0	2	0
Projektakti 4	0	2	0	0	1	0	0	0	1	2
Projektakti 5	0	1	0	0	1	0	1	0	0	0
Pikë Gjithsej	4	5	0	0	5	1	3	0	5	6
									Pikë Gjithsej	29/100 ose 29%

Raportimi institucional për rezultatet e konsultimit për çdo projektakt priret të jetë i paplotë, pa kategorizim të detajuar të metodave të përdorura, llojeve të palëve të interesit të përfshira dhe përshtypjeve të ndara prej pjesëmarrësve. Mungesa e kategorizimit të të dhënave do të thotë se raportet nuk bëjnë dallim ndërmjet palëve publike dhe jopublike të interesit, dhe se nuk i kategorizojnë përshtypjet e ndara sipas llojit të palëve të interesit, nivelit organizativ apo ekspertizës.

Për shembull, raporti i konsultimit për Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 'Gjyqësori dhe të drejtat themelore', përfshin informacion për numrin e pjesëmarrësve prej organizatave të shoqërisë civile, akademisë, grupeve të interesit dhe medias. Megjithatë, raporti përmend qartësisht vetëm tri organizatat që kanë paraqitur komente. Në mënyrë të ngjashme, raporti i konsultimit për projektligjin 'Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë' përshkruan takime të ndryshme, nivelin e mbulimit dhe komentet e marra, por nuk përcakton individët apo subjektet që kanë ndarë përshtypjet. Në të përmenden vetëm 'operatorët e telekomunikacionit' si kontribues. Megjithatë, vlen të përmendet se ka pasur raste raportimi të të dhënave gjithëpërfshirëse për angazhimin qytetar, si në rastin e 'Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030' dhe ligjit 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë', ndër të tjera.

Duhet të theksohet se institucionet nuk i kanë shënuar të gjitha metodat e konsultimit të përdorura dhe se ndonjëherë nuk dokumentojnë çdo proces konsultimi të kryer gjatë vitit. Në fakt, konsultimet informale të ndërmarra nga institucioni, konsultimet për projektaktet e papublikuara, konsultimet në fazën e hershme dhe ato të kryera nga kontraktorë privatë për projektet strategjike priren të mos përfshihen. Kjo mungesë raportimi gjithëpërfshirës na pengon të analizojmë plotësisht përfshirjen e palëve të interesit.

TREGUESI 6.7: KATEGORIZIMI I TË DHËNAVE VJETORE TË RAPORTUARA PËR ANGAZHIMIN QYTETAR

Po aq thelbësore janë edhe statistikat vjetore të raportuara nga institucionet për angazhimin qytetar. Në mënyrë të ngjashme me raportet për konsultimin e projektakteve të veçanta të lartpërmendura, raportet vjetore të hartuara për konsultimet publike duhet të përfshijnë informacion për numrin e pjesëmarrësve, kontribuesve dhe komenteve. Një praktikë e mirë për institucionet është kategorizimi i palëve të interesit sipas llojit (qeveritarë ose joqeveritarë), nivelit të organizimit, ekspertizës, llojit të kontributit të ofruar dhe metodave të konsultimit të përdorura. Kjo qasje mundëson kryerjen e një analize të hollësishme të përfshirjes dhe ndikimit të grupeve të ndryshme në procesin e konsultimit publik dhe bën të mundur vlerësimin e efektivitetit të metodave të ndryshme.

Treguesi 6.7 vlerëson nëse institucionet kanë publikuar statistika vjetore të detajuara dhe të kategorizuara për pjesëmarrjen qytetare në konsultimet përkatëse, duke përfshirë informacione për llojin e aktorëve pjesëmarrës, kontributet përkatëse dhe ndikimin e tyre te procesi. Nëse kriteret ishin përmbushur, institucionet u vlerësuan maksimalisht me dy pikë. Institucionet që kishin përfshirë disa të dhëna për pjesëmarrjen, por jo në nivelin gjithëpërfshirës të informacionit të përcaktuar më sipër, u vlerësuan me një pikë. Institucionet që nuk kishin publikuar asnjë të dhënë statistikore apo informacion për pjesëmarrjen, u vlerësuan me zero pikë.

Figura 37: Performanca sa i përket kategorizimit të të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar



Performanca e përgjithshme e institucioneve për këtë tregues ishte në nivelin 13%. Sikurse në rastin e disa prej treguesve pararendës, statistikat vjetore për pjesëmarrjen qytetare u vlerësuan dy herë për çdo institucion (një herë në vit në 2022 dhe 2023).

Gjatë vlerësimit të performancës së institucioneve për kategorizimin e statistikave për pjesëmarrjen qytetare në konsultimet përkatëse, shtatë nga 10 institucione u vlerësuan me zero pikë. Tri institucionet e tjera, që patën një performancë më të mirë, ishin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (vlerësuar me dy nga katër pikë), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (vlerësuar me dy nga katër pikë) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (vlerësuar me një nga katër pikë). Nuk u konstatua dallim domethënës në performancën e institucioneve ndërmjet viteve 2022 dhe 2023.

Tabela 47: Performanca bazuar te kategorizimi i të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar. për institucion

Treguesi 6.7: Kategorizimi i të dhënave vjetore të raportuara për angazhimin qytetar										
Institucioni	KM	MD	MAS	MB	MBZHR	AMBU	MFE	MSHMS	MIE	MTM
2022	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0
2023	0	0	0	0	1	0	0	0	1	1
Total	0	0	0	0	2	0	0	0	2	1
									Pikë Gjithsej	5/40

Për ta përmbledhur, të njëjtat mangësi të identifikuar në raportimin e institucioneve lidhur me rezultatet e konsultimeve për projektaktet e veçanta (të trajtuara më sipër) konstatohen edhe për raportet në nivel vjetor. Të dyja nivelet e raportimit shfaqin një mungesë të qartë detajimi të metodave të përdorura, llojeve të palëve të interesit të përfshira dhe të hollësive konkrete sa u përket përshtypjeve të ndara. Për shembull, në rastin e pyetjeve konkrete, si “Cili është numri i përgjithshëm i rekomandimeve dhe komenteve të marra, dhe sa është mesatarja për çdo konsultim?” ose “Sa aktorë të jashtëm, joqeveritarë morën pjesë në hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës ose organeve këshillimore gjatë vitit?”, përgjigjet prireshin të ishin të paqarta. Në vend të paraqitjes së statistikave precize, raportet vjetore përfshinin deklarata të përgjithshme, si “morën pjesë OJF-të dhe bizneset e interesuara” (Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitin 2022) ose “aktorët pjesëmarrës përfshinin kryesisht ekspertë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, organeve rregullatore dhe ministrive të linjës” (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në vitin 2022).

Raportet vjetore janë veçanërisht të ndjeshme ndaj mangësive të tilla sepse mbështeten te rigoroziteti dhe plotësia e të dhënave të mbledhura gjatë konsultimeve për projektakte të veçanta gjatë vitit. Kur raportet individuale janë të paplota ose nuk përfshijnë të gjitha metodat e konsultimit dhe të dhënat për pjesëmarrësit, këto mangësi përcillen rrjedhimisht edhe te raportet vjetore, duke theksuar mungesën e transparencës dhe duke kufizuar mundësitë për vlerësimin e angazhimit të palëve të interesit në proceset e konsultimit.

REKOMANDIMET

Konsultimi efektiv publik është jetik për të siguruar që politikat e qeverisë dhe legjislacioni reflektojnë nevojat e shoqërisë. Për të arritur një angazhim kuptimplotë, institucionet shqiptare duhet të kenë prioritet transparencën, aksesueshmërinë, efektivitetin, llogaridhënien, gjithëpërfshirjen, mosdiskriminimin, si dhe pjesëmarrje qytetare në të gjitha fazat e procesit të konsultimit.

Duke u mbështetur në gjetjet e këtij raporti monitorimi, rekomandimet e mëposhtme identifikojnë fushat kritike për përmirësim për secilin parim:

PARIMI I: TRANSPARENCA

Për të siguruar **transparencë në të gjitha fazat** - para, gjatë dhe pas konsultimeve - institucionet duhet të:

- Publikojnë materiale mbështetëse të plota që shoqërojnë projektaktin, për të ofruar kontekst dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e informuar;
- Publikojnë planet vjetore të konsultimeve, së bashku me planet e konsultimeve individuale për çdo projektakt, për të mbajtur palët e interesuara të informuara për konsultimet që do të zhvillohen;
- Bëjnë transparente të gjitha komentet e marra gjatë konsultimeve, duke identifikuar qartë palët e interesuara jo-qeveritare, për të shmangur paqartësitë dhe për të lehtësuar ndjekjen e saktë të kontributeve;
- Publikojnë rregullisht raportet pas konsultimit, në baza gjashtëmujorë dhe vjetore.

PARIMI II: AKSESUESHMËRIA

Për të rritur **aksesin** në dokumentet e konsultimit publik, institucionet duhet të:

- Sigurojnë një seksion të dedikuar për konsultimet publike në faqet e tyre zyrtare;
- Ofrojnë njoftime në kohë mbi konsultimet publike, duke përfshirë detaje të qarta logjistike mbi takimet konsultuese;
- Sigurohen që të gjitha dokumentet mbështetëse për konsultimet të jenë në formate lehtësisht të aksesueshme dhe të ripërdorshme.

PARIMI III: EFEKTIVITETI

Për të rritur **efektivitetin** e proceseve të konsultimeve publike, institucionet duhet të:

- Caktojnë afate fleksibël konsultimesh, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe volumnin e dokumenteve të përfshira;
- Përmirësojnë planifikimin dhe parashikueshmërinë e procesit duke: prioritetizuar shtrirjen e konsultimeve gjatë gjithë vitit, shmangur aktivitete të njëkohshme, siguruar konsultime të paraplanifikuara, si dhe duke nxitur miratimin në kohë të akteve.
- Zbatojnë mekanizma të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi që vlerësojnë efektivitetin e konsultimeve, si dhe të publikojnë raportet përkatëse të monitorimit.

PARIMI IV: LLOGARIDHËNIA

Për të përmirësuar **llogaridhënien** në konsultimet publike, institucionet duhet të:

- Ofrojnë arsytetime mbi përjashtimin e akteve të caktuara nga konsultimet publike;
- Hartojnë dhe publikojnë tabelat me komentet e gjeneruara nga çdo konsultim, duke treguar qartë se si kontributet kanë ndikuar në draftin përfundimtar dhe në vlerësimin e ndikimit rregullator;
- Mundësojnë informacion të plotë mbi fazën e hartimit të akteve të konsultuara, si dhe aktorët jopublikë që morën pjesë në fazën e hartimit dhe të konsultimit;
- Ofrojnë udhëzime të qarta mbi procedurat e ankimimit në lidhje me konsultimet publike, për qytetarët dhe palët e interesuara.

PARIMI V: MOSDISKRIMINIMI DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Për të siguruar **mosdiskriminim dhe gjithëpërfshirje** në konsultimet publike, institucionet duhet të:

- Rrisin përpjekjet për të identifikuar, arritur dhe përfshirë siç duhet grupet e interesit dhe aktorët jopublikë në konsultime, qoftë në fazën e hartimit, ashtu edhe në atë të konsultimit;
- Identifikojnë dhe zbatojnë metoda të përshtatshme konsultimi, të cilat akomodojnë nevojat dhe karakteristikat e komuniteteve dhe grupeve të interesit të prekura, për të mundësuar akses të barabartë.

PARIMI VI: PJESËMARRJA QYTETARE

Për të përmirësuar **pjesëmarrjen e qytetarëve** dhe mundësitë për ndikim, institucionet duhet të:

- Kryejnë konsultime në fazat e hershme me aktorë joqeveritarë, para/gjatë fazës së hartimit të ligjeve dhe politikave;
- Dokumentojnë qartë metodat e konsultimeve të përdorura, për të treguar përpjekjet për të siguruar pjesëmarrje efektive;
- Publikojnë të dhëna të disagreguara mbi pjesëmarrësit dhe kontribuesit, si në fazën e hartimit ashtu edhe në atë të konsultimeve, për të lejuar kryerjen e analizave mbi pjesëmarrjen dhe ndikimin e aktorëve të ndryshëm fazën e hartimit dhe të konsultimit

SHTOJCAT

Tabela 48: Performanca e institucioneve për secilin parim, renditur nga performanca më e lartë tek ajo më e ulët

Institucioni	MB	MBZHR	MD	MTM	MIE	KM	MFE	AMBU	MAS	MSHMS	Performanca e përgjithshme (%)
Transparenca (Maksimumi 48)	42	30	28	35	24	32	26	20	17	2	53%
Aksesueshmëria (Maksimumi 20)	17	15	13	15	19	13	9	16	9	15	71%
Efektiviteti (Maksimumi 26)	10	12	11	13	9	9	12	13	12	7	42%
Llogaridhënia (Maksimumi 46)	24	20	21	13	16	17	6	16	12	2	32%
Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 40)	18	19	20	12	17	10	13	7	8	5	32%
Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 32)	3	12	10	12	10	6	10	1	3	2	22%
Gjithsej	114	108	103	100	95	87	76	73	62	33	

Tabela 49: Renditja e projektakteve sipas shumës së pikëve të fituara, renditur nga rezultati më i lartë tek ai më i ulët

1	2	3	4	5
MD Akti Nr. 2: Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 "Për të drejtën e informimit"	MBZHR Akti Nr. 4: Ligji nr. 20/2023 "Për Bletarinë"	MTM Akti Nr. 2: Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar	MB Akti Nr. 2: Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut"	MB Akti Nr. 5: Projektvendim "Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023"
24 Pikë	23 Pikë	23 Pikë	22 Pikë	22 Pikë
6	7	8	9	10
MBZHR Akti Nr. 5: "Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027"	MIE Akti Nr. 3: Ligji nr. 30/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	MTM Akti Nr. 1: Projektligj "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit"	MB Akti Nr. 4: "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve")	MD Akti Nr. 1: Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.82/2021 "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar"
22 Pikë	22 Pikë	22 Pikë	21 Pikë	21 Pikë
11	12	13	14	15
MTM Akti Nr. 4: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar	KM Akti Nr. 3: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik	MD Akti Nr. 4: Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimit të krimin 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve".	MBZHR Akti Nr. 1: Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqesore"	MBZHR Akti Nr. 2: Projektvendim "Për politikën kombëtare shqiptare për sigurinë agro-ushqimore"
21 Pikë	21 Pikë	20 Pikë	19 Pikë	19 Pikë
16	17	18	19	20
MIE Akti Nr. 2: Projektligj "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"	KM Akti Nr. 2: Projektligji "Për sigurinë kibernetike	MB Akti Nr. 1: Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024-2026"	MD Akti Nr. 5: Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës – Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore	MFE Akti Nr. 3: Vendimi nr. 51, datë 26.01.2022 "Per miratimin e Programit te Reformave Ekonomike (ERP) 2023-2025"
19 Pikë	19 Pikë	18 Pikë	17 Pikë	17 Pikë

21	22	23	24	25
MAS Akti Nr. 1: Për Projektvendim "Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"	MAS Akti Nr. 3: Ligji nr. 44/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	MB Akti Nr. 3: Projektvendim "Për miratimin e Planit të Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025", të ndryshuar	MIE Akti Nr. 4: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 616, datë 01.11.2023 "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë"	MFE Akti Nr. 2: Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar
17 Pikë	17 Pikë	16 Pikë	16 Pikë	16 Pikë
26	27	28	29	30
AMBU Akti Nr. 1: "Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje"	MIE Akti Nr. 1: Vendim i Këshillit të Ministrave N. 448, datë 26.07.2023 "Për miratimin Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023-2030	AMBU Akti Nr. 5: Projektligji për Burimet Ujore	MD Akti Nr. 3: Projektligj "Për mbrojtjen e të dhënave personale"	KM Akti Nr. 4: Projektligji "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë"
16 Pikë	15 Pikë	14 Pikë	13 Pikë	13 Pikë
31	32	33	34	35
KM Akti Nr. 5: Projektligji "Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi	AMBU Akti Nr. 2: Draft Plani i Menaxhimit i Basenit Ujor Mat	KM Akti Nr. 1: Projektligj për titujt e nderit në RSh	MFE Akti Nr. 5: Ligj nr. 105/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"	AMBU Akti Nr. 4: Projektligji për Strategjinë Detare
13 Pikë	13 Pikë	12 Pikë	12 Pikë	12 Pikë
36	37	38	39	40
MAS Akti Nr. 2: Për Projektligjin "Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë"	AMBU Akti Nr. 3: Plani i Menaxhimit i Basenit Ujor Erzen	MTM Akti Nr. 5: Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr.155, datë 7.12.2020 "Për ndryshimet klimatike"	MIE Akti Nr. 5: Projektligji "Për Urdhrin Profesional të Inxhinierëve"	MTM Akti Nr. 3: Ligj nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe disa ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"
12 Pikë	11 Pikë	10 Pikë	8 Pikë	8 Pikë

41	42	43	44	45
MFE Akti Nr. 1: Projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet")	MShMS Akti Nr. 4: Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 105/2014 "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", të ndryshuar	MShMS Akti Nr. 3: Kontrollin e Kultivimit dhe Përpunimit të Bimës së Kanabisit dhe Prodhimit të Nënprodukteve të Saj për Qëllime Mjekësore dhe Industriale	MShMS Akti Nr. 2: Projektligji Per nje shtese dhe nje ndryshim ne Ligjin Nr. 57/2019 "Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise"	MBZHR Akti Nr. 3: Për planin e veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri për vitet 2022-2032
8 Pikë	8 Pikë	7 Pikë	6 Pikë	5 Pikë
46	47	48	49	50
MFE Akti Nr. 4: Projektligji "Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive	MShMS Akti Nr. 1: Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030	MShMS Akti Nr. 5: Draft-Dokumenti i Politikave Sociale	MAS Akti Nr. 4: Ligji nr.60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë"	MAS Akti Nr. 5: Vendim nr.338 datë 31.05.2023 "Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj"
4 Pikë	4 Pikë	4 Pikë	0 Pikë	0 Pikë

Tabela 50: Performanca e procesit të konsultimit për çdo projektakt, e vlerësuar sipas secilit parim dhe e organizuar sipas institucionit propozues

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektaktet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Brendshme	Akti nr. 1: Projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026"	5	3	1	5	4	0	18	99	15	114
	Akti nr. 2: Projektligji "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 107/2016 'Për Prefektin e Qarkut'"	8	4	2	6	2	0	22			
	Akti nr. 3: Projektvendimi "Për miratimin e Planit të Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar"	5	4	0	4	3	0	16			
	Akti nr. 4: "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, planit të saj të veprimit dhe pasaportës së treguesve"	8	3	2	4	4	0	21			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektaktet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
	Akti nr. 5: Projektvendimi "Për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 'Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale të Luftës kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2023'"	8	3	1	5	5	0	22			
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Akti nr. 1: Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore"	6	3	1	5	3	1	19	88	20	108
	Akti nr. 2: Projektvendimi "Për politikën kombëtare shqiptare për sigurinë agroushqimore"	5	3	2	4	3	2	19			
	Akti nr. 3: Plani i veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri për vitet 2022-2032	1	3	1	0	0	0	5			
	Akti nr. 4: Ligji nr. 20/2023 "Për bletarinë"	5	3	2	5	7	1	23			
	Akti nr. 5: "Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027"	5	3	1	6	6	1	22			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Akti nr. 1: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 26.07.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023-2030"	2	4	1	2	5	1	15	80	15	95
	Akti nr. 2: Projektligji "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"	2	4	1	6	5	1	19			
	Akti nr. 3: Ligji nr. 30/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"	6	4	1	4	5	2	22			
	Akti nr. 4: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 01.11.2023 "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë"	5	4	2	3	1	1	16			
	Akti nr. 5: Projektligji "Për Urdhrin Profesional të Inxhinierëve"	2	3	2	0	1	0	8			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Drejtësisë	Akti nr. 1: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 82/2021 'Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar'"	6	2	2	6	4	1	21	95	13	108
	Akti nr. 2: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, "Për të drejtën e informimit"	7	3	2	5	6	1	24			
	Akti nr. 3: Projektligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale".	4	2	1	4	2	0	13			
	Akti nr. 4: Projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, planit të saj të veprimit dhe pasaportës së treguesve"	6	3	1	4	4	2	20			
	Akti nr. 5: Udhërrëfyese për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"	5	3	2	2	4	1	17			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Akti nr. 1: Projektligji "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit"	8	4	2	3	3	2	22	84	16	100
	Akti nr. 2: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015, 'Për turizmin', i ndryshuar"	7	3	2	4	5	2	23			
	Akti nr. 3: Ligji nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'"	2	2	2	2	0	0	8			
	Akti nr. 4: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, 'Për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor', i ndryshuar"	8	3	2	3	3	2	21			
	Akti nr. 5: Projektligji "Për një ndryshim në Ligjin nr. 155, datë 7.12.2020 'Për ndryshimet klimatike'"	4	3	2	0	1	0	10			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Këshilli i Ministrave	Akti nr. 1: Projektligji "Për titujt e nderit në Republikën e Shqipërisë"	6	2	2	1	1	0	12	78	9	87
	Akti nr. 2: Projektligji "Për sigurinë kibernetike"	5	3	1	5	3	2	19			
	Akti nr. 3: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, 'Për prokurimin publik'"	5	4	1	6	3	2	21			
	Akti nr. 4: Projektligji "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë"	6	2	2	2	1	0	13			
	Akti nr. 5: Projektligji "Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"	6	2	1	2	2	0	13			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Akti nr. 1: Projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet"	2	1	2	2	1	0	8	57	19	76
	Akti nr. 2: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"	4	2	2	2	5	1	16			
	Akti nr. 3: Vendimi nr. 51, datë 26.01.2022 "Për miratimin e Programit të Reformës Ekonomike (PRE) 2023-2025"	8	3	0	2	3	1	17			
	Akti nr. 4: Projektligji "Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklarim vullnetar të pasurive"	1	1	2	0	0	0	4			
	Akti nr. 5: Ligji nr. 105/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 92/2014 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"	3	2	2	0	4	1	12			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore	Akti nr. 1: Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasë të ndodhin përmbytje	4	4	2	3	2	1	16	66	7	73
	Akti nr. 2: Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor për Basenin Ujor të Matit	3	3	1	4	2	0	13			
	Akti nr. 3: Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor të Erzenit	3	3	1	3	1	0	11			
	Akti nr. 4: Projektligji për Strategjinë Detare	3	3	2	3	1	0	12			
	Akti nr. 5: Projektligji për burimet ujore	5	3	2	3	1	0	14			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Akti nr. 1: Projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj"	6	3	1	4	3	0	17	46	15	61
	Akti nr. 2: Projektligji "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë"	2	3	2	3	2	0	12			
	Akti nr. 3: Ligji nr. 44/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 69/2012 'Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"	4	3	2	5	3	0	17			
	Akti nr. 4: Ligji nr. 60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e Përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë"	0	0	0	0	0	0	0			

	Aktet	Transparenca (Maksimumi 8)	Aksesueshmëria (Maksimumi 4)	Efektiviteti (Maksimumi 2)	Llogaridhënia (Maksimumi 8)	Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (Maksimumi 8)	Pjesëmarrja qytetare (Maksimumi 2)	Gjithsej (Maksimumi 32)	Gjithsej (Pikët nga projektet)	Gjithsej (Pikët nga burimet e tjera)	Pikët e përgjithshme të fituara nga Institucioni
	Akti nr. 5: Vendimi nr. 338, datë 31.05.2023 "Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj"	0	0	0	0	0	0	0			
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Akti nr. 1: Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030	1	3	0	0	0	0	4	29	4	33
	Akti nr. 2: Projektligji për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"	0	3	2	0	1	0	6			
	Akti nr. 3: Kontrolli i kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit si dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale	0	3	2	0	2	0	7			
	Akti nr. 4: Ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimet farmaceutike", i ndryshuar	1	3	0	2	2	0	8			
	Akti nr. 5: Projektdokumenti për politikën sociale	0	3	1	0	0	0	4			



KONSULTIMI PUBLIK NË SHQIPËRI: ILUZIONI I PËRFSHIRJES

NJË DISTANÇË E LARGËT NDËRMJET TRANSPARENCËS
DHE PJESEMARRJES NË KONSULTIMET E QEVERISË